

Tiranë 2013

Craig L. Blomberg

Libri i Zbulesës:

Plani i Perëndisë për historinë kozmike

Përgatitën për botim: Ylli Doçi, Afrim Karoshi

Përkthyes: Blerta Qiriazhi-Myrteza

Redaktor teologjik: Florenc Mene

Redaktor letrar dhe korrektor: Agesil Qiriazhi *Design:*
m&b

© Craig L. Blomberg

All rights reserved. This translation of “From Pentecost to Patmos” first published in 2006 is published by arrangement with Inter-Varsity Press, Nottingham, United Kingdom.

© Botimet Jeta e Re (Instituti Jeta e Re) për botimin në shqip.

ISBN: 978-99956-851-7-1

Vizatimet në kopertinë nga Albrecht Durer: “Gjoni përpara Zotit dhe pleqve” dhe “Katër kalorësit”, nga libri “The Life and Art of Albrecht Durer” nga Erwin Panofsky. © Princeton University Press, 1955.

Shtypur: albPAPER / Tirazhi: 1000 kopje

Mirënjohje për parathënie

Profesor Craig Blomberg njihet dhe vlerësohet botërisht në Amerikë dhe në shumë vende të tjera, si një ndër akademikët më të respektuar ungjillorë të kohës sonë. Por atë e njohin edhe shumë njerëz të thjeshtë, sepse kalibri i tij akademik u popullarizua sidomos përmes librit “Çështja e Krishtit” të Lee Strobel.

Shumë janë ata që kanë dëgjuar për profesor Blombergun dhe kanë lexuar veprat e tij, por vetëm disa të privilegjuar mund t’i dëgjojnë nga goja e tij shpjegimet që kondensojnë studimet e tij të admirueshme. Klasat e tij në Seminarin e Denverit mbushen më shpejt sesa mbushen dyqanet e mëdha amerikane në ditën e parë të ofertave të mëdha dhe shumë studentë detyrohen të presin semestrin e ardhshëm ose të bëjnë kursin me një profesor tjetër. Pasi e provova edhe unë vështirësinë për t’u regjistruar në klasën e tij, kam patur privilegjin të studioj Dhiatën e Re për disa semestra me profesor Blombergun në Seminarin e Denverit dhe, midis shumë profesorëve të mrekullueshëm atje, pa asnjë hezitim, mund të deklaroj që Blombergu ishte profesori më i mirë si shpjegues i lëndës. Një zotërues i mahnitshëm i njohurisë për lëndën, ai është i pakrahasueshëm në mundësimin e kuptimit të koncepteve më të debatuar.

Në vitin 2009 dhe 2012 të krishterët shqiptarë në Tiranë kanë patur privilegjin të studiojnë Ungjillin e Mateut dhe Librin e Zbulesës në dy vizitat njëjavore të profesorit, për të mësuar stafi në Institutin “Jeta e Re”. Me rastin e ardhjes së tretë të profesor Blombergut në janar 2014, për të na mësuar Ungjillin e Gjonit, ne po botojmë këtë komentuar të shkurtër të Zbulesës, shkëputur nga libri i tij “From Pentecost to Patmos”.

Zbulesa konsiderohet si libri më i vështirë i Biblës për t’u kuptuar dhe shumë shpesh lihet pa lexuar, ndërkohë që Zbulesa është i vetmi libër që thotë shprehimisht se leximi i kësaj profecie bekon. Të krishterët në përgjithësi duken se s’kanë besim tek vetja për ta kuptuar duke e lexuar Zbulesën vetë dhe gjithmonë synojnë shpjegimet e të tjerëve që mund të variojnë në një gamë shumë të gjerë këndvështrimesh dhe interpretimesh. Një arsye pse e ftuam profesor Blombergun për Zbulesën ishte pikërisht që me qartësinë erudite që e karakterizon dhe me përvullësinë frymëzuese të dashamirësisë së tij për mendimet ndryshe, të ndihmonë në forcimin e bindjes që çdo i krishterë mund të ushqehet vetë nga ky libër në bashkëbisedim inteligjent me lexuesit e tjerë, pa komplekse dhe fetishizime të një këndvështrimi apo të një tjetri.

Përvoja jonë gjatë javës që profesor Blombergu lexoi Zbulesën me ne në Tiranë nuk mund të ripërsëritet dhe mbetet privilegj i atyre që ishin atje, por me këtë libër ne shpresojmë të sjellim një ndihmë të rëndësishme për

kuptimin e Zbulesës. As profesori dhe as ne nuk presim që çdo lexues të njësohet me të në çdo mendim për Zbulesën, por shpresojmë që thjeshtësia dhe qartësia e arsyetimit do të inkurajojë mendimin e çliruar nga paragjykimet dhe pasiguria që të përtypë bekimin e Zbulesës, duke e lexuar vetë.

Për shkak të respektit maksimal që kam unë për profesor Blombergun, për shkak të vetëdijes që njohuria e tij është si një mal para njohurisë sime sa një kokërr gështenje, unë gëzohem kur gjej një gjë që nuk bie dakord me të, sepse kuptoj që nuk jam hipnotizuar nga mësimi i tij. Është pikërisht kjo hapësirë mendimi personal që inkurajon profesor Blombergu ajo që i bën transformuese ato mbrëmje pranë zjarrit në shtëpinë time, ato ditë leksionesh pranë podiumit të tij apo ato orë leximi nga faqet e librit të tij.

Ylli Doçi *Drejtor Kombëtar i Institutit
Jeta e Re
për Shqipërinë dhe Kosovën*

HYRJE

Autorësia

Kritikët në përgjithësi e hedhin poshtë pretendimin historik të kishës mbi autorësinë e Gjonit për librin e Zbulesës. Si shumë vendimtare shikohen disa ndryshime stilistike dhe teologjike me Ungjillin dhe letrat e Gjonit. Për shembull, emri “dashuri” dhe folja “dua” (agapē, agapaō) gjenden 44 herë në Ungjillin e Gjonit dhe 52 herë në letrat e tij, por vetëm 6 herë në Zbulesë. “Besoj” (pisteuō) gjendet 98 herë në Ungjill, 9 herë në letrat e Gjonit, por nuk del fare në Zbulesë. Gjithashtu, Zbulesa përmban shumë solecizma (parregullsi gramatikore që nuk mund t’i atribuohen ndonjë rregulli të njohur apo modeli të greqishtes së shkruar) që mungojnë në librat e tjerë të Gjonit. Peshkopi i Aleksandrisë në shekullin

e tretë, Dionisi, shprehu dyshimet e tij në lidhje me autorësinë e apostullit për këtë dokument, kryesisht për shkak të dyshimit të tij ndaj teologjisë mijëvjeçariste¹ që gjendet aty dhe për shkak të mospëlqimit nga ana e tij të literaturës apokaliptike në përgjithësi.²

Megjithatë, ky është i vetmi nga të pesë librat e atribuar Gjonit që mban emrin “Gjon” brenda tekstit të tij. Prandaj, nëse ndonjëri nga librat do të kishte më shumë të drejtë për të mbajtur autorësinë e apostullit, ai do të ishte ky. Nga ana tjetër, ky Gjon identifi kohet si shërbëtor, vëlla dhe profet (1:1, 4, 9; 22:28), por kurrë si apostull apo si plak.

Në vazhden e rishfaqjes së një mendimi për origjinën hebreje të shumicës së Dhiatës së Re, shumë studiues sot janë gati të pranojnë etiketat që përdor teksti dhe të bëjnë lëshimin që shkruesi i këtij dokumenti ishte një profet hebre i krishterë, ndoshta edhe nga Palestina, por i ndryshëm nga apostulli me të njëjtin emër.³ Në fund të fundit, Ungjilli dhe letrat nuk i referohen autorit të tyre si Gjon. Meqenëse Zbulesa nuk e specifi kon se cili Gjon është autori i saj, kjo linjë argumentimi është krejt e arsyeshme.

¹ . “Teologjia mijëvjeçariste” – bëhet fj alë për faktin se libri i Zbulesës (20:3-7) duket se fl et për një mbretërim mijëvjeçar të Krishtit në tokë, përpara gjykimit të madh (shënim i redaktorit teologjik, Florenc Mene.).

² . Për këtë dhe argumente të tjera shih Robert H. Mounce, *The Book of Revelation* (Grand Rapids:Erdmans, rev.1998), 8-15.

³ . Shih Richard Bauckham, *The Theology of the Book of Revelation* (Cambridge and New York: CUP, 1993)

Megjithatë, ne nuk mund ta hedhim poshtë kaq shpejt traditën e kishës së hershme. Justin Martiri (*Dialogje* 81.15), Ireneu (*Kundër herezive* 4.14.1, 5.26.1), Tertuliani (*Kundër Marcionit* 3.14, 24) dhe Klementi i Aleksandrisë (*Të ndryshme* 6.106-7, *Tutori* 2.119) e pohojnë se Apokalipsin e shkroi apostulli, dhe nuk ka tradita të vjetra konkurruese në lidhje me autorësinë. Ndryshimet në fj alor mund t'i atribuohen gjinisë letrare dhe përmbajtjes. Zbulesa nuk i ka qëllimet ungjillizuese ose katekiste (mësimore) të nxitjes së njerëzve për besim, siç i kanë shkrimet e tjera të Gjonit; periodha kohore që përshkruhet aty pasqyron më shumë gjykimin e Perëndisë, sesa dashurinë e Tij. Stili i çrregullt mund të pasqyrojë natyrën e vegimeve të Gjonit – një përpjekje për të shpjeguar të pashpjegueshmen – ose ekstatën e profetit, ose mungesën e një shkruesi apo redaktori, ose mospërfshirjen e “shkollës joanine.”⁴⁵ Fjalori dhe niveli i përgjithshëm i shkrimit ka më shumë

⁴ · Shumë studiues flasin për “Shkollën Joanine”. Ky term i referohet këndvështrimit të katër studiuesve, sipas së cilëve egzistonte një komunitet redaktorësh që i përpunuan dhe botuan shkrimet që ia atribuojmë Gjonit në disa faza të procesit. Sipas Blomberg, megjithëse ka arsye për të menduar për një lloj redaktimi minimal, përsëri autorësia e Gjonit i qëndron kohës edhe sot. Shiko Craig L. Blomberg, “From Pentecost to Patmos: An Introduction to Acts through Revelation”, B&H Publishers, TEN (2006): 486. (Shën. i Botuesit).

⁵ · Për më tepër, jo të gjitha problemet e greqishtes së Zbulesës duken aq të mëdha, sa në fi llim, pasi ke bërë një kërkim më të gjerë në greqishten helenistike. Shih Stanley E. Porter, “The Language of the Apocalypse in Recent Discussion,” NTS 35 (1989): 583-603.

ngjashmëri me shkrimet e tjera të Gjonit, sesa ndryshime (apo ngjashmëri me dokumentet e tjera të Dhiatës së Re).

Për shembull, vetëm në këta pesë libra del kristologjia e logosit ose e “Qengjit të Perëndisë” si titull për Jezusin, apo përdorimi i Zakarias 12:10 si profeci e përmbushur nga Jezusi (Krahaso: Gjoni 19:37; Zbu 1:7). Zbulesa, gjithashtu, ka të përbashkët me shkrimet e tjera të atribuara Gjonit, një theks të dukshëm mbi dëshminë, jetën e përjetshme përkundër vdekjes së përjetshme, uri dhe etje shpirtërore, si dhe temën e fi tores.⁶

Sfondi Historik

Sfondi historik që pranohet më gjerësisht për Zbulesën është përndjekja jetëshkurtër, por hera-herës shumë e ashpër, e Domicianit nga viti 94 deri në 96. Ireneu (Kundër herezive 5.30.3) dhe Eusebi (Historia e kishës 3.18-20, 5.8.6) i referohen qartë pjesës së fundit të sundimit perandorak të Domicianit, i cili zgjati gjithsej nga viti 81 deri në vitin 96 (krahaso edhe Viktorinin, Klementin e Aleksandrisë dhe Origenin). Internimi i shkurtër i Gjonit në ishullin e

⁶ . Krahaso G.R. Beasley-Murray, *The Book of Revelation* (London: Marshall, Morgan & Scott, rev. 1978: Grand Rapids: Eerdmans, 1981), 34. Disa herë të Zbulesa shfaqen fj alë të ndryshme për të njëjtat koncepte që gjenden *paralelisht* në ungjillin e katërt, por, ajo gjë që nuk vihet re nga shumë studiues është se rrallëherë nuk përfshihen edhe të njëjtat fj alë në të dy dokumentet (Ungjillin e Gjonit dhe Zbulesën), në një pikë apo në një tjetër.

Patmosit (1:9) përputhet mirë me mesin e viteve 90, sepse s'ka dëshmi apo prova të dëbimit të të krishterëve prej vendeve të tyre nga qeveria, para kësaj date. Procedura gjatë kësaj periudhe duket se ka qenë të arrestoheshin vetëm ata të krishterë që dorëzoheshin tek autoritetet nga të tjerë dhe zakonisht vetëm kur dorëzimi shoqërohej me një akuzë për ndonjë shkelje tjetër (sado të sajuar). Edhe në këto raste dënimi i zakonshëm ishte burgimi (ose internimi për udhëheqësit e krishterë, në mënyrë që ata të ushtronin sa më pak ndikim) dhe jo vdekja. Dhe edikti kundër të krishterëve u anulua nga Nerva, që erdhi pas Domicianit, në vitin 96.⁷ Për më tepër, pak gjëra të Zbulesa do të kishin nevojë të shpjegoheshin me armiqësinë *direkte* të qeverisë. Bezdisjet në mënyra të tërthorta të romakëve dhe përbuzja e paganëve për zakonet e të krishterëve, nga mesi i shekullit të parë, deri në fi llim të shekullit të dytë, ishin të zakonshme dhe mund të shpjegojnë një pjesë të madhe të atyre gjërave që po përjetonin kishat e Gjonit në atë kohë.⁸

⁷ Veçanërisht nën dritën e argumenteve nga Leonard L. Thompson (*The Book of Revelation: Apocalypse and Empire* [Oxford and New York: OUP, 1990], 95-115), shumë studiues kanë fi lluar të thonë se Domiciani pothuajse s'i ka përndjekur fare të krishterët. Kjo rrymë është një kundërbalancë e mirë për pretendimin e vjetër që e ekzagjeronte ashpërsinë e kësaj përndjekjeje, por që e nënvlerëson atë që ndodhi vërtet. Për një vlerësim të shkurtër, por të ekuilibruar, shih: Ben Witherington III, *Revelation* (Cambridge and New York: CUP, 2003), 5-10.

⁸ Th omas B. Slater, "On the Social Setting of the Revelation to John," NTS 44 (1998): 232-56.

Edhe shumë referenca historike të shpërndara në gjithë Zbulesën përputhen më mirë me vitet 90. Në këtë kohë Laodicea e kishte marrë veten nga tërmeti që e shkatërroi në fi llim të viteve 60. Tensioni me degë të ndryshme të judaizmit kishte arritur kulmin, duke çuar në *birkath ha-minim* (“bekimin” [si eufemizëm për “mallkim”] mbi heretikët, veçanërisht të krishterët) – një lutje e nëntëmbëdhjetë e shtuar në liturgjinë e sinagogave, e shoqëruar me dëbimin e hebrenjve të krishterë nga sinagogat dhe fshirjen nga listat e anëtarësisë. Prandaj, Gjoni mund t’i etiketojë asamblatë hebreje në Efes dhe Filadelfi a si sinagoga “të Satanit” (2:9; 3:9). Në këtë kohë, në disa qarqe pagane mbizotëronte edhe besimi për një Neron *redivivus* (të rikthyer në jetë) – imazh ky që gjendet mbrapa portretizimit të bishave anti-të krishtera në kapitujt 12-13. Kisha në Efes kishte rënë nga rëndësia (si në 2:1-7), gnosticizmi ishte gati të lulëzonte (si ndoshta në 2:24) dhe uria e vitit 92 formonte sfondin e simbolikës së 6:6.⁹

Megjithatë, një numër i vogël studiuesish zakonisht tejet konservatorë, e vendosin datën në vitet 60, pjesërisht për shkak të heshtjes në lidhje me shkatërrimin e Jerusalemit në vitin 70 pas Krishtit dhe për shkak të supozimit se referencat për tempullin në kapitullin 11 nënkuptojnë se ai është ende më këmbë. Disa hedhin si argument një traditë të një pakice në kishën e hershme, që

⁹ . Për këto dhe argumente të tjera të lidhura me to, krahaso sidomos Grant. R. Osborne, *Revelation* (Grand Rapids: Baker, 2002), 6-9.

thotë se Gjoni u martirizua në një datë më të hershme. Shumë prej tyre e vënë gishtin te disa imazhe në të gjithë Zbulesën që duket se pasqyrojnë ngjarje në jetën e Neronit, megjithëse kjo vetëm sa konfirmon se sfondi nuk mund të jetë më herët se koha e Neronit.¹⁰ Disa mendojnë që misteri i shtatë mbretërve në 17:9-11 (shih më poshtë fq. 96) zgjidhet më mirë me këtë datim. Të tjerë, me sa duket, thjesht *dëshirojnë* që të jetë e vërtetë një datë më e hershme, në mënyrë që të mbrojnë këndvështrimin “preterist”¹¹ ndaj librit (shih më poshtë, fq. 28-31), sipas të cilit, pothuajse çdo gjë, përveç qiejve të rinj dhe tokës së re në kapitujt 21-22, mund të merret se u referohet ngjarjeve që kanë përfunduar deri në vitin 70.¹² Por, provat e jashtme dhe të brendshme për një datë më të vonë (dhe një martirizim më të vonë të Gjoni), mbeten shumë më të forta, për të mos përmendur që

¹⁰ · Nga një këndvështrim krejt i ndryshëm, J. Christian Wilson (“The Problem of the Domitianic Date of Revelation,” NTS 39 [1993]: 587-605) vë në pikëpyetje gjithë traditën patristike në lidhje me shkrimet e Gjoni dhe përndjekjen e Domicianit, dhe përpiket të koordinojë referencat ndaj pesë mbretërve që kanë rënë në 17:10 me listën e perandorëve, duke fi lluar me Julin ose Augustin dhe duke përfunduar kështu, ose me Klaudin (menjëherë përpara Neronit), ose me Neronin vetë.

¹¹ · Pikëpamja preteriste – Preterizmi është një pikëpamje eskatologjike e krishterë që i interpreton profecitë e Biblës si ngjarje që kanë ndodhur tashmë. Sipas kësaj pikëpamjeje, shumica e profecive biblike u përmbush në vitin 70 pas K. në kohën e shkatërrimit të tempullit të Jerusalemit (shën. i red. teol. F.M.).

¹² · Shih veçanërisht Kenneth L. Gentry, Jr., *Before Jerusalem Fell: Dating the Book of Revelation* (Tyler, Tex.: Institute for Christian Economics, 1989).

përndjekja e Neronit (vitet 64-68) zor se përfshiu të krishterë jashtë provincës së Italisë.¹³

Cilado të ketë qenë data, adresat janë të qarta: *shtatë bashkësi të krishtera në Azinë e Vogël* (në Turqinë e sotme perëndimore), të renditura në atë mënyrë që i korrespondon radhës sipas të cilës një udhëtar do të kishte udhëtuar për tek ato, duke ndjekur një seri rrugësh në një formë ovale të çrregullt nisur nga Efesi në bregun e Egjeut (1:4, 11). Ky, sigurisht, ishte rajoni në të cilin Gjoni kishte shërbyer. Dëshira e Gjonit mund të ketë qenë që, një vizitor në Patmos nga kontinenti, të cilit ai mund t'i besonte, t'ua çonte letrën fi llimisht efesianëve, të cilët do të bënin një kopje për vete dhe pastaj ta dërgonin dokumentin më tutje te komuniteti tjetër të cilit i drejtohej. Ajo kishë pastaj do të përsëriste procesin, e po ashtu edhe tjetra, e me radhë, derisa të shtata bashkësitë të kishin marrë një kopje të librit. Pse u zgjodhën këto shtatë kisha, nuk mund të përgjigjemi me siguri – patjetër jo të gjitha komunitetet ishin njëlloj të rëndësishme. Ndoshta ishte lehtësia e çuarjes se letrës e kombinuar me njohurinë e Gjonit se ato përfaqësonin një spektër të mirë të kishave të shëndetshme dhe të pashëndetshme në botën e tij (shih më poshtë fq. 38-48). Ndoshta ato ishin kishat që ai njihte më mirë, zemra e “komunitetit

¹³ · Për një teori të hartimit me dy faza të dokumentimit, duke lejuar pikat e forta të të dyja datave të kombinohen, shih Robert B. Moberly, “When Was Revelation Conceived?” *Bib* 73 (1992): 376-93.

joanian.”¹⁴ Sigurisht, disa prej tyre ishin vatra të konkuruesve kryesorë paganë të krishtërimit, më i njohuri prej të cilëve ishte kulti perandorak.¹⁵

Zemra e mesazhit të Gjonit ishte t’i siguronte këta të krishterë në Azi që bezdisjet dhe përndjekja (ose thjesht frika e secilës) që ata përjetonin përputhej me planin e Perëndisë, dhe se ngjarjet e asaj kohe paralajmëronin mundimin e madh që do të vinte menjëherë para kthimit të Krishtit.¹⁶

Por, për ata që do të “fi tonin,” që do të mbeteshin besnikë në rrëfi min e Krishtit, Perëndia do të siguronte fitore dhe shpërblim përfundimtar, e po ashtu, do të gjykonte dhe shkatërronte armiqtë e tyre. Sado të zymta të duken gjërat në këtë jetë, Perëndia mbetet në kontroll. Një ditë Jezusi do të triumfojë dhe e vetmja gjë që do të ketë rëndësi është: do të jemi apo jo në anën e Tij!

¹⁴ · “Komuniteti joanian” – komuniteti që Gjoni (fj. ala greke “Joan”) mbikëqyrte dhe mësonte (Red. Teol. F.M).

¹⁵ · Mbi përhapjen e adhurimit të perandorit dhe mbi rëndësinë e tij për interpretimin e Zbulesës, shih: Steven J. Friesen, *Imperial Cults and the Apocalypse of John* (Oxford and New York: OUP, 2001).

¹⁶ · Krahason sidomos Adela Yarbro Collins, *Crisis and Catharsis: The Power of the Apocalypse* (Philadelphia: Westminster, 1984).

Gjinia letrare

Zbulesa është një përzierje e tre gjinive letrare të mirënjohura hebreje dhe greko-romake.¹⁷ Kryesisht, siç tregojnë edhe vetë titulli dhe fjala e parë e librit, ajo është apokalips. Letërsia apokaliptike ishte e zakonshme në burime të tjera hebreje dhe të krishtera, duke përfshirë pjesë nga Ezekieli, Danieli, Zakaria dhe biseda e Jezusit me dishepujt në Malin e Ullinjve (Mat. 24-25). Në letërsinë ndërthiore¹⁸, 1 Enokut, 4 Ezras dhe 2 Barukut janë nga librat apokaliptikë hebrenj më të njohur dhe më të rëndësishëm, sidomos për interpretimin e Zbulesës.¹⁹ Letërsia apokaliptike ndryshonte shumë në formë, por tiparet që haseshin më shpesh përfshinin (a) përdorimin e gjerë të simbolizmit, shpesh me krijesa dhe kozmologji të çuditshme ose groteske, shumë të ngjashme në funksion me karikaturat e sotme politike; ²⁰ (b) përshkrimin e ngjarjeve historike botërore të së kaluarës, të së tashmes dhe/ose të së ardhmes që kulmonin në një ndërhyrje vendimtare nga ana e Perëndisë, për të vënë në vend

¹⁷ · Krahaso: Dave Mathewson, "Revelation in Recent Genre Criticism: Some Implications for Interpretation," *TrinJ* 13 (1992): 193-213.

¹⁸ · Librat e shkruar në kohën mes dy Dhiatave (të vjetrës dhe të resë). Pra, këta libra u shkruan diku mes viteve 400 para K. deri në kohën e ardhjes së Krishtit (red. teol. F.M.).

¹⁹ · Për një antologji të shkëlqyer të apokalipseve jokanonikë hebrenj dhe të krishterë, shih: Mitchell G. Reddish, ed., *Apocalyptic Literature: A Reader* (Peabody: Hendrickson, 1995).

²⁰ · Beasley-Murray, *Revelation*, 16-17.

padrejtësitë shoqërore dhe për të shpërblyer njerëzit e Tij besnikë; dhe (c) sigurinë për njerëzit në vështirësi reale ose të imagjinuara që e keqja më në fund nuk do të fi tojë.²¹

Kështu, nuk ka si ta parashikojmë që më parë sa e drejtpërdrejtë apo fi gurative do të jetë një vepër e tillë. Çdo simbol potencial do të duhet të interpretohet nën dritën e sfondit të vet historik dhe ashtu si do të kishte më shumë të ngjarë ta kishin kuptuar dëgjuesit/lexuesit e parë. Në rastin e apokalipsit të Gjonit, ky sfond do të ishte *Dhiata e Vjetër*,²² *letërsia ndërthiutore dhe ngjarjet që kishin ndodhur së fundmi apo që po ndodhnin në qytetet e Azisë së Vogël në kohën e Gjonit. Por numrat janë pothuajse gjithmonë simbolikë, sidomos shtatat dhe shumëfi shat e tyre (që simbolizojnë plotësi apo universalitet – bazuar në shtatë ditët e krijimit) dhe dymbëdhjetat dhe shumëfi shat e tyre (që simbolizojnë dymbëdhjetë fi set e Izraelit dhe/ose dymbëdhjetë apostujt – për të përshkruar popullin e Perëndisë në tërësi).*²³ Megjithatë, Zbulesa ndryshon nga

²¹ · Një përkufi zim teknik i shpeshcitur i apokalipsit është ai i John J. Collins, “Introduction: Toward the Morphology of a Genre,” *Semeia* 14(1979): 9 – “një gjini letrare zbulesore me një strukturë tregimtare, në të cilën një zbulesë e caktuar transmetohet nga një qenie e një bote tjetër te një marrës njerëzor, dhe që zbulon një realitet transhendent që është edhe kohor, përderisa paraqet shpëtim eskatologjik, edhe hapësinor, përderisa ka të bëjë me një botë tjetër, të mbinatyrshe.”

²² · “Zbulesa përmban më shumë referenca ndaj Dhiatës së Vjetër, sesa çdo dokument tjetër i Dhiatës së Re, edhe pse këto referenca janë shpesh aluzive” (Stephen S. Smalley, *Th e Revelation to John* [London: SPCK; Downers Grove: IVP, 2005], 9).

²³ · Shih veçanërisht Richard Bauckham, *Th e Climax of Prophecy* (Edinburgh: T&T Clark, 1993), 22-37; kra. Frederick J. Murphy *Is Babylon: Th e Revelation to John* (Harrisburg: Trinity, 1998), 24-27.

letërsia apokaliptike e botës së vjetër, duke *mos* qenë (a) me pseudonim; (b) histori retrospektive (që ka profeci *ex eventu*, d.m.th. pas ngjarjes); apo (c) dualiste nga ana morale dhe tërësisht pesimiste në këndvështrim.²⁴ Dhe, duke qenë se shkrimet e tjera apokaliptike nuk bazoheshin domosdoshmërisht në vegime apo zbulesa të vërteta të përjetuara nga autorët, por ishin një mjet letrar për të përshkruar të vërteta të papërshkrueshme, ky apokalips ndryshon prej tyre, sepse është i themeluar në përjetime të vërteta të Zotit që i zbulohet Gjoni.

Ben Uidhëringtoni (Witherington) e përshkruan mirë ekuilibrin midis zbulesës reale dhe interpretimit simbolik: “Atë që dëgjoji Gjoni mund ta ketë transkriptuar pothuaj fj alë për fj alë, por ato që pa i duhej t’i përshkruante dhe për këtë i duhej të përdorte imazhet që kishte në mendje. Kur dikush shikon imazhe dhe simbole në kombinime të çuditshme, atij i duhet të kërkojë analogji për t’i përshkruar (prandaj ndeshim shpesh frazën ‘ishte si’).”²⁵

Zbulesa, gjithashtu, kombinon elemente të dy gjinive të tjera letrare – të letërsisë profetike dhe asaj epistolare, që e bëjnë formën e saj apokaliptike të veçantë. Si *profeci* (1:3) Gjoni u referohet ngjarjeve reale që i takojnë së ardhmes, megjithëse shpesh i përshkruan me një gjuhë shumë simbolike. Kur Gjoni i drejtohet situatës aktuale në kishat, ai e bën këtë pjesërisht me qëllim që kishat që

²⁴ · Për një listë më të zgjeruar, shih: Leon Morris, *Th e Book of Revelation* (Grand Rapids: Eerdmans, rev. 1987), 25-27.

²⁵ · Witherington, *Revelation*, 36.

kanë nevojë të pendohen, të pendohen dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të sjellë ndryshimin e botës që Perëndia dëshiron në kohën e tyre, sado e papërsosur të mbetet ajo. Me fj alë të tjera, Zbulesa merr pjesë në të njëjtën teologji të mbretërisë së inauguruar që “është e pranishme edhe pse jo plotësisht”, që karakterizon Dhiatën e Re.²⁶ Ajo, gjithashtu, në mënyrë të nënkuptuar, sfi don strukturat e këqia perandorake të Romës që, në mënyrë të paligjshme, pretendojnë autoritet hyjnor, ashtu siç kanë bërë profetët në shumë epoka që kanë konfrontuar mbretër dhe sundimtarë, kur ata e kanë kapërcyer cakun e autoritetit të dhënë nga Perëndia.²⁷

Si letër (krahaso formën e 1:4-5), që në vetvete përmban shtatë letra më të shkurtra individuale për secilën nga shtatë kishat (kapitujt 2-3), libri është i lidhur ngushtë me sfondet specifi ke dhe ngjarjet aktuale në fund të shekullit të parë, për secilin nga komunitetet e provincës së Azisë, në të cilat gjenden shtatë kishat. I gjithë dokumenti u është shkruar këtyre bashkësive për t’iu dhënë atyre shpresë në rrethana të caktuara historike.

²⁶ · Mbi Zbulesën si profeci shih sid. Frederick D. Mazzaferri, *The Genre of the Book of Revelation from a Source—Critical Perspective* (Berlin and New York: de Gruyter, 1989).

²⁷ · Shih sid. Allan A. Boesak, *Comfort and Protest: Reflections on the Apocalypse of John of Patmos* (Philadelphia: Westminster, 1987); Elizabeth Schüssler Fiorenza, *The Book of Revelation: Justice and Judgement* (Philadelphia: Fortress, 1985).

Kjo do të thotë që parimi më themelor hermeneutik²⁸ që dubet ndjekur në interpretimin e Zbulesës është të kërkojmë domethënie që do të kishin qenë të kuptueshme për të krishterët e Azisë së Vogël në shekullin e parë, dhe jo kuptime të fshehura të deshifrueshme vetëm nga njerëz shekuj më vonë, që mendojnë se mund të jetojnë në ditët e fundit para kthimit të Krishtit.²⁹

Ky përfundim shpeshherë vihet në dyshim nga ata që citojnë Danielin 12:4,8-10, veprën më të famshme profetike-apokaliptike të Dhiatës së Vjetër. Aty profetia iu tha nga Perëndia ta vuloste librin, sepse njerëzit do t'i kuptonin plotësisht fj alët e tij vetëm në një kohë shumë më të vonë, dhe atëherë vetëm “njerëzit e ditur.” Por Zbulesa 22:10, me qëllim kontraston me këtë këndvështrim, kur Zoti e urdhëron Gjonin: “Mos i vulos fj alët e profecisë së këtij libri, sepse koha është afër.” Ata që mendojnë se më shumë se 1900 vjetët që kanë kaluar, që kur shkroi Gjoni, e hedhin poshtë këtë pretendim, duhet të shikojnë diskutimin për 2 Pjetrit 3:8-9 më sipër.³⁰

²⁸ · Hermeneutik – (nga greqishtja, *hermenevo*, “interpretoj, përkthej, sqaroj”) që ka të bëjë me interpretimin e Biblës. Shkenca e interpretimit të Biblës quhet “hermeneutikë” (red. teol. F.M.).

²⁹ · Krahaso: Fee and Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, 254.

³⁰ · Fraza “më sipër” i referohet komentarit të 2 Pjetrit 3:8-9 në librin “From Pentecost to Patmos”: 481, nga i njëjti autor. (Shën. i Botuesit). Për një pamje të plotë të të tria gjinive letrare, ashtu siç shfaqen te Zbulesa, shih: David E. Aune, *Revelation 1-5* (Dallas: Word, 1997), lxx-xc.

Struktura dhe pikat kryesore

Pjesët e strukturës së apokalipsit të Gjonit janë shumë të qarta. Kapitulli 1 prezanton librin, kapitujt 2-3 formojnë letrat për shtatë kishat, 4-5 paraqesin një pamje të lavdërimit qiellor dhe 6-19 formojnë pjesën qendrore të librit me tri seritë prej shtatë gjykimesh të portretizuara si vula, bori dhe kupa të zemërimit të Perëndisë. Kapitulli 20 përmban vegimin e mijëvjeçarit, ndërkohë që kapitujt 21-22 përshkruajnë jetën e përjetshme – qiejt e rinj dhe tokën e re.

Debati më i ndërlikuar strukturor vërtitet rreth marrëdhënies së tri serive të gjykimeve në kapitujt 6-19, sidomos për shkak se midis këtyre serive ndërhyjnë disa segmente të tekstit që janë quajtur shpesh “interlude” (7:1-17; 10-11:14; 12:1-14:20). Interludet nuk është se na çojnë përpara drejt ditës së gjykimit dhe disa herë duken si pamje të gjalla të skenave historike të kaluara ose edhe të ardhme.

Mënyra më e thjeshtë e kuptimit të tri shtatave i koncepton ato në radhë lineare ose *kronologjike*. Kjo e shpjegon mirë intensitetin gjithnjë në rritje të ashpërsisë

Një gjini e katërt që disave u duket se hyn në lojë është ajo e dramës. James L. Blevins (*Revelation as Drama* [Nashville: Broadman, 1984]) thotë, p.sh. se apokalipsi u shkrua me synimin që të luhej si një dramë me shtatë akte. I lidhur ngushtë me këtë është sugjerimi se struktura dhe funksioni i librit kanë ngjashmëri me liturgjinë e adhurimit të komunitetit të krishterë. Krah. Jose A. Filho, “Th e Apocalypse of John as an Account of a Visionary Experience: Notes on the Book’s Structure,” *JSNT* 25(2002): 213-34; me Paulo A. De Souza Nogueira, “Celestial Worship and Ecstatic-Visionary Experience,” *JSNT* 25 (2002): 165-84.

së gjykimeve, nga seria e parë, deri në serinë e tretë. Për shembull, gjykimet e vulave duket se prekin shumë-shumë një të katërtën e tokës (6:8), boritë mundojnë një të tretën e planetit (8:7, 8, 9, 10, 11, 12), ndërsa gjykimet e kupave nuk kanë ndonjë kufi zim gjeografi k (16:1-21).

Nga ana tjetër, gjykimi i gjashtë në secilën seri duket sikur del jashtë renditjes kronologjike, duke na sjellë mu në prag të mbarimit të botës, duke përshkruar trazira kozmike që nuk mund ta lejojnë universin e sotëm të mbetet në ekzistencë (6:12-17; 9:13-21; 16:17-21).


Megjithatë, në secilin rast, tregimi i Gjonit vazhdon për njëfarë kohe sikur qiejt dhe toka të mos ishin shkundur aq fort, sa e përshkruajnë këto fatkeqësi.³¹

Si rezultat, shumë i kanë parë këto tri shtata si *ripërsëritëse*, që përshkruajnë të njëjtën periudhë të një mundimi të madh nga këndvështrime të ndryshme. Por kjo e bën të vështirë për të shpjeguar rritjen e intensitetit nga njëra seri në tjetrën. Prandaj, ndoshta mundësia më e mirë është e treta. *Gjykimi i gjashtë në secilën seri vërtet nga një këndvështrim na sjell më afër fundit, ndërsa i shtati nuk është se na çon shumë përpara në kohë, por na prezanton serinë e radhës. E thënë më mirë, ajo e përmban serinë e radhës. Do të ishte*

³¹ . Marko Jauhainen ("Recapitulation and Chronological Progression in John's Apocalypse: Towards a New Perspective," NTS 49 [2003]: 54359), megjithatë thotë se vula e gjashtë shënon fi llimin e "Ditës së Zotit", ndërsa boria e gjashtë shënon fundin e kohës gjatë së cilës jobesimtarët mund të pendohen ende. Kështu, ai shpjegon trazirat e pazakonta që shoqërojnë gjykimet, pa iu larguar këndvështrimit kronologjik.

sikur dikush të vinte një xham zmadhues mbi vulën e shtatë dhe, duke bërë këtë, të mund të shikonte shtatë boritë e fshehura aty dhe, në mënyrë të ngjashme, në borinë e shtatë mund të shihen të shtatë kupat.

Duke iu afruar humnerës



Ky është quajtur shpesh *këndvështrimi teleskopik*.³²

Një ndarje shumë më e thjeshtë në tri pjesë e gjithë librit gjendet në vargun 1:19. Këtu Krishti e urdhëron Gjonin: “Shkruaj, pra, gjërat që pe, ato që janë dhe ato që do të ndodhin pas atyre.”

³² · Një mënyrë tjetër për të menduar për këtë këndvështrim është të imagjinosh një person që ecën drejt një shkëmbi (pesë vulat e para), hedh një shikim poshtë (vula e gjashtë), kthehet mbrapsht i tmerruar, ndjek një shteg paralel me buzën e shkëmbit për një farë kohe, pastaj shkon përsëri drejt buzës, kësaj here nga një pikë më e afërt nisjeje (vula e shtatë, që prezanton pesë boritë e para), shikon përsëri poshtë (boria e gjashtë), tërhiqet përsëri, por duke ndjekur një shteg tjetër paralel drejt shkëmbit shkon edhe më tutje, pastaj ecën përsëri për të fundit herë nga një pikënisjeje më e afërt (boria e shtatë, që paraqet të pesë kupat), shikon poshtë edhe një herë (kupa e gjashtë) vetëm për t’u shtyrë nga buza e shkëmbit e poshtë (kupa e shtatë). Nuk e kam sajuar unë këtë diagram, por nuk kam mundur ta kujtoj ku e kam parë. Për diagrame të mira që i paraqesin të tri këndvështrimet të strukturuar (shumë më thjesht!), shih H. Wayne House, *Chronological and Background Chartsof the New Testament* (Grand Rapids: Zondervan, 1981), 146.

Një interpretim i natyrshëm i këtij udhëzimi, duke supozuar që Zbulesa është rezultat i bindjes së Gjonit, është që kapitulli 1 përshkruan ato që ai i ka parë, deri në kohën kur i është dhënë ky urdhër. Kapitujt 2-3 (dhe ka mundësi edhe 4-5, sepse i vetmi tregues kohor për ta është që ngjarjet ndodhin pas veprës shpenguese të Krishtit – 5:5-6)³³ atëherë tregojnë “ato që janë,” duke përshkruar gjendjen aktuale shpirtërore të shtatë kishave. Kapitujt 6-21, përshkruajnë ngjarje që, për Gjonin, janë ende në të ardhmen.

Ky këndvështrim, kohët e fundit, nuk është shumë i preferuar, por duket se është gjithsesi i mbrojtshëm.³⁴ Të tjerë fokusohen në ato që ata besojnë se janë shtatë seksione kryesore, disa herë të para si kiaslike (*Kiaxëm është një fi gurë letrare stilistike, në të cilën një seri prej 2 ose më shumë elementesh ndiqen nga një seri tjetër, që ju korrespondojnë elementeve*

³³ . Kap. 4:1 tregon që një zë qiellor i premtoi Gjonit se do t'i tregonte “gjërat që duhet të ndodhin pas këtyre gjërave.” Por ky premtim përmbushet vetëm ndërsa Qengji fi llon të hapë vulat në 6:1. Kapitujt 4-5 përmbajnë lavdërime himnore për Perëndinë dhe Qengjin, që ka të ngjarë të kenë ndodhur në Qiell që nga koha e ringjalljes së Jezusit.

³⁴ . John F. Walvoord, *The Revelation of Jesus Christ: A Commentary* (Chicago: Moody, 1966), 47-49. Argumenti kryesor kundër këtij këndvështrimi është që në *çdo* seksion të librit ka material të lidhur me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, por kjo nuk na pengon të dallojmë se në secilën pjesë dominon njëra nga këto. Propozimi më i zakonshëm sot e interpreton këtë varg sikur e ndan librin në dy kohë (foljore): “ato që pe” bën fj alë për gjithë serinë e zbulesave, që pastaj ndahet sërish në të tashme (“ato që janë”) dhe në të ardhme (“ato që do të ndodhin pas atyre”). G.K.Beale (*The Book of Revelation* [Carlisle: Paternoster; Grand Rapids and Cambridge: Eerdmans, 1999], 152-70) bën një përmbledhje dhe analizë të plotë të këtyre dhe të tjera mundësive, duke propozuar një këndvështrim që i sheh të tria pjesët e nënrenditura në 1:19, sikur i referohen gjithë librit.

të para në rend të kundërt. Zakonisht elementi në mes të strukturës pasqyron thelbin e asaj që do të komunikojë autori - Shën. i botuesit) në renditje, duke i korresponduar shpeshtësisë së numrit shtatë, si simbol i plotësisë, gjatë gjithë librit.³⁵

Duke rrezikuar t'i imponojmë më pak strukturë përkundër stërhollimit strukturor të apokalipsit të Gjonit, ne propozojmë një ndarje të përgjithshme që është më shumë tematike, duke e ndarë tekstin në segmente prej një deri tre kapitujsh secilin dhe pastaj duke e nënndarë secilin segment.

³⁵ · Shih shqyrtimin e këndvështrimeve po aty, në referencën numër 34, faqja: 127-37.

E <u>kaluara</u>	{	Kap. 1
E <u>tashmja</u>		Kap. 2-3 Kap. 4-5
E <u>ardhmja</u>	{	Kap. 6-19 Kap. 20-22

Hyrja
<u>Letra drejtuar shtatë kishave</u>
<u>Lavdërimi Qiellor</u>
Shtatë Shtatë Shtatë kupat zemërimit të
<u>Mijëvjecari</u> <u>Oiej të rinj dhe tokë e re</u>

Zbulesa

Hyrja (1:1-20) A. Prologu (1:1-3)

B. Përshëndetja dhe dedikimi (1:4-8)

C. Ngarkimi me detyrë i Gjonit (1:9-20)

I. Letrat shtatë kishave (2:1-3:22)

A. Efesit: Humbja e dashurisë së parë
(2:1-7)

B. Smirnës: Qëndresë me gjithë
vështirësitë
(2:8-11)

C. Pergamit: Përzierje e besimit me
imoralitetin
(2:12-17)

D. Tiatirës: Ngatërrimi i djallëzores
me hyjnoren (2:18-29)

E. Sardës: Pothuaj e vdekur (3:1-6)

F. Filadelfi së: E bindur dhe besnike
(3:7-13)

G. Laodicesë: E papishme dhe e
padobishme
(3:14-22)

II. Lavdërimi qiellor (4:1-5:14)

A. Për Perëndinë (4:1-11)

B. Për Qengjin (5:1-14)

- III. Shtatë vulat dhe interludi i parë (6:1-8:5)
 - A. Gjashtë vulat e para (6:1-17)
 - B. Të 144 mijët dhe turma e madhe që askush nuk mund ta numërojë (7:1-17)
 - C. Vula e shtatë (8:1-5)
- IV. Shtatë boritë dhe interludi i dytë (8:6-11:19)
 - A. Gjashtë boritë e para (8:6-9:21)
 - B. Libërthi (10:1-11)
 - C. Dy dëshmitarët (11:1-14)
 - D. Boria e shtatë (11:15-19) VI.

Triniteti satanik:

Ngritja dhe rënia e afërme (12:1-14:20)

- A. Dragoi (12:1-17)
- B. Bisha e parë (13:1-10)
- C. Bisha e dytë (13:11-18)
- D. Fitorja e Qengjit mbi trinitetin satanik (14:1-20)

1.Përsëri të 144 mijët (14:1-5)

2.Tre engjëjt (14:6-13)

3Dy korret (14:14-20)

VII. Shtatë kupat (15:1-16:21)

A. Lavdërimi qiellor përgatit skenën për Gjykimet e Kupave (15:1-8)

B. Fillojnë Gjykimet e Kupave (16:1-21) VIII. Mposhtja e Fuqive të Këqia nga

Mbretëria e Krishtit (17:1-20:15)

A. Fundi i Perandorisë së Keqe të Kohëve të Fundit (17:1-18:24)

1. Përmasat fetare dhe politike (17:1-18)
2. Përmasat ekonomike (18:1-24)
- B. Vendosja e Mbretërisë së Krishtit (19:1-20:15)
 1. Ardhja e dytë (19:1-20:3)
 2. Mijëvjeçari (20:4-15)
- IX. Qiejt e rinj dhe toka e re (21:1-22:21)
 - A. Përjetësia (21:1-22:6)
- Mbyllja (22:7-21)

Këndvështrimet interpretuese

Numri i këndvështrimeve dhe kombinimeve të përqasjeve ndaj Zbulesës e bën të pamundur trajtimin e gjithë mundësive të mundshme interpretuese për çdo fragment të librit. Ajo që mund të bëjmë është të vëmë në dukje këndvështrimin e përdorur këtu dhe t'i drejtojmë lexuesit të shkrime të tjera që i shpjegojnë më me hollësi gjithë mundësitë.

Këndvështrimet e mijëvjeçarit

Ka një debat interpretues në lidhje me rolin e periudhës njëmijëvjeçare të përshkruar në 20:4-15. *Paramijëvjeçaristët*³⁶ besojnë se Krishti do të kthehet përpara

³⁶ . Paramijëvjeçarizëm, pasmijëvjeçarizëm dhe jomijëvjeçarizëm – këto terma, si dhe ato që rrjedhin prej tyre në latinisht (dhe si rrjedhojë, në anglisht) gjenden në format e mëposhtme: premillennialism,

kësaj epoke të artë të historisë njerëzore. *Pasmijëvjeçaristët* e shohin në të kundërt rrjedhën e këtyre ngjarjeve. *Jomijëvjeçaristët* e shikojnë mijëvjeçarin (mileniumin), ose si shpirtëror dhe që ndodh në të njëjtën kohë me mbretërimin e Krishtit në zemrat e besimtarëve (dhe në qiell), ose e barazojnë me qiejt e rinj dhe tokën e re që do të vijë. Siç do ta shpjegojmë më poshtë, është e vështirë ta kuptojmë se si mund të futet një pushim kronologjik midis 19:21 dhe 20:1, siç kërkohet në pikëpamjet jomijëvjeçariste dhe pasmijëvjeçariste. Rebelimi në fund të mijëvjeçarit (20:11-15) e bën të vështirë barazimin e kësaj periudhe me përjetësinë. Kjo do të thotë që pikëpamja që mban autori është ajo paramijëvjeçariste.

Por, sidomos në bazë të kohës kur ndodh rrëmbimi i Kishës, paramijëvjeçarizmi nënndahet në paramijëvjeçarizëm *dispensacional*³⁷ (ose *paramijëvjeçarizëm regjimesh kohore*) dhe *klasik/historik*.³⁸

postmillennialism dhe amillennialism. Këto janë termat të përdorura në tekstin original të librit. (red. teol. F.M.).

³⁷ · Dispensacional, dispensacionalizëm – interpretimi biblik, sipas së cilit Perëndia është lidhur me qeniet njerëzore në mënyra të ndryshme nën besëlidhjet e ndryshme biblike, nëpërmjet një serie “rendesh” (anglisht: dispensations) ose periudhash historike (red. teol. F.M.).

³⁸ · Për këndvështrimet e ndryshme, shih: sid. Robert G. Clouse, ed., *The Meaning of the Millennium: Four Views* (Downers Grove: IVP, 1977); Millard J. Erickson, *A Basic Guide to Eschatology: Making Sense of the Millennium* (Grand Rapids: Baker, re. 1999).

Lidhja midis rrëmbimit dhe mundimit

Në mënyrë tipike, pasmijëvjeçarizmi, jomijëvjeçarizmi dhe paramijëvjeçarizmi klasik mbështesin rrëmbimin e kishës *pas mundimit të madh*. Kjo do të thotë që rrëmbimi i besimtarëve në ajër për të takuar Krishtin që zbret (kujtoni diskutimin te 1 Selanikasve 4:17) ndodh në të njëjtën kohë me zbritjen përfundimtare të Krishtit në tokë – ajo që zakonisht quhet “Ardhja e Dytë.” Paramijëvjeçaristët dispensacionalë, nga ana tjetër, janë normalisht *paramundimistë*³⁹, d.m.th., mendojnë se rrëmbimi i fshehtë i besimtarëve nga toka në qiell ndodh para periudhës së përshkruar si “mundimi i madh,” periudhë e cila vetë i paraprin ardhjes së dytë. Disa paramijëvjeçaristë nga të dyja anët (klasike dhe dispensacionale/regjimiste) kanë propaganduar një rrëmbim *në mes të mijëvjeçarit*, bazuar kryesisht në mënyrën se si e kuptojnë ata kapitullin 11 (shih më poshtë). Sipas kësaj pikëpamjeje, kisha e përjeton gjysmën e parë të mundimit në tokë, por jo të dytën. Kohët e fundit, disa paramijëvjeçaristë e kanë modifi kuar këtë këndvështrim në atë që ata e quajnë rrëmbimi *para zemërimit*, sepse merakut i tyre kryesor është që kisha të mos përjetojë zemërimin e Perëndisë të derdhur mbi tokë, jo që ajo të përjashtohet nga i gjithë mundimi. Por ata nuk

³⁹ . Paramundimist, paramundimizëm – në anglisht (e prejardhur nga latinishtja) fjalë është “pretribulationist” dhe “pretribulationizëm”. (red. teol. F.M.).

pretendojnë se e dinë me saktësi se kur, gjatë mundimit, duhet të ndodhë rrëmbimi.

Ne kemi argumentuar tashmë për një rrëmbim *pas mundimit të madh*, bazuar në të vetmin tekst biblik që e përdor termin mbi të cilin bazohet fjala “rrëmbim.”⁴⁰ Do të shohim se këndvështrimi i mësipërm ka më shumë kuptim këtu, duke vërejtur në komentarin më poshtë arsyet se pse tekstet në Zbulesë, që shpesh merren për të mbështetur një këndvështrim tjetër, sipas mendimit tonë, nuk na çojnë në ato drejtime.⁴¹

Këndvështrimi historik

Vendimi i fundit madhor interpretues që duhet marrë vjen si rezultat i të kuptuarit të pikëpamjes që mbështet Zbulesa: mbështet *futurizmin* – vështrimin e ngjarjeve në kapitujt 6-19, si ende në të ardhmen nga këndvështrimi i Gjonit (dhe ende në të ardhmen nga këndvështrimi ynë sot); *preterizmin* – vështrimin e atyre ngjarjeve si të plotësuara në ato që ndodhën deri në vitin 70 pas Krishtit, duke përfshirë edhe vitin 70, referuar kështu ngjarjeve gjatë jetës së Gjonit që, nga këndvështrimi ynë, janë në të kaluarën e largët; *historizmin* – të kuptuarit e ngjarjeve si

⁴⁰ · Bëhet fjala për pasazhin te 1 Selanikasve 4:17 ku është përdorur fjala “rrëmbim” në tekstin shqip (lat. raptus). Shiko “From Pentecost to Patmos”; 147-48 (Shën. i Botuesit)

⁴¹ · Për pikëpamjet e ndryshme, shih: sid. Richard Reiter, ed., *The Rapture: Pre-, Mid- or Post-Tribulational* (Grand Rapids: Zondervan, 1984); Marvin J. Rosenthal, *The Pre-Wrath Rapture of the Church* (Nashville: Nelson, 1990).

të përmbushura progresivisht gjatë gjithë historisë së kishës, duke lënë vetëm më të keqen ende në të ardhmen nga këndvështrimi ynë; apo *idealizmin* – kuptimin e ngjarjeve si simbolike të betejës së pakohë midis të mirës dhe të keqes, gjatë gjithë epokës së kishës.⁴²

Nuk diskutohet që beteja e përshkruar gjatë gjithë Zbulesës është ripërsëritur shpesh në historinë e kishës, madje edhe në historinë e botës, prandaj këndvështrimet idealiste dhe historiciste kapin të vërteta kyçe. Në mënyrë të ngjashme, shumë nga ngjarjet e shekullit të parë përkonin më specifi kisht me shumë nga gjykimet e përshkruara në gjithë apokalipsin e Gjonit. Nëse Gjoni donte që bashkësitë e tij të shekullit të parë të kuptonin diçka nga vegimet e papërshkrueshme që përjetoi ai, do të përdorte natyrshëm ngjarje të kohës së tij, për t'i ndihmuar njerëzit të kuptonin domethënien e atyre vegimeve. Por, meqenëse të tria këto pikëpamje, në mënyrë tipike, e mohojnë një plotësim më të tmerrshëm, ende në të ardhmen të gjykimeve të përshkruara në këtë libër apo një periudhë të fundme mundimi të pashoq që do t'i paraprijë ardhjes së dytë, do të na duhet të rezervohemi dhe t'i mbahemi një këndvështrimi kryesisht

⁴² · Për lexime paralele të apokalipsit nga secili prej këtyre katër këndvështrimeve, shih: Steve Gregg, *Zbulesa: Four Views – A Parallel Commentary* (Nashville: Nelson, 1997). Për një krahasim të këndvështrimeve preteriste, idealiste, dispensacionaliste progresive (shumë më afër këndvështrimit paramijëvjeçarist historik, sesa atij dispensacionalist), dhe këndvështrimit dispensacionalist klasik, shih: C. Marvin Pate, ed. *Four Views on the Book of Revelation*. (Grand Rapids: Zondervan, 1998).

futurist, pa injoruar elementet e vërteta në të tria këndvështrimet e tjera.⁴³

Prirjet gjatë historisë së kishës

Është interesante të vëmë re se paramijëvjeçarizmi historik mbizotëroi në kishën pre-agustiniane të tre shekujve të parë të shkrimeve të Etërve, megjithëse mund të gjendet aty edhe pak jomijëvjeçarizëm. Që nga Agustini e këtej, Kisha Katolike Romane u bë gjithnjë e më jomijëvjeçare. Disa nga reformatoret protestantë e ruajtën këtë pikëpamje; të tjerë fi lluan të kthehen te paramijëvjeçarizmi. Pasmijëvjeçarizmi ka qenë pikëpamja me më pak mbështetje nga të tria gjatë gjithë historisë së kishës, por ka dalë në pah sidomos në kohërat e lëvizjeve të mëdha misionare dhe të zgjerimit të kishës. Në kohëra të tilla, duket sikur Fryma e Perëndisë do të përdorë të krishterët për të sjellë mijëvjeçarin, madje përpara Ardhjes së Dytë. Shekulli i 19-të i krishtëritimit, në Europën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut, ishte koha më e bujshme e pasmijëvjeçarizmit. Pasmijëvjeçarizmi ka patur prirjen të ndjekë një pikëpamje preteriste; jomijëvjeçarizmi një pikëpamje idealiste; paramijëvjeçarizmi një pikëpamje futuriste, ose me raste, një pikëpamje historiciste.

Paramijëvjeçarizmi dispensacionalist dhe, në mënyrë specifi ke, rrëmbimi para mundimit është, në një shkallë

⁴³ · Krahaso: Osborne, *Revelation*, 21-22.

të madhe, produkt i denominacionit “Vëllezërit e Plimuthit” (Plymouth Brethren), themeluar nga Xhej Nelson Darbi (J. Nelson Darby) në Skoci, në vitet 1830, dhe që aty i transplantuar në Amerikë, ku lulëzoi, në veçanti, në sajë të shënimeve për studimin e Biblës të shkruara nga Skofi Ildi (C.I.Scofi eld) dhe të shkrimeve voluminoze të Luis Sperri Çejfërit (Lewis Sperry Chafer), themeluesi i Seminarit Teologjik të Dallasit. Dispensacionalizmi, gjithashtu, formoi kolegje biblike të panumërta në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera, duke i bërë të mirënjohura këndvështrimet e veta interpretuese të Shkrimeve në gjithë krishterimin konservator në mbarë botën. Në dekadat e fundit dhe në një nivel më popullor, veçanërisht përmes shkrimeve “që sjellin fakte dhe informacione” të Hal Lindsit (Hal Lindsey) dhe serisë së romaneve “Left Behind” (në shqip “Fillimi i fundit”) të Tim LaHejit dhe Xherri Xhenkinsit (Tim LaHaye, Jerry Jenkins) kjo rrymë ka çuar në një këndvështrim të tillë ndaj Zbulesës, që i sheh profecitë e saj të përmbushura në ngjarjet e sotme. Por, nga ana tjetër, edhe pikëpamjet e tjera kanë nxjerrë interpretimet e tyre se si të njëjtat profeci janë përmbushur në epokat e tyre, gjatë gjithë historisë. I vetmi vëzhgim i padiskutueshëm në lidhje me këto pretendime është që, deri ditën e sotme, *100% e tyre kanë dalë të gabuara, fakt që duhet të na paralajmërojë të mos u besojmë shumë skenareve specifi ke të cilitdo autor.*⁴⁴

⁴⁴ · Për më shumë mbi këndvështrimet e ndryshme përgjatë gjithë historisë së kishës, shih: sid. Arthur W. Wainwright, *Mysterious Apocalypse*:

KOMENTAR

Prologu (1:1-3)

Ashtu si Ungjilli i Gjonit dhe Letra e Parë e Gjonit, edhe Apokalipsi fi llon me një prolog që ka në qendër Krishtin. Por këtu fokusi është më shumë në natyrën e zbulesës që Gjoni po merr. “E bëri të ditur” në vargun 1 është fj alë për fj alë “tregoi me fi gura,” duke e përgatitur lexuesin për faktin që ky komunikim do të bëhet me anë të shenjave dhe simboleve.⁴⁵ Afërsia e fundit e shpallur këtu duhet interpretuar si në 2 Pjetrit 3:8 dhe Psalmin 90:4. Ajo na kujton, gjithashtu, për ato që kemi parë vazhdimisht që nga Veprat 2:17 e tutje – që ditët e fundit fi lluan me Rrëshajët dhe kanë vazhduar që atëherë. Ky është, gjithashtu, i vetmi libër në Dhiatën e Re që premton qartë një bekim për ata që e lexojnë dhe e marrin për zemër, kështu që, nëse e lëmë pas dore, është në dëmin tonë, megjithëse duhet punë për ta interpretuar drejt, në vend që ta keqpërdorim, siç kanë bërë shumë njerëz.

Përsëndetje dhe kushtim (1:4-8)

Gjoni iu dërgon të shtatë kishave përsëndetjen greke “hír” dhe bekimin hebraik “paqe,” që të dy të krishterizuar, sepse vijnë nga Perëndia trini – Ati i

⁴⁵ · Krahaso: Osborne, *Revelation*, 55.

përjetshëm, “të shtatë frymërat” [d.m.th. e plotë]⁴⁶ dhe nga Jezu Krishti (vv. 4-5a). Ai pastaj ofron një doksologji (lavdërim) të veçantë për Krishtin, si mirënjohje për shpengimin që Ai ka përmbushur dhe Mbretërinë që ka krijuar për besimtarët, të cilët tani kanë hyrje të drejtpërdrejtë priftërore tek Ati (vv. 5b-6). Këto vargje sugjerojnë atë që do të bëhet më e qartë, ndërsa shpaloset libri: teologjia e tij është shumë më e pasur, sesa thjesht deklarata për fundin e botës.⁴⁷ Në lidhje me eskatologjinë,⁴⁸ parimi qëndror del në vargun 7: *Krishti do të kthehet në tokë me triumf, në mënyrë publike, të dukshme, dhe të gjithë do të vajojnë*. Te Zakaria 12:10, ky tekst i referohet qartazi vajtimit të pendimit nga ana e besimtarëve, por në mënyrën se si e përdor atë Jezusi te Mateu 14:30, ai mund të përfshijë edhe hidhërimin e gjykimit për jobesimtarët. Vargu 8 është i rëndësishëm, sepse konceptet e tij do të

⁴⁶ · Mënyra tjetër për ta përkthyer këtë është “shtatë frymërat” (shën. i përkthyesit: ky koment është ngaqë në anglisht shprehja më shpesh është përkthyer “shtatë Frymërat”, pra, me shkronjë të madhe, kurse në shqip e kemi me shkronjë të vogël në LIM), duke i kuptuar ato si ushtri engjëjlore që rrethojnë Perëndinë, por, meqë këto “frymëra” diku tjetër specifi kohen si “e Perëndisë dhe të Qengjit” (3:1; 4:5; 5:6), është më mirë t’i shohim ato si një paraqitje të Frymës së Shenjtë në gjithë plotësinë e Tij. Shih: sid. Bauckham, *The Theology of the Book of Revelation*, 11015.

⁴⁷ · Shih sid. Graeme Goldsworthy, *The Gospel in Revelation*. (Exeter: Paternoster, 1984; Nashville: Nelson, 1985).

⁴⁸ · Eskatologji – nga greqishtja “*es-batos*” (“fund”), ajo degë e teologjisë biblike që merret me studimin e gjërave që lidhen me ngjarjet e fundit të historisë dhe destinacionin përfundimtar të njerëzimit (red. teol. F.M.).

përsëriten në vargjet 17-18, kësaj here jo nga Zoti Perëndi, por nga Jezusi, një tregues i qartë ky i hyjnisë së Krishtit.⁴⁹

Detyra e Gjonit (1:9-20)

Gjoni e mbyll këtë hyrje, duke përshkruar ngjarjet që çuan të merrte bojë e papirus për të shkruar këtë dokument. Përndjekja e Domicianit sapo ka fi lluar të prekë një pjesë të lexuesve të tij. Edhe Gjoni vetë është internuar në ishullin e Patmosit dhe është “pjesëtar në pikëllimin” që kanë ata në Jezusin, si rezultat i besimit të tyre të përbashkët (v.9). Një të diel, ndërsa po adhuronte (vetëm?), Gjoni pati një përjetim ekstatik, që përmbante një vegim të “birit të njeriut” të lartësuar – d.m.th. Jezusit në rolin e përshkruar nga Danieli 7:13-14.⁵⁰ Ky Bir njeriu u shfaq në mes të shtatë shandanëve (v.12), që simbolizojnë të shtatë kishat (v.20). Pjesëve individuale të këtij vegimi – rrobës së Jezusit, brezit, fl okëve, syve, e kështu me radhë (vv. 13-16), nuk iu duhet dhënë domethënie e pavarur alegorike. Së bashku, ato krijojnë një pikturë të fuqishme të Krishtit, gjykatësit të lavdishëm e madhështor.⁵¹ Pasi e identifi kon veten, Jezusi e ngarkon

⁴⁹ · Një tipar intrigues i përkthimit “Bota e Re” të Biblës që përdorin “Dëshmitarët e Jehovahit” është se, ndërkohë që tekste më të qarta që pohojnë hyjninë e plotë të Jezusit janë përkthyer në mënyrë të tillë që ta fshehin këtë doktrinë, këto fragmente nuk janë ndryshuar, kështu që edhe përkthimi Bota e Re mund të përdoret për të demonstruar hyjninë e Krishtit.

⁵⁰ · Shih Blomberg, *Jesus and the Gospels*, 405-7 dhe literaturën e cituar atje.

⁵¹ · Ndoshta portretizuar i ngjashëm me engjëjt e lartësuar, si një urë midis monoteizmit të pastër hebre dhe mendimit trinitar të zhvilluar plotësisht

Gjonin të shkruajë këtë libër. Nëse vargu 19 nuk është referencë për ndarjen e shkuar-e tashme-e ardhme të librit (shih më sipër), atëherë “gjërat që pe” mund t’i referohet të gjithë vëllimit, me vegimet e së tashmes, (“ato që janë”) dhe të së ardhmes (“ato që do të ndodhin pas atyre”).⁵²

Të shtatë yjet që përfaqësojnë “ëngjëjt” e të shtatë kishave i kanë bërë vazhdimisht komentatorët të ngrejne supet. Fjala *angelos* do të thotë “lajmëtar,” prandaj disa përfytyrojnë me të letërprurësit apo pastorët, por kudo tjetër në Dhiatën e Re kjo fj alë u referohet gjithmonë qenieve të mbinatyrshme, kështu që shumica besojnë se Gjoni e ka fj alën për idenë hebreje që gjendet ndoshta pas vargjeve të 1 Korintasve 11:10 për engjëj që ruajnë kishat gjatë adhurimit.⁵³ Sido që të jetë, është e qartë se mesazhet që do të shkruajë janë për kishat e vërteta të Azisë së Vogël.

Letra drejtuar shtatë kishave

Të shtata letrat kanë struktura shumë të ngjashme.

Forma e përgjithshme është: kujt i drejtohet, identifi kimi i folësit (Krishti), lavdërimi, kritika, kërcënimi i gjykimit, thirrja për të dëgjuar dhe premtimi për ata që “fi tojnë,” d.m.th. për ata që i

pas Dhiatës së Re. Shih: sid. Peter R. Carrell, *Jesus and the Angels: Angelology and the Christology of the Apocalypse of John* (Cambridge and New York: CUP, 1997).

⁵² · Shih: p.sh. Mounce, *Revelation*, 62

⁵³ · Krahazo më tej: Jürgen Roloff, *Revelation: A Continental Commentary* (Minneapolis: Fortress, 1993), 38-40.

mbeten besnikë Jezusit në kohë të vështira. Paralelizmat me dekretet perandorake sugjerojnë që këto letra tregojnë se urdhërat mbretërorë të Perëndisë kanë përparësi mbi ato të Cezarit.⁵⁴⁵⁵ Dy kisha nuk marrin kritika: Smirna dhe Filadelfi a. Dy nuk marrin ndonjë lavdërim formal: Sarda dhe Laodicea. Të shtatë kishat, në këtë mënyrë, pasqyrojnë spektrin e plotë të besnikërisë dhe mosbesnikërisë së pranishme në çdo epokë të historisë së kishës.⁵⁶

Efesi: Humbja e dashurisë së parë (2:1-7)

Ata që mbetën në doktrinën e shëndoshë, me gjithë ndërhyrjet e heretikëve (kujtoni letrat e Gjonit), e kishin fituar betejën teologjike, por kishin humbur betejat e sjelljes dhe të frymës. Asgjë nuk dihet për nikolaitët (v.6), përveçse ky emër në greqisht do të thotë: “ata që fitojnë mbi njerëzit”. Në 2:15 ata lidhen me mbështetësit idhujtarë dhe imoralë të Balaamit, emri i të cilit, në mënyrë interesante, ka të njëjtin kuptim në hebraisht. Efesianëve

⁵⁴ . David E. Aune, “Th e Form and Function of the Proclamations to the Seven Churches (Revelation 2-3),” NTS 36 (1990): 182-204; Nestor p. Friedrich, “Adapt or Resist? A Socio-Political Reading of Revelation

⁵⁵ .18-29,” JSNT 25 (2002): 185-211.

⁵⁶ . Vepra më e saktë dhe më e detajuar që na jep për informacion mbi këto shtatë qytete, për të na ndihmuar t’i deshifrojmë vegimet unike që Perëndia i dha secilit, është Colin J. Hemer, *Th e Letters to the Seven Churches of Asia in their Local Setting* (Sheffield: JSOT, 1986). Disi më të lehtë për t’u lexuar janë dy librat nga Roland H. Worth Jr., *Th e Seven Cities of the Apocalypse and Roman Culture* dhe *Th e Seven Cities of the Apocalypse and Greco-Asian Culture* (New York: Paulist, 1999).

u bëhet thirrje të pendohen dhe të bëjnë veprat e para (v.5), një tregues që lënia e dashurisë së tyre të parë (v.4) nuk është kryesisht një deklaratë për mungesën e zellit emocional, por një problem me shprehjen në praktikë të besimit.⁵⁷ Ata ishin më të mirë në mbajtjen e së vërtetës, sesa në dashurinë ndaj Perëndisë apo të tjerëve; krahasojë këtë me ata që i mbajnë sytë hapur për të kapur herezi në ditët e sotme. Kërcënimi për lëvizjen e shandanit nga vendi – marrjen fund të kishës në Efes – u realizua afër fundit të shekullit të dytë bashkë me rënien e gjithë qytetit.⁵⁸ Premtimi i pemës së jetës (v.7) bën kontrast të fortë me statujën prej lisi të kultit të Artemisë në qytet dhe të mbrojtjes që ajo ofronte.

Smirna: Qëndresë me gjithë vështirësitë (2:8-11)

Kjo është e para nga dy kishat për të cilat Gjoni nuk ofron dënim. Th eksimi i hyjnisë dhe ringjalljes së Jezusit (v. 8) janë të rëndësishme në kundërshtimin e kultit të perandorit që ishte i fortë në Smirna. Ky qytet e quante veten “i pari” midis qyteteve të Azisë së Vogël dhe e shikonte veten si të “ringjallur” në vitin 290 para Krishtit, pasi kishte qenë shkatërruar nga një mbret pushtues i

⁵⁷ · Në fakt, në kontekstin e luftës së komunitetit joanian me mësuesit e rremë, duket më e mundshme që ata duhet të përtërinin dashurinë për anëtarin e kishës që kishte ikur në rrugë të shtrembër me shumë sesa dashurinë për Perëndinë (Murphy, *Fallen is Babylon*, 115-16).

⁵⁸ · Megjithatë, shih: Osborne, *Revelation*, 108-9. Nuk është e sigurt nëse përpjekjet për të parandaluar mbushjen e portit të Efesit me lym, që çoi në rënien e qytetit, ishin të suksesshme apo jo.

Lidisë.⁵⁹ Për “sinagogën e Satanit” kujtoni ato që thamë më përpara. Kjo gjuhë nuk duhet përgjithësuar për të gjithë hebrenjtë. “Atyre që e quajnë veten judenj, por nuk janë” u referohet atyre, veprimtaria e të cilëve në përndjekjen e të krishterëve e mohon trashëgiminë e tyre fetare dhe etnike.⁶⁰ Smirna është qyteti ku pas afro tridhjetë vjetësh u martirizua Polikarpi, dishepulli i apostullit Gjon, dhe hebrenjtë mblodhën dru për turrën ku ai u dogj, megjithëse ishte e shtunë (*Mart.Pohc.* 13.1, 17.2)! Përndjekja dhjetëditore (v.10) – ndoshta përdoret një numër i rrumbullakosur për të treguar një periudhë të shkurtër, të kufi zuar vuajtjeje (kujtoni Danielin 1:1214).⁶¹ Një mbishkrim në Smirna, me sintaksë identike, fl et për një periudhë të tillë që do të zgjaste pesë ditë.⁶² Pavarësisht nga besnikëria e tyre, Perëndia nuk u dha asnjë garanci për bekime të jashtme në këtë jetë. Por, ata që do të fi tonin, do të merrnin një kurorë me dafi na – simbol i përshtatshëm i shpërblimit qiellor në një komunitet të

⁵⁹ · Po aty, 128

⁶⁰ · Krahaso më tej Beasley-Murray, *Revelation*, 82. Ai shton, “Kurrë nuk ka qenë kundërshtimi më i madh sesa në Smirna.” Mark R. J. Bredin (“Th e Synagogue of Satan Accusation in Revelation 2:9,” BTB 28 [1999]: 16064) shton sugjerimin se mosgatishmëria e të krishterëve për t’i paguar taksa Romës, që i përjashtonte judaistët nga përndjekja, i acaroi tensionet me sinagogën.

⁶¹ · Roloff, *Revelation*, 48-49.

⁶² · Hemer, *Th e Letters to the Seven Churches*, 69-70. Sjef van Tilborg (“Th e Danger at Midday: Death Th reats in the Apocalypse,” Bib 85 [2004]: 12) vëren se lojërat me gladiatorë me njerëz apo bisha të egra që luftonin me kriminelë të dënuar zgjasnin nga tre deri trembëdhjetë ditë dhe përputheshin mirë me llojin e vuajtjes që përshkruhet këtu.

mirënjohur për kurora të tilla, si emblemë e bukurisë së tij – në vend që të përjetonin vdekjen “e dytë” (d.m.th. të përjetshme, shpirtërore).

Pergami: Përzierja e besimit me imoralitetin (2:12-17)

Pergami ishte qendër e adhurimit të Zeusit, shërimeve asklepiane⁶³ dhe kultit të perandorit; kur Gjoni fl et për fronin e Satanit (v.13), mund të ketë patur parasysh secilën prej tyre ose të gjitha .⁶⁴ Asgjë tjetër nuk dihet për dëshmorin Antipa, por duket qartë që kjo kishë ka mbetur pjesërisht besnike ndaj Jezusit. Ata kanë ngrënë ushqim të fl ijuar idhujve, me sa duket në kontekstin e adhurimit pagan, i cili thuhet se përfshinte edhe marrëdhënie seksuale si ato me priftërinj apo priftëresha të tempujve paganë, me shpresë për të arritur bashkim me perënditë apo perëndeshat (v.14 e ka fj alën për Balaamin dhe Balakun, shih: Num. 24:14; 31:16). Kujtoni dënimin në 1 Korintasve 10:1-22. mbi nikolaitët, shih më sipër Zbulesën 2:6. Por imoraliteti këtu, ashtu si shpesh në Dhiatën e Vjetër, mund të jetë metaforë për mosbesnikërinë që pasqyronte idhujtaria. Shpërblimi për atë që do të fi tojë përfshin manën e fshehur – “bukën e jetës” që judenjtë besonin se do të rikthehej në fundin e kohërave dhe që Jezusi e siguroi në mënyrë frymërore në

⁶³ · Asklepi ishte perëndi i shërimit në mitologjinë greke, (shën. i përkthyesit.)

⁶⁴ · Mounce, *Revelation*, 79.

personin dhe shërbesën e vet (Gjoni 6:30-59). Një gur i bardhë mund të përdorej si biletë hyrjeje në një festë, si votë shfajësimi në gjyq, si shenjë e futjes në një grup fetar dhe si hajmali magjike që mbronte atë që e mbante.⁶⁵ Të gjitha këto përdorime gjejnë analogjitë e tyre shpirtërore në shpresën e të krishterit për të ardhmen. Emri i ri tregon rilindjen e besimtarit, që ka fi lluar tashmë, por që do të përmbushet plotësisht vetëm kur të kthehet Krishti.

Tiatira: Ngatërrimi i djallëzores me hyjnoren (2:18-29)

Në një qendër shoqërisht tregtare, Gjoni i referohet natyrshëm Jezusit si “ai që ka sytë si fl akë zjarri dhe këmbët e tij janë të ngjashme me bronz të shkëlqyeshëm” (v. 18), si veprat e qeramikës pasi i kanë mbijetuar furrës.⁶⁶ Tiatira, ashtu si Pergami, shfaqte elemente kyçe të besimit dhe shërbimit (v. 19), por mosbindje të tmerrshme që kishte të bënte me ushqime fl ijuar idhujve dhe imoralitet seksual. Këtë herë Gjoni e krahason qytetin me mbretëreshën Jezabel të Dhiatës së Vjetër, gruan mizore të Ashabit, kundër së cilës u profetizua gjykim dhe u zbatua

(vv. 20-23; krahaso: 1 Mbretërve 21:23 dhe 2 Mbretërve 9:33). Shprehja “thellësiat e Satanit, siç e quajnë ata” (v.

⁶⁵ · Krahaso Aune, *Revelation 1-5*, 190-91.

⁶⁶ · Aune, (po aty, 201) vëren mbizotërimin në Tiatira të shoqërive të “rrobapunuesve, bukëpjekësve, regjësve të lëkurëve, poçarëve, lipunuesve, tregtarëve të leshit, tregtarëve të skllëvërve, këpucarëve, ngjyrosësve dhe bakërxhinjve [sic].”

24) mund t'i referohet idesë gnostike⁶⁷ që njeriu duhet ta përjetojë në thellësi të keqen, për të treguar se është i imunizuar ndaj saj.⁶⁸ Krishti do t'i shkatërrojë ata në kishë që nuk pendohen, siç thyheshin enët e bukura të argjilës që prodhonte Tiatira (v. 27). Ylli i mëngjesit mund t'i referohet Venusit, simbolit të sovranitetit romak, dhe/ose Krishtit vetë (shih: 22:16; krahaso me Num. 24:17).

Sarda: Pothuaj e vdekur (3:1-6)

Gjendja e kishës në Sardë përkonte me gjendjen e qytetit. Të dy kishin marrë fund, por asnjëri nuk e pranonte këtë (v. 1). Jezusi, si i vetmi që mund t'i mbante në ekzistencë apo t'i ruante nga humbja e plotë, bënte kontrast të fortë me fortesën e papushtueshme në majë të kodrës së qytetit, e cila, megjithatë, kishte rënë dy herë në dorë të armikut, kur rojet nuk kishin ruajtur siç duhet (nën Kirin dhe Antiokun III).⁶⁹ Atje ku do të prisnim lavdërim, nuk gjejmë gjë, megjithëse vargu 4 përmend nja dy ndjekës besnikë në kishë. Por këtu, Gjoni vazhdon menjëherë me një qortim të fortë dhe thirrje për pendim, përndryshe Jezusi do të vijë papritur dhe do t'i gjykojë (vv. 2-3; kujtoni

⁶⁷ · Gnosticizmi – (nga greqishtja “gnosis”, “njohuri”) një ide fetare e shekujve të parë pas Krishtit. Ndonëse është e vështirë të përcaktohet me pak fj alë, gnosticizmi është ideja se njeriu mund të arrijë Perëndinë nëpërmjet një njohurie (gnosis) të fshehtë që e njohin vetëm disa persona të privilegjuar. Nëpërmjet marrjes së kësaj njohurie, njeriu lë mënjanë padijen që e pengon të arrijë Perëndinë dhe në këtë mënyrë “shpëtohet” (red. teol. F.M.).

⁶⁸ · Krahaso më tej Osborne, *Revelation*, 162-63.

⁶⁹ · Po aty, 174, 177.

1 Sel. 5:2 dhe Mat. 24:43). Ndryshe nga rojet që e braktisën detyrën e tyre, të krishterët e Sardës duhet të qëndronin vigjilentë.

Mohimi i dyfi shtë “nuk do ta fshij,” krijon një siguri të fortë që, ata që fi tojnë, e kanë të garantuar jetën e përjetshme. Imoraliteti i tyre (“petkat e ndotura”) do të zëvendësohet nga drejtësia (“rroba të bardha”; vv. 4-5).⁷⁰ Për fi gurën e librit të jetës shiko Eksodin 32:32-33. Premtimi i Krishtit është, gjithashtu, në kontrast me dëbimin e të krishterëve judenj nga sinagogat, ku emrat e tyre fshiheshin me bojë nga regjistri i anëtarësisë. Rrëfi mi i emrave të tyre para Atit dhe engjëjve të tij duket se i referohet thënies së Jezusit te Luka 12:8-9 dhe fragmenteve paralele me të.

Filadelfi a: E bindur dhe besnike (3:7-13)

Kjo është më pozitivja nga gjithë letrat. Ndryshe nga Smirna, që ishte besnike, e megjithatë e përndjekur, Filadelfi a është besnike dhe dukshëm e bekuar, me derë të hapur për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë dhe për të ndihmuar të tjerët të hyjnë bashkë me të, pavarësisht nga forca e pakët e saj (vv. 7-8).⁷¹

Por asgjë nuk na thotë që kisha e Filadelfi së ishte *më* e bindur se ajo e Smirnës. Vetëm Perëndia në sovranitetin e Tij e vendos se kur është apo nuk është i përshtatshëm

⁷⁰ · J. William Fuller, “I Will Not Erase His Name from the Book of Life” (Revelation 3:5), JETS 26 (1983): 297-306.

⁷¹ · Hemer, *The Letters to the Seven Churches*, 162.

bekimi i jashtëm për shërbim dhe qëndrueshmëri të krishterë. Paralelizmi me Smirnën shkon më tej edhe nga një referencë tjetër ndaj një “sinagoge të Satanit” (v. 9; kujtoni 2:9).

Vargu 10 jep pikën kyçe në këtë letër. Ruajtja “nga ora e sprovës që do të vijë mbi gjithë botën” do të thotë që të krishterët do të hiqen nga vendi i mundimit apo që do të mbrohen, megjithëse do të gjenden në mes të tij? Gramatikisht, shprehja mund të ketë secilin nga këta kuptime. Ata që mbrojnë rrëmbimin para mundimit, sigurisht zgjedhin kuptimin e parë, kurse pasmundimistët zgjedhin të dytën. Është interesante që i vetmi rast tjetër ku përdoret folja *tēreō* (“ruaj”) me parafj alën *ek* (“nga”) në Dhiatën e Re është te Gjoni 17:15, kur Jezusi lutet për ndjekësit e tij që të mbrohen nga i ligu, edhe pse do të mbeten në botë.

Por, nëse ky është një aluzion për mundimin e madh në fund të historisë njerëzore, kjo është e vetmja referencë në këto letra drejtuar shtatë kishave. Çdo detaj tjetër në to zbatohet qartë për kontekstin e kohës së tyre në fundin e shekullit të parë.

Prandaj, ndoshta, “ora e sprovës” që përmendet këtu i referohet përndjekjes në të ardhmen e afërt të të krishterëve në mbarë perandorinë (që në kontekstin romak kishte marrë kuptimin “e gjithë bota”). A është thjesht rastësi që kisha në Filadelfi mbeti deri në vitin 1392, shumë kohë pasi kishat në gjashtë qytetet e tjera ishin shkatërruar, disa nga pushtimet islame që fi lluan në

shekullin e shtatë?⁷² Në vargjet 11-12 vjen premtimi për t'i bërë shtylla në tempullin e ri të Perëndisë në Jerusalemin e ri ata që fi tojnë. Patjetër, kjo është metaforë për të thënë që do t'i bëjë të qëndrueshëm, sepse Jerusalemi i ri nuk ka tempull me gurë (21:22). Ky ishte edhe një imazh shumë i përshtatshëm për banorët e Filadelfi së, që ishin mësuar aq shumë me tërmete në atë zonë, të cilët tronditnin shtyllat e tempullit të tyre dhe strukturat e tjera prej guri, saqë shumica prej tyre banonin jashtë mureve të qytetit.

Laodicea: E papishme dhe e padobishme (3:14-22)

Kjo është më negativja nga të shtatë letrat. Kisha në këtë qytet ishte si burimi i tij i ujit, proverbial për vakësinë e tij (v. 15). Laodicea nuk kishte vetë ujë të pijshëm, kështu që ai duhej të sillej me tuba, ose nga burimet e ftohta malore afër Kolosit, ose nga burimet e nxehta kurative afër Hierapolisit. Në të dy rastet, deri sa uji arrinte në Laodice, ai ishte bërë pa shije. Kështu që, “i nxehtë” dhe “i ftohtë” në këtë fragment janë të dyja metafora *pozitive*, dhe vihen në kontrast me gjendjen e neveritshme të laodiceasve (v. 16).⁷³ Qyteti ishte gjithashtu i famshëm për pasurinë e tij (ai u rindërtua vetë, pa ndihmën e romakëve, pas një tërmeti në vitin 60 pas Krishtit), për industrinë e

⁷² · Krahaso: Aune, *Revelation 1-5*, 240; Craig S. Keener, *Revelation* (Grand Rapids: Zondervan, 2000), 154.

⁷³ · Shih: sid. M.J.S. Rudwick dhe E.M.B. Green, “Th e Laodicean Lukewarmnes,” *ET* 69 (1957-58): 176-78; dhe Stanley E. Porter, “Why the Laodiceans Received Lukewarm Water (Revelation 3:15-18),” *TynB* (1987): 143-49.

leshit të zi dhe për një shkollë mjekësore që prodhonte kolir për sytë. Në kontrast me to, vargu 17 iu referohet të krishterëve atje si “qyqar e mjeran, i varfër, i verbër dhe i zhveshur.” Ata duhet të blejnë “ar” shpirtëror, “petka të bardha” dhe “kolir” për sytë, që ta ndryshojnë këtë gjendje (v.18).⁷⁴

Th irrja që u bëhet laodiceasve për pendim (v.19) përdor metaforën e famshme të hapjes së derës, që Jezusi të hyjë e të hajë me ta (v. 20). Megjithëse ky mund të jetë një imazh i fuqishëm për dikë që e pranon Krishtin në zemër për herë të parë, në këtë kontekst Gjoni i referohet qartë kishës *si kolektiv*, duke u bërë thirrje ta mirëpresin *përsëri* Jezusin në mesin e tyre.⁷⁵ Trokitja e Tij e duruar bën kontrast me hyrjen me forcë të zyrtarëve romakë nga porta e trefi shtë e mureve rrethuese, duke kërkuar banesë në këtë qytet të pasur.

Juxhin Pitersoni (Eugene Peterson) e përmbledh shumë bukur thelbin e lavdërimeve dhe dënimeve të secilës kishë, gjë që mund të na ndihmojë të gjejmë grupe analoge të krishterësh në kohëra dhe vende të tjera që kanë nevojë për premtime dhe paralajmërime të ngjashme. “Kishat lavdërohen për punë të palodhur, këmbëngulëse dhe vigjilente (Efesi); për durim me trimëri të vuajtjeve (Smirna); për dëshmi të guximshme (Pergami); për dishepullëzim të mirë (Tiatira); për qëndrueshmëri

⁷⁴ · Krahazo më tej Beasley-Murray, *Revelation*, 103, 106.

⁷⁵ · Tim Wiarda, “Revelation 3:20: Imagery and Literary Context,” *JETS* 38 (1995): 203-12.

(Filadelfi a).” Por “ato qortohen se e kanë lënë dashurinë e parë të zjarrtë për Krishtin (Efesi); se janë indiferente ndaj mësimëve heretike (Pergami); se tolerojnë imoralitetin (Tiatira; se janë të vakëta (Sarda); dhe se kanë lejuar që luksi dhe pasuritë të zëvendësojnë jetën në Frymë (Laodicea).”⁷⁶

Përveç kësaj, Riçard Folksi (Richard Foulkes) thekson se “shpërthimi” i mesazhit të Jezusit në jetët e anëtarëve të shtatë kishave nuk lë asgjë pa prekur. Ai këmbëngul në ndryshime jetësore, jo vetëm në nivel individual (shumë nga fetë në Efes e përreth tij pranonin kthim personal në një kult të caktuar që nuk i diskreditonte opsionet e tjera fetare të kohës), por edhe në nivelin shoqëror të “strukturave që i skllavërojnë dhe i mashtrojnë njerëzit.

Kjo do të thotë që aspekti fetar i jetës është kaq i ndërthurur me aspektet e tjera, ekonomike, qytetare dhe ligjore – madje edhe në botën tonë të ashtuquajtur ‘laike’ – sa që një ndryshim fetar i shkaktuar nga Jezusi do të duhej të ndikonte gjithë pjesën tjetër të ekzistencës.”⁷⁷

⁷⁶ · Eugene H. Peterson, *Reversed Th under: Th e Revelation of John and the Praying Imagination* (San Francisco: Harper & Row, 1988), 51, 52.

⁷⁷ · Ricardo Foulkes, *El Apocalipsis de San Juan: Una lectura desde América latina* (Buenos Aires: Nueva Creación; Grand Rapids: Eerdmans, 1989), 30 (përkthimi i autorit).

Lavdërimi qiellor

Për Perëndinë (4:1-11)

Në vegimin e tij, Gjoni tani rrëmbehet në dhomën qiellore të fronit, ku atij do t'i tregohen ngjarje të ardhme (gjë që, me sa duket, fi llon në 6:1). Por, së pari, ai e shikon veten për pak në paradhomën e Perëndisë (kap. 4). “Dera e hapur në qiell” e vargut 1a, bashkë me një udhërrëfyes qiellor dhe një udhëtim vegimtar janë tipare standarde të letërsisë apokaliptike, prandaj nuk kemi arsye të mendojmë se Gjoni këtu përfaqëson gjithë kishën e rrëmbyer në qiell, si në dispensacionalizmin klasik.⁷⁸ Por “pas këtyre gjërave” në vargun 1b e mbështet interpretimin futurist të pjesës më të madhe të librit. Përshkrimi jo i drejtpërdrejtë i Perëndisë dhe hollësitat e sfondit përreth nuk duhen alegorizuar; elementet e vargjeve 2-6 kombinohen për të krijuar një tablo mahnitëse pasurie, bukurie, madhështie, sovraniteti, pushteti dhe pastërtie të Zotit. Të njëzet e katër pleqtë dhe katër qeniet e gjalla ngjajnë me kerubinët dhe serafi nët e Ezekielit 10:14 dhe të Isaisë 6:2. “Pleqtë” lidhen me krijesa të tjera qiellore, gjatë gjithë librit të Zbulesës (4:6; 5:5,11; 7:11; 19:4), dhe dallohen nga ata që janë shpenguar nga toka (5:8; 7:13-14; 11:18; 14:3), prandaj ata duhen parë më

⁷⁸ Fjala “e hapur” në të vërtetë është përcjellore në formën joveprore, fj alë për fj alë, “duke qenë hapur.”

mirë si zëdhënës engjëllorë.⁷⁹ Fakti që janë njëzet e katër mund të sugjerojë që ata përfaqësojnë dhe/ose mbrojnë gjithë njerëzit e Perëndisë në të gjitha kohërat të udhëhequr nga dymbëdhjetë bijtë/ fi set e Izraelit dhe dymbëdhjetë apostujt. Por ky numër mund të vijë edhe nga njëzet e katër ndarjet e priftërinjve dhe këngëtarëve levitikë të 1 Kronikave 24-25 dhe të tregojë një rol udhëheqës në adhurimin qiellor.⁸⁰

Vargjet 6b-11 na çojnë pikërisht te ky adhurim. Këtu ai i drejtohet Perëndisë, duke e lavdëruar pa pushim për shenjtërinë, përjetësinë, krijimin dhe gjërat që jep. Nderimi i Tij si “Zoti, Perëndi, i Plotfuqishmi” e sfi donte drejtpërdrejt Domicianin, i cili i mbante këta tre tituj për vete.

Fakti që pleqtë hedhin kurorat para fronit (v. 10) është marrë shpesh si provë që besimtarët marrin shpërblime të ndryshme (kurora) në qiell. Por, nëse pleqtë janë engjëj, atëherë kjo tablo nuk na mëson asgjë në lidhje me shpërblimin e *besimtarëve*. Sidoqoftë, edhe po të përfaqësojnë kishën, fakti që ia kthejnë në fund shpërblimet Atit qiellor i bën të gjithë gjithsesi të barabartë.⁸¹ Në të vërtetë, ideja thelbësore këtu nuk është

⁷⁹ · Shih: p.sh. George E. Ladd, *A Commentary on the Revelation of John* (Grand Rapids: Eerdmans, 1972), 75.

⁸⁰ · Krahason: sid. Mounce, *Revelation*, 121-22.

⁸¹ · Adhurimi “na kujton se çfarëdo tjetër që të jenë tani dhuntitë dhe thirrja jonë, të gjithë të krishterët bëhen të njëjtë si adhurues të Perëndisë; e ardhmja e përjetshme lë pak vend për dhuntitë që vlerësohen tani, por

lartësimi i ndonjë tjetri përveç Perëndisë vetë. Vetëm Ai është i denjë të marrë gjithë nderin dhe lavdinë.

Për Qengjin (5:1-14)

Kapitulli 5 e vazhdon këtë temë, por e kalon lavdërimin për Qengjin e therur, i cili është i vetmi që mund të hapë librin (rrotullën) dhe të tregojë ngjarjet e kohës së fundit. Në fi llim del një problem në dukje i pazgjidhshëm: askush në gjithësi nuk është i denjë të zgjidhë vulat që e mbajnë librin të mbyllur dhe profecitë të fshehura (vv. 1-4). Një rrotull e shkruar nga të dy anët shpesh ishte një dekret perandorak.⁸²

Hapja e vulave të një libri mund t'i referohej ekzekutimit ligjor të përmbajtjes së tij. Në këtë rast, para se të mundet djalli dhe të vendoset mbretëria e përsosur e Krishtit, duhet paguar një fl ijim për mëkatin. Por, ndërsa Gjoni fi llon të qajë që gjërat janë kështu, vjen shpallja që “Luani i fi sit të Judës, Rrënja e Davidit, fi toi” dhe mund të hapë librin (v. 5). Një mbret që rrjedh nga familja dhe fi si mbretëror është padyshim Mesia. Por, megjithëse Krishti quhet *luan*, kur Gjoni kthehet të shikojë këtë pamje, ai sheh një *qengj* të therur, por të ringjallur, në qendër të fronit të Perëndisë, me shtatë brirë dhe sy që

përkushtimi ynë ndaj Perëndisë rritet gjithmonë” (Keener, *Revelation*, 180).

⁸² Në të vërtetë i gjithë kapitulli të kujton adhurimin e perandorëve romakë, por tregon se Krishti dhe jo Cezari është Ai që e meriton këtë adhurim. Shih: J. Daryl Charles, “Imperial Pretensions and the Throne Vision of the Lamb: Observations on the Function of Revelation 5,” *CTR* 7 (1993): 85-97.

përfaqësojnë Frymën (e Shenjtë) e shtatëfi shtë (shiko faqen 35), me anë të të cilit Mesia është i kudondodhur. Fakti që Fryma vjen nga Perëndia e plotëson referencën e sapofi lluar ndaj Trinisë (v. 6).

Marrja e librit është preludi i nevojshëm para hapjes së tij. Por, para se të vazhdojnë ngjarjet, turma engjëllore shpërthen në një litani (varg i gjatë) lavdërimesh për shpengimin që ka bërë Mesia, i cili ka bërë të mundur të shpengohen njerëz nga çdo grupim etnik dhe gjuhësor në tokë. Ky lavdërim vjen duke u shtuar, ndërsa Qengji paraqitet, lartësohet dhe vendoset në fron – një ceremoni e plotë kurorëzimi (vv. 7-14).⁸³ Shërbëtori i vuajtur është bërë mbreti-luftëtar.⁸⁴ Fakti që çdo krijesë në gjithësi e lavdëron Qengjin (v. 13) nuk do të thotë që të gjithë shpëtohen. Isaia 45:23-24 përshkruan për herë të parë adhurimin e detyruar të Perëndisë nga armiqtë e Tij, të cilët në të njëjtën kohë do të turpërohen (krahaso: Fil. 2:1011; Kol. 1:20; Efe. 1:21-23). Imazhi i lavdisë qiellore që gjendet në kapitujt 4-5 që i pret gjithë njerëzit e Perëndisë e përgatit Gjonin për vegimet e ngjarjeve të tmerrshme që duhet t'i paraprijnë kësaj lavdie dhe u jep lexuesve të tij këndvështrimin “e tablosë së madhe” që është i nevojshëm për t'i mbajtur ata besnikë në kohët e vështira që do të vijnë së shpejti.⁸⁵

⁸³ . Beasley-Murray, *Revelation*, 126. Mounce (*Revelation*, 134) e quan këtë “një nga skenat më të mëdha të adhurimit universal të regjistruara diku.”

⁸⁴ . Donald Guthrie, *The Relevance of John's Apocalypse* (Exeter: Paternoster; Grand Rapids: Eerdmans, 1987), 46-51. Por, siç vëren Aune (*Revelation 1-5*, 368), fi gura e një qengji të therur (si në Pashkë ose tek Isaia 52-53) përzihen me imazhin e një dashi luftëtar në tekste apokaliptike si Danieli 8.

⁸⁵ . “Lavdërimi vendos përndjekjen, varfërinë dhe fatkeqësitë në këndvështrimin e duhur; Perëndia po përmbush në mënyrë sovranë

Shtatë vulat dhe Interludi i parë

Gjashtë vulat e para (6:1-17)

Zemra e librit të Zbulesës paraqet njëzet e një gjykime të Perëndisë mbi botën, në tri grupe me nga shtatë elemente secili. Grupi i parë përfaqësohet nga shtatë vula që duhen hequr nga libri, në mënyrë që ai të hapet. Imazhi i një libri gjykimi të Perëndisë (krahaso 5:2-5) na kujton raste të ngjashme në Dhiatën e Vjetër (sidomos Ezekieli 2:93:3). Megjenëse duhen hequr vulat, para se libri të lexohet, është e natyrshme t'i marrim shumicën e gjykimeve të para si *preludin e tmerreve të kohëve të fundit* (të cilat më vonë quhen “Mundimi apo Shtrëngimi i madh” – 7:14), dhe jo aq si pjesë e këtyre tmerreve vetë.⁸⁶ Paralelet e tyre me një numër ngjarjesh që paratha Jezusi në predikimin profetik në Malin e Ullinjve (shih: Marku 13:7a, 8 pjesërisht), si gjëra që *nuk* tregonin fundin (v. 7b), e përforcojnë këtë përshtypje. Vërtet, katër gjykimet e para të vulave, të përfaqësuara nga katër kuaj dhe kalorës që na kujtojnë Zakarian 1:8-11, paraqesin mundime që kanë ndodhur shpesh gjatë gjithë historisë: militarizëm, luftë, zi buke dhe vdekje (Zbu. 6:1-8).

Vula e parë (vv. 1-2) paraqet të vetmen dykuptimshmëri midis të katërtave. Megjenëse në 19:11

qëllimet e Tij dhe dhimbjet e kësaj bote janë thjesht dhimbjet e lindjes së një bote të re: (Keener, *Revelation*, 182).

⁸⁶ . Ladd, *Revelation*, 95-96, 98.

Krishti vetë shfaqet si kalorës mbi një kalë të bardhë, disa e kanë kuptuar këtë vulë sikur paraqet kthimin e kombeve në besim prej Krishtit. Por, meqenëse të gjitha simbolet e gjykimeve të tjera janë padyshim negative, ne ndoshta duhet të dallojmë këtu simbolin romak të *militarizmit dhe pushtimit perandorak*. Harku (i shigjetës) ishte imazh luftimi, sidomos midis partëve, fqinjëve të romakëve në verilindje të perandorisë së tyre.⁸⁷ Perëndia greko-romak, Apoloni, po ashtu besohej se luftonte me hark e shigjeta. Por pushtetet e njerëzve dhe të “perëndive” do të dalin se janë të pafuqishme kundër gjykimit të Unë Jam-it.⁸⁸

Vula e dytë (vv. 3-4) paraqet qartazi *luftë*. Vula e tretë përfaqëson *zj buke*, shumë e ngjashme me kushtet që pasuan një thatësi në vitin 92 pas Krishtit. Duhej paga e një dite për të blerë racionet ditore normale të grurit dhe elbit, kurse rrënjët e ullinjve dhe të hardhive (që janë më të thella) ende gjenin ujë të mjaftueshëm për t’u rritur mirë.⁸⁹ Mëshira e Perëndisë është e qartë që po e kufi zon vuajtjen këtu. Vula e katërt parashikon vdekje nga lufta, zija e bukës dhe murtaja. Teksti disa herë lexohet sikur profetizon që do të vritet një e katërta e njerëzimit. Por ajo që shkruan Gjoni është se atyre u është dhënë “pushtet

⁸⁷ · Murphy, *Fallen is Babylon*, 205.

⁸⁸ · Shih për më shumë Allen Kerkeslager, “Apollo, Greco-Roman Prophecy, and the Rider on the White Horse in Rev 6:2,” *JBL* 112 (1993): 11621.

⁸⁹ · Justo L. González dhe Catherine G. González, *Revelation* (Luisville and London: WJKP, 1997), 48-49.

përmbi një të katërtën e dheut.” Sa janë vrarë në këtë pjesë të botës në të cilën bie gjykimi, nuk na thuhet.⁹⁰

Vula e pestë e thyen rregullin e gjykimeve aktive të portretizuara nga kuajt dhe kalorësit e tyre. Në vend të kësaj, kjo vulë çliron *klithmat e martirëve të krishterë* që pyesin edhe sa kohë do të duhet që Perëndia të marrë hak për vdekjen e tyre.⁹¹ Përgjigjia është që ata duhet të presin edhe pak, sepse do të martirizohen edhe të tjerë (vv. 9-11). Por, si “shpirtra” afër pranisë së Perëndisë, atyre iu jepen rroba të bardha që simbolizojnë pastërtinë e tyre qiellore. Kështu që e vetmja fatkeqësi e mirëfi lltë që paraqitet nga vula e pestë është siguria që fatkeqësitë e katër vulave të para duhet të vazhdojnë, siç edhe kanë vazhduar në shumë vende dhe kohëra në historinë e krishterë.⁹²

Me vulën e gjashtë ne kalojmë nga ngjarjet që përgatisnin rrugën për në Mundimin e madh, në atë që duket sikur Mundimi ka fi lluar dhe madje po vjen në pikën kulmore (vv. 12-17). Këto janë ngjarje që, edhe po të mos merren në mënyrë të

⁹⁰ · Krahaso Ladd, *Revelation*, 101.

⁹¹ · Disa vënë në pikëpyetje moralitetin e këtyre thirrjeve për hakmarrje, por drejtësia e Perëndisë është ana tjetër e medaljes së dashurisë së Tij. Dhe vetëm Ai mund të hakmerret me drejtësi të plotë, prandaj duhet t'i bëjmë thirrje Atij ta bëjë këtë, në vend që të përpiqemi ta marrim hakmarrjen në duart tona. Kujtoni Lëvizjen 32:35, ku Zoti thotë se hakmarrja i takon Atij (krahaso: Psalmin 94:1, Rom. 12:19 dhe shumë tekste të tjera ku Zoti premton të hakmerret për popullin e Tij).

⁹² · Pavarësisht unikalitetit të saj si e vetmja “lutje” në Apokalips, kjo vulë luan një rol të plotë në bashkimin e atyre që mëson libri në lidhje me gjykimin dhe hakmarrjen. Shih: John P. Heil, “Th e Fifth Seal (Rev 6, 9-11) as a Key to the Book of Revelation,” *Bib* 74 91993): 220-43.

drejtpërdrejtë, janë aq kozmike në shtrirje dhe në shkatërrim, saqë ideja e Gjonit duhet të jetë që, bota siç e njohim tani, nuk mund të vazhdojë (vv. 1214). Imazhe të tilla në pjesë të tjera apokaliptike hebreje, disa herë nuk i referohen shkrirjes së vërtetë të universit, por një epoke krejt të re socio-politike të sundimit të Perëndisë në tokë.⁹³ Trazira e krijuar është, të paktën, po aq e përhapur dhe ndoshta edhe më shumë, sesa ajo që nënkuptojmë ne me shprehjet po aq metaforike “ajo e ktheu botën përmbys” apo “nuk la dy gurë bashkë.” Siç u tha më sipër, kjo ndoshta është një “parapamje” e pragut të fundit, pak përpara se Krishti të vijë dhe t’i bëjë të gjitha gjërat të reja.⁹⁴

Cilatdo të jenë ngjarjet e drejtpërdrejta, ato sjellin tmerr të madh dhe dëshirë për të vdekur bazuar mbi bindjen e gabuar se vdekja do t’u japë fund vuajtjeve të tyre (vv. 15-17). “Zemërimi i Qengjit” është një oksimoron⁹⁵ i mrekullueshëm për rolin e Jezusit në këtë sfond.

⁹³ · N.T.Wright, *The New Testament and the People of God* (London: SPCK; Minneapolis: Fortress, 1992), 280-86.

⁹⁴ · Krahaso: Witherington, *Revelation*, 135-36.

⁹⁵ · Oksimoron, ka kuptimi “kombinimi i dy termave kontradiktore” (Shën. i Përkthyesit)

Të 144 mijët dhe turma që askush nuk mund ta numëronte (7:1-17)

Para se të përshkruajë vulën e shtatë, Gjoni fut dy segmente të një vizioni tjetër qiellor. Vargjet 1-8 përshkruajnë vulosjen e 144 mijë njerëzve. Para se të çlirohet fatkeqësia tjetër, Perëndia sigurohet që “shërbëtorët” e Tij që janë ende në tokë, të mbrohen nga zemërimi i Tij që po vjen

(vv. 1-3; krahaso me Ezekieli 9:4-6). Vula mund të tregojë edhe pronësinë e Perëndisë mbi ndjekësit e Tij. Pra, është e qartë që ka besimtarë mbi tokë gjatë mundimit që po vjen. Ajo që diskutohet është nëse ky është një përshkrim i gjithë kishës apo i vetëm një pjese të saj – për shembull i të krishterëve hebrenj – të cilët (ose një pjesë e të cilëve) nuk janë rrëmbyer ose besojnë kur shohin rrëmbimin e kishës. Në pamje të parë, interpretimet që thonë se këta janë hebrenj të vërtetë duken shumë më të mundshme.

Ky fragment ndoshta është ai që mbështet më shumë idenë e rrëmbimit të kishës para mundimit, sesa çdo tekst tjetër nga Bibla. Grupi që përmendet në vargjet 4-9 shpallet si i marrë nga fi set e Izraelit – 12 mijë për secilin nga 12 fi set. Nga ana tjetër, në vegim, te vargjet 9-17, Gjoni sheh një turmë nga çdo grup etnik mbi tokë që askush nuk mund ta numëronte (v. 9), e cila ka dalë nga “mundimi/shtrëngimi i madh” (v. 14), me sa duket, kisha e rrëmbyer shumëkombëshe e Jezu Krishtit.⁹⁶

⁹⁶ . Ky është këndvështrimi klasik dispensacionalist. Shih: p.sh. Robert L.

Por, kur e sheh më nga afër, disa tipare të këtij kapitulli hedhin dyshime mbi këtë interpretim. *I pari* është lista unike e fi seve në vargjet 5-8. Askund tjetër në ndonjë letërsi të lashtë hebreje nuk shfaqet saktësisht kjo listë emrash (në çfarëdo renditjeje) ku mungon emri i Danit dhe ku përmendet Jozefi , por vetëm në lidhje me njërin nga dy bijtë e tij (Manaseun, por jo Efraimin), midis të cilëve u nda toka. Ky mund të jetë treguesi i parë që ky nuk është një përshkrim krejt i drejtpërdrejtë i Izraelit etnik.⁹⁷ *Së dyti*, të 144 mijët dalin përsëri në 14:1-5, pa ndonjë kufi zim etnik dhe me karakteristika të përgjithshme të krishtera (shih edhe më poshtë). *Së treti*, Gjoni nuk i shikon asnjëherë të 144 mijët. Vargu 4 shpjegon se ai e “dëgjoi” numrin e të vulosurve nga secili fi s. Pasi dëgjoi përshkrimin natyrshëm, do të prisnim që ai ta shikonte grupin e saposhpallur. Dhe kjo është ajo që ai bën në vargun 9 dhe ajo që ai shikon është turma që askush nuk mund ta numëronte. *Duket sikur kjo pamje përfaqëson të njëjtin grup që sapo është përshkruar me terma më hebreje.*⁹⁸ *Nuk duhet të harrojmë se e njëjta dukuri ndodhi në 5:5-6. Atje Gjoni iu tha të vështronte dhe të shikonte Luanin*

Th omas, *Revelation 1-7* (Chicago: Moody, 1992), 487.

⁹⁷ · Për një përmbledhje të detajuar të përpjekjeve për të gjetur një shpjegim për këtë listë unike, shih: Richard Bauckham, “Th e List of the Tribes in Revelation 7 Again,” *JSNT* 42 (1991): 99-115. Krahaso edhe Christopher R. Smith, “Th e Portrayal of the Church as the New Israel in the Names and Order of the Tribes in Revelation 7.5-8,” *JSNT* 39 (1990): 111-18.

⁹⁸ · Shih: p.sh. Roloff , *Revelation*, 98.

e Judës, por ajo që pa ai ishte një Qengi si i therur. Në botën e Gjonit nuk mund të imagjinohej ndryshim më i madh se ai midis mbretit të kafshëve dhe një qengji të therur. Dhe, megjithatë, të dy këta imazhe i referohen të njëjtit realitet – Jezusit vetë (shih më lart).⁹⁹ Prandaj është krejt e mundur që anëtarët e numëruar të fi seve të Izraelit dhe turma shumëkombëshe që askush nuk mund ta numëronte paraqesin të njëjtën gjë – kishën – nga dy këndvështrime të ndryshme, por që plotësojnë njëritjetrin. Nga njëra anë, kisha është plotësimi përfundimtar i synimeve fi llestare të Perëndisë për Izraelin. Nga ana tjetër, ajo përbëhet nga një numër shumë më i madh njerëzish nga çdo grup etnogjuhësor mbi tokë.¹⁰⁰

Edhe vargjet 9-17 bëjnë kontrast me vargjet 4-8, duke treguar shumën e gjithë të shpenguarve në qiell, jo më në tokë. Por etiketimi i tyre si “ata që kanë ardhur nga shtrëngimi i madh”, sugjeron më natyrshëm që ata e kanë përjetuar atë, sesa që u përjashtuan fare prej tij.¹⁰¹ Rrobat e tyre të bardha (vv. 9, 13) na kujtojnë shpërblimin e

⁹⁹ · Krahaso imazhin e dyfi shtë paralel në të gjithë Zbulesën e ndjekësve të Krishtit, edhe si luftëtarë fi timtarë, edhe si martirë të përndjekur. Shih veç. Stephen Pattemore, *Th e People of God in the Apocalypse* (Cambridge and New York: CUP, 2004).

¹⁰⁰ · Krahaso: Philip E. Hughes, *Th e Book of Revelation* (Leicester: IVP; Grand Rapids: Eerdmans, 1990), 94-95. Natyra plotësisht shumëkulturore e Qiellit sugjeron mandatin për të punuar për *kisha* shumëkulturore, si edhe për një kishë universale multikulturore në këtë epokë. Shih: Justo L. Gonzalez, *For the Healing of the Nations: Th e Book of Revelation in an Age of Cultural Conflict* (Maryknoll: Orbis, 1999).

¹⁰¹ · Krahaso: Ladd, *Revelation*, 117-18.

martirëve në 6:11. Edhe fakti që rrobat i kanë larë dhe i kanë zbardhur në gjakun e Qengjit përbën një tjetër oksimoron, por vepra shlyese e Krishtit në të vërtetë i bën ndjekësit e Tij krejt të pastër, të paktën pas përfundimit të jetës së tyre tokësore. Nuk është për t'u habitur, pra, që një përfundim kaq i mrekullueshëm i bën të shpenguarit të shpërthejnë në lavdërim për shpëtimin e tyre (v. 10), për madhështinë e Perëndisë që e bëri këtë të mundur (v. 12) dhe për fatin e tyre të përjetshëm (vv. 15-17). Çfarëdo vuajtje të kenë përjetuar në këtë jetë, do të fshihet për të mos u kthyer kurrë më. Qengji transformohet në një Bari që i udhëheq njerëzit e Tij në vende çlodhjeje të përjetshme!¹⁰²

Vula e shtatë (8:1-5)

Më në fund Gjonit i lejohet të mësojë për vulën e shtatë. Por, në vend që ajo të sjellë fatkeqësi, thirrje për hakmarrje apo tronditje kataklizmike, siç ndodh me gjashtë vulat e para, gjithçka që ndodh është *një beshtje qiellore e zgjatur* (krahazo Zakaria 2:13), *e ndjekur nga çfarë mund të quben efekte zanore dhe ndihma pamore kozmike*, si ato që shoqërojnë fatkeqësitë “natyrore” në gjithë historinë njerëzore. Vetëm, në këtë rast, duket sikur bubullima dhe vetëtima fi llojnë në tokë dhe jehojnë deri në qiell. Fakti që, edhe heshtja (v. 1), edhe efektet që e pasojnë (vv. 3-5)

¹⁰² - Krahazo më tej Kirsten Nielsen, “Shepherd, Lamb and Blood: Imagery in the Old Testament – Use and Reuse,” *ST* 46(1992): 121-32.

kanë në mes një referencë ndaj të shtatë engjëjve me shtatë boritë, mbështet sugjerimin tonë të mëparshëm se vula e shtatë nuk paraqet ndonjë gjykim të ri, por thjesht përgatit rrugën për serinë tjetër të gjykimeve të borive dhe e përfshin brenda atë (Shiko faqet 20-23 më sipër).¹⁰³

Shtatë boritë dhe Interludi i dytë

Gjashtë boritë e para (8:6-9:21)

Nga marshimi i famshëm i Jozueut përreth Jerikos e deri te tekstet apokaliptike, si 1 Korintasve 15 dhe 1 Th esalonikasve 4-5, boritë shpeshherë funksionojnë si parajmëruese të gjykimit në Bibël. *Më në fund jemi gati për vetë Mundimin e Madh*, siç tregohet në librin, i cili tani mund të hapet për të na zbuluar gjykimet e Perëndisë që janë duke ardhur (v. 6). Ashtu si me katër vulat e para, gjykimet e katër borive të para janë shumë të ngjashme me njëra – tjetrën (vv. 7-12). *Ato ngjajnë edhe me fatkeqësitë mbi egjiptasit gjatë debatit midis Moisiut dhe Faraonit. Ky paralelizëm sugjeron që, edhe në këtë kohë, qëllimi i tyre është t'i nxitë të këqijtë të pendohen*. Mbyllja e këtij seksioni (9:20-21) e konfirmon këtë synim në mënyrë të tërthortë. Me gjithë gjykimet e

¹⁰³ · Për hollësi, shiko: J. Ramsey Michaels, *Interpreting the Book of Revelation* (Grand Rapids: Baker, 1992), 56-58.

borive, të këqijtë e tokës nuk pendohen – gjë që sugjeron se ata ende e kishin një mundësi për t'u penduar.¹⁰⁴

Gjykimi i borisë së parë përfshin *breshër e zjarr të përzier me gjak*; e dyta *një mal që digjej u hodh në det duke e kthyer atë në gjak*; e treta, *një yll i zjarritë i kthen burimet e ujit në pelin të hidhur*; dhe e katërta, *një fatkeqësi që errëson dritën e diellit, hënës dhe yjeve* (vv. 7-12). Në secilin rast preket një e treta e këtyre zonave të synuara mbi tokë. Çfarëdo tjetër që mund të tregojë kjo thyesë, është patjetër më e madhe se një e katërta e tokës që përmendet në 6:8. Megjithatë, me gjithë intensifi kimin e gjykimit, vetëm një pakicë e botës preket nga fatkeqësitë e Perëndisë.¹⁰⁵ Është e pamundur ta përcaktosh se sa të drejtpërdrejta janë këto përshekrime. Disa nga vegimet përfshijnë patjetër dukuri që nuk mund të ndodhnin në mënyrë të drejtpërdrejtë, për shembull, errësimi pikërisht i një të tretës së diellit. Imazhet që përfshihen këtu janë tipike për profecinë apokaliptike (jo të drejtpërdrejtë). Gjoni, pa dyshim, po përshkruan sa më saktësisht mundet ato që pa në vegime, po kjo nuk do të thotë që ato vegime janë riprodhime ekzakte të ngjarjeve që do të ndodhin. Përkundrazi, siç ndodh shpesh në letërsinë apokaliptike, ato janë simbole për ngjarje të vërteta që mund të duken krejt ndryshe në realitet, por qëllimet dhe

¹⁰⁴ · Krahaso: Beasley-Murray, *Revelation*, 156, 167.

¹⁰⁵ · Keener, *Revelation*, 272.

pasojat e të cilave janë njëlloj të tmerrshme.¹⁰⁶

Boria e pestë dhe e gjashtë (të quajtura, gjithashtu, mjerimi i parë dhe mjerimi i dytë) janë të një natyre tjetër (8:13-9:21). Në *fî llim*, *Gjoni shikon ushtri karkalecash të përshkruar në mënyrë groteske, origjina e të cilëve është humnera* (9:1-2). Kjo sugjeron që ai po shikon një hordhi demonike, më shumë sesa një luftë njerëzore.¹⁰⁷ Epidemitë e karkalecave ishin shumë të zakonshme në botën e lashtë të Lindjes së Mesme, dhe Joeli 2:1-11 ishte një precedent profetik për një epidemi karkalecash që u shndërrua në ushtri për betejë. Por ende Perëndia po e kufi zon shkatërrimin që mund të sjellin këto krijesa djallëzore. Atyre nuk u lejohet të dëmtojnë bimët (kurse në 8:7 i gjithë bari në botë u shkatërrua, një kujtesë tjetër që këto profeci nuk duhen marrë gjithmonë sikur paraqesin në mënyrë të drejtpërdrejtë çfarë duhet të ndodhë). Dhe, më e rëndësishmja, ata nuk mund të dëmtojnë asnjë nga besimtarët që u vulosën në 7:4. Ata nuk mund t'i vrasin jobesimtarët, por vetëm t'i torturojnë për pesë muaj, një kohëzgjatje e përshtatshme për këtë vegim, sepse pasqyron jetëgjatësinë normale të një karkaleci (v. 5a).¹⁰⁸

¹⁰⁶ · Robert H. Mounce *The Book of Revelation* (Grand Rapids: Eerdmans, 1977), 302-3. Nuk e dimë për çfarë arsye ky shpjegim është fshirë nga botimi i rishikuar, megjithëse pozicioni i autorit mbi këtë çështje nuk duket të ketë ndryshuar.

¹⁰⁷ · David E. Aune, *Revelation 6-16* (Nashville: Nelson, 1998), 527.

¹⁰⁸ · Po aty, 530.

Megjithatë, ata janë në gjendje t'iu shkaktojnë vuajtje të mëdha njerëzve që mund t'i dëmtojnë gjatë kësaj periudhe (v. 5b - 6). Ironia është se Satani, i quajtur Shkatërruesi në vargun 11, u është kthyer të tijve, ashtu siç bën e keqja herët a vonë. Pastaj, Gjoni përshkruan luftëtarët-karkaleca demonikë me një sërë krahasimesh, padyshim, duke kërkuar me hamendje analogji me të cilat të përshkruajë të papërshkrueshmen (vv. 7-10). Tabloja u ngjan disi ushtrive të partëve me kuajt e veshur me armaturë, të zbukuruar me jele të gjata, dhe luftëtarët e hipur në ta gjuanin me shigjeta, edhe përpara, edhe mbrapa, për të sulmuar këdo që sulmonte nga anët. Disa herë ata rrotullonin edhe topuzë mbrapa kuajve.¹⁰⁹ Por, përsëri, ne nuk duhet t'i mendojmë si ushtri thjesht njerëzore; po ta bëjmë këtë, do ta “demitologjizojmë” apo do të hiqim elementin e mbinatyrshëm nga teksti.¹¹⁰

Së dyti, Gjoni dëgjon urdhrin për zgjidhjen e katër engjëjve të përgatitur për të vrarë një të tretën e njerëzimit (vv. 13-16). Mënyra se si do ta bënin këtë, do të ishte me anë të (fj alë për fj alë) “dy mizëri mizërish” kalorësish. Një mizëri (gr. *muriados*) mund të kishte kuptimin dhjetë mijë ose një numër shumë i madh.

¹⁰⁹ . George B. Caird, *The Revelation of Saint John the Divine* (London: Black; New York: Harper & Row, 1966), 122.

¹¹⁰ . “Gjoni, pa dyshim, do të kishte qeshur me përpjekjet për ta identifikuar këtë hordhi me një grup qeniesh njerëzore, sepse ai po fl et për principata dhe pushtete.” (Witherington, *Revelation*, 154).

Fakti që kuajt nxirrnin nga goja zjarr, tym dhe squfur, të gjithë elemente të lidhura me ferrin, sugjeron që ata janë po aq krijesa demonike, sa edhe karkalecat. Prandaj, përpjekja për t'i identifi kuar këto hordhi si ushtri njerëzore nga një vend aq i madh, sa të nxjerrë dyqind milionë ushtarë, e humbet krejt idenë e Gjonit. *Por, nëse krijesat janë demonike, atëherë lufta mund të jetë fare mirë luftë shpirtërore dhe vdekja e një të tretës së njerëzimit mund të jetë po aq shpirtërore, sa edhe fi zike* (vv. 17-19).¹¹¹ Është e habitshme që edhe pse gjykohet një pjesë kaq e madhe e njerëzve të botës, jobesimtarët që mbeten vazhdojnë të ndjekin idhujtarinë dhe imoralitetin (vv. 20-21).

Libërthi (10:1-11)

Ashtu si me gjykimet e vulave, ka një hapësirë midis borisë së gjashtë dhe të shtatë. Interludi përmban dy vegime krejt të ndarë nga njëri-tjetri. Vegimi i parë na tregon një engjëll me një “libërth” (*bibliarion* – forma zvogëluese e fj alës së përdorur në 5:1). Engjëlli përshkruhet me madhështi qiellore që na kujton Jezusin vetë (v. 1), por Jezusit askund në Shkrimet nuk i referohen si engjëll, prandaj nuk ka shumë të ngjarë që Ai të jetë këtu. Hollësisht e pamjes së engjëllit nuk duhen alegorizuar. Për shkak se fj ala për këtë libër në vargun 2a

¹¹¹ · Aune (*Revelation 6-16*, 539), vëren se ushtri të mëdha me engjëj shkatërrimtarë shfaqen dy herë në Talmudin Babilonas (*b. Shabbat* 88a; *b. Pesachim* 112b). Në fragmentin e fundit, “180 mijë engjëj shkatërrimtarë dalin çdo natë,” me sa duket, më tepër për të sjellë shkatërrim shpirtëror, sesa fi zik.

është e ndryshme nga ajo e përdorur më parë dhe, për shkak se ajo duket se i referohet një faze të re në zbulesën e Perëndisë (“të duhet *përsëri* të profetizosh” – 10:11), shumica e studiuesve e marrin për të vërtetë që përmbajtja e tij korrespondon me ato që thuhet te 11:1-13 – vegimi që merr Gjoni pasi e gëlltit libërthin dhe para se të rifi llojnë gjykimet e borive.¹¹² Por disa kanë sugjeruar që kjo është pjesë e librit të madh dhe e planit të Perëndisë që është shpalosur më parë.¹¹³ Fakti që këmbët e engjëllit janë mbi det dhe mbi dhe (v. 2b), sugjeron, në të dyja interpretimet, domethënien universale të kësaj zbuluese.

Kur engjëlli thirri me zë të madh, Gjoni dëgjon një zë të lartë të përshkruar si “shtatë bubullima” (v. 3). Por, kur ai fi llon me zell t’i shkruajë fj alët e tyre, siç ka bërë me gjithë zbulesat e tjera të Perëndisë deri tani, atij i thonë t’i “vulosë” fj alët e tyre dhe të mos i shkruajë (v. 4). Letërsia apokaliptike hebreje kishte disa herë zbulesa të fshehura midis atyre që ishin bërë publike (në Dhiatën e Re, krahaso zbulesën krejt private të Palit në 2 Korintasve 12:1-4).¹¹⁴ Nën dritën e idesë kryesore të vargjeve 5-7 që nuk do të ketë më vonesë, mund të imagjinojmë që shtatë bubullimat kanë patur gjykime të pazbatuara, të cilat Perëndia mund t’i kishte zbatuar, po të kishte lënë më shumë kohë deri në fund, por për këtë s’kemi si të jemi të

¹¹² P.sh. Mounce, *Revelation*, 202.

¹¹³ Shih: sid. Bauckham, *Climax of Prophecy*, 243-57.

¹¹⁴ Krahaso: Aune, *Revelation 6-16*, 562-63.

sigurt.¹¹⁵ Betimi formal dhe i ndërlikuar i vargjeve 5-6 e bën këtë pohim më solemn dhe më të sigurt.

Ndërsa Danielit ju tha se rezultati i profecisë së tij u vulos deri sa të vinte fundi, duke nënkuptuar se fundi nuk ishte ende afër (Dan 12:9), Gjonit i thuhet të vulosë ato që ka dëgjuar, sepse fundi *është* afër.

Ndërkohë që vula e pestë iu përgjigj thirrjes së martirëve për hakmarrje, me urdhrin për të pritur edhe pak (6:9-11), tani kemi ardhur edhe një herë në pragun e fundit (si me vulën e gjashtë në 6:12-17). Në të njëjtën kohë, mbeten për t'u treguar dhe tetë gjykime të tjera, kështu që duket sikur kemi një tjetër pamje të gjërave që do të ndodhin në të ardhmen, e cila nuk çon menjëherë në përfundimin e të gjitha gjërave.¹¹⁶

Ajo që Gjoni urdhërohet të bëjë me libërthin, pasqyron drejtpërdrejt detyrën që iu ngarkua Ezekielit disa shekuj më përpara (shih sidomos Ezekieli 3:3, 14). Në vegimin e tij, engjëlli i thotë Gjonit ta gllabërojë libërthin, duke e paralajmëruar se do t'ia hidhëronte stomakun, megjithëse në gojë do të ishte i ëmbël si mjalti (vv. 9-10). Me fj alë të tjera, gjykimet e ardhshme që atij i duhet t'i shpallë në lidhje me fatin e gjithë botës (v. 11) do të jenë, edhe të hidhura, edhe të ëmbla. Për besimtarët, fundi do të thotë shpëtim; për jobesimtarët, gjykim. Një pjesë e

¹¹⁵ P.sh. Caird, *Revelation*, 126.

¹¹⁶ Përkthimi KJV, "time will be no more," (koha nuk do të jetë më) të ngatërron, sepse kjo është e vërtetë vetëm në gjendjen e përvetshme (nëse edhe atëherë).

hidhërimit mund të përfshijë edhe përndjekjen që besimtarët do të duhet të durojnë përpara se nxjerrjes së tyre pa faj. Siç do të bëhet më e qartë në kapitujt 11-14, tri tema e përshkojnë këtë “interlud” të gjatë, para se të tregohen gjykimet e kupave: (1) *njerëzit e Perëndisë përjashtohen nga zemërimi i Tij*, (2) *por jo patjetër i shpëtojnë përndjekjes njerëzore apo djallëzore*; (3) *megjithatë, Perëndia më në fund do të ndreqë të gjitha padrejtësitë e kësaj epoke, duke sjellë jetë të përjetshme për ata që e mbështesin Atë dhe vdekeje të përjetshme për ata që e kundërshtojnë.*¹¹⁷

¹¹⁷ · Krahaso: Murphy, *Fallen is Babylon*, 260.

PYETJE SHITESË PËR PËRSËRITJE

1. Cilat janë disa nga sfi dat për t'ia veshur autorësinë e Zbulesës të njëjtit person që shkroi Ungjillin e katërt dhe letrat e Gjonit? Çfarë provash të jashtme e të brendshme mbështesin argumentin që ia atribuon Zbulesën këtij autori?
2. Hibrid i tri prej cilave gjini letrare hebreje dhe grekoromake është Zbulesa? Ku ngjan libri i Zbulesës me shkrime të tjera të lashta apokaliptike dhe ku ndryshon? Çfarë parimi hermeneutik kërkon natyra epistolare e Zbulesës?
3. Tri seritë e shtatave që paraqiten në Zbulesë janë kuptuar në mënyra të ndryshme. Cili nga të tre opsionet jep shpjegim për ngjarjet e Zbulesës?
4. Çfarë ndarje të thjeshtë të gjithë apokalipsit na jep Zbulesa 1:19? Si e ndihmon kjo lexuesin për të interpretuar siç duhet fi gurat dhe metaforat e ofruara në gjithë Zbulesën?
5. Ndoshta më shumë se çdo libër tjetër i Dhiatës së Re, Zbulesa kërkon disa vendime interpretuese që e diktojnë pastaj të kuptuarit e gjithë librit. Cilat janë këto çështje interpretuese dhe cilat janë pikëpamjet madhore brenda secilës nga këto çështje?

6. Cili është modeli i strukturës në secilën nga të shtatë letrat drejtuar kishave? Kë përfaqësojnë kishat? Përmbledhni idenë qendrore të mesazhit të Krishtit ndaj secilës nga të shtatë kishat dhe parimin që është i zbatueshëm për kishën e sotme. Çfarë informacioni historik në lidhje me secilën letër e ndihmon interpretuesin e sotëm ta rrokë më mirë kuptimin fi llestar që synonte autori?
7. Si duhen kuptuar metaforat e Krishtit si luani dhe qengji në gjithë Zbulesën? Çfarë e bën unike këtë fi gurë midis gjithë banorëve të qiellit?
8. Cili është qëllimi i synuar i vulave në Zbulesë? Cilat elemente nga vetë teksti dhe nga Dhiata e Vjetër i ndihmojnë interpretuesit të arrijnë në këtë përfundim? Përgjigjuni së njëjtës pyetje për boritë.
9. Cilat janë tri temat e rëndësishme që përshkojnë interludin e libërthit të Zbulesa 10?

Dy dëshmitarët (11:1-14)


Vegimi i dytë që Gjoni sheh para rënies së borisë së shtatë përfshin dy individë, të quajtur thjesht “dëshmitarët” e Perëndisë, që kanë ngjashmëri shumë të madhe me Moisiun dhe Elian në fuqitë e tyre mrekullibërëse, por që kryqëzohen dhe ringjallen ashtu si Jezusi. Shumica e komentatorëve e pranojnë se në gjithë Zbulesën ky është kapitulli më i vështirë për t’u interpretuar nga ana e detajeve, megjithëse temat kryesore mbeten të qarta deri në një masë të kënaqshme. Edhe

sikur e gjithë kisha ose vetëm të krishterët hebrenj (ose të krishterët e pasrreëmbimit) ta përjetojnë mundimin, është e natyrshme t'i shohim këta dy dëshmitarë si simbolikë apo përfaqësues të gjithë ndjekësve besnikë të Perëndisë që dëshmojnë gjatë kësaj periudhe të tmerrshme në fund të historisë njerëzore, siç e njohim ne. Megjithatë, jashtë qarqeve të studiuesve, ka shumë që preferojnë të imagjinojnë dy individë të vërtetë, mundësisht Moisiun dhe Elian e vërtetë të rikthyer nga qielli.¹¹⁸

Profecia e Gjonit këtu fi llon me një vegim të tempullit të Jerusalem dhe me një urdhër për ta matur dhe për të numëruar adhuruesit atje (v.1). Ashtu si te Zakaria 2:2, këto veprime simbolizojnë mbrojtjen e Perëndisë (fq 535). Vargu 2 tregon çfarë ndodh me oborrin e jashtëm që nuk matet – ai jepet për shkatërrim. Në vitet 90, audienca e Gjonit do të kishte menduar menjëherë për shkatërrimin e tempullit në vitin 70 pas Krishtit (krahoso sidomos Luka 21:24). Por atëherë u rrafshua i gjithë tempulli, jo vetëm pjesa e jashtme, kështu që mbrojtja e oborreve të brendshme dhe e vendit të shenjtë duhet të jetë shpirtërore, jo fi zike. Nëse Perëndia do ta përshkruante gjithë bashkësinë e besimtarëve si 144 mijë hebrenj, nuk është e vështirë të imagjinosh që do ta përshkruajë kishën e Tij si tempull; në të vërtetë ky është kuptimi që del

¹¹⁸ . Shih: Osborne (*Revelation*, 417-24) për një prezantim dhe diskutim të të gjitha interpretimeve. Mbi tipologjinë e Moisiut – që ndoshta është më e përhapura në Apokalips, shih: Peder Borgen, "Moses, Jesus and the Roman Emperor: Observations in Philo's Writings and the Revelation of John," *NovT* 38 (1996): 145-59.

vazhdimisht për fj alën *tempull* në gjithë letrat e Palit dhe të Pjetrit. Në këtë rast, kontrasti i jashtëm-i brendshëm do të sugjeronte mbrojtje të brendshme (shpirtërore), pavarësisht nga përndjekjet e jashtme (fi zike). Dhe, edhe një herë, kisha mund të shikohet si mbetja besnike e Izraelit.¹¹⁹



Dy dëshmitarët do të profetizojnë për 1260 ditë. Me tridhjetë ditë në vit, ky numër është i barabartë me 42 muaj apo tre vjet e gjysmë. Kjo kohëzgjatje vjen fi llimisht nga Danieli 9:27 dhe 12:7, duke iu referuar periudhës së fundit të kohës përpara se të plotësohen të gjitha profecitë e Danielit. Kjo periudhë kohe do të rikthehet në Zbulesa 12:6, 14 dhe 13:5. Meqenëse shtata është numri i plotësisë ose përsosmërisë në gjithë Zbulesën (dhe në pjesën më të

¹¹⁹ · Keener, *Revelation*, 288-89.

madhe të Biblës), domethënia më e mundshme e tre e gjysmës është që është gjysma e shtatës – një periudhë e paplotë që nuk përfaqëson fj alën e përsosur apo të plotë të Perëndisë mbi një çështje. E keqja ka fj alën e parafundit, por mundimi i lë rrugë të lirë gjykimit dhe hakmarrjes së Perëndisë, i cili zbulon verdiktin e Tij fi nal mbi historinë njerëzore.¹²⁰ Meqenëse shkelja e oborrit të jashtëm të tempullit e fi llon këtë periudhë 1260 ditore, zgjidhja më e mirë duket se është ta barazosh me “epokën e kishës” ose të paktën me periudhën e kohës që nga shkatërrimi i tempullit në vitin 70 pas Krishtit deri në kthimin në masë të hebrenjve në besim, që ndodh menjëherë para kthimit të Krishtit.¹²¹

Ne i shohim dy dëshmitarët në shërbesë, duke profetizuar të veshur me thes, veshja e lashtë karakteristike për zinë, në këtë kontekst, padyshim, duke vajtuar për mëkatet e botës në rebelimin e saj ndaj Krishtit dhe duke i bërë thirrje të pendohet. Në vargun 4, pemët e ullirit na kujtojnë simbolizmin e përdorur te Zakaria 4:6 për aktivitetin e Frymës së Perëndisë, ndërsa shandanët na kthejnë sërish te Zbulesa 1:20 ku thuhej se përfaqësonin kishat. Të dy këta imazhe na përforcojnë mendimin se *dy dëshmitarët portretizojnë kishën e Jezu Krishtit, duke shpallur me guxim ungjillin përmes fuqisë së Frymës në këto ditë të fundit*.¹²²

¹²⁰ : Krahaso: Roloff , *Revelation*, 130.

¹²¹ : Keener, *Revelation*, 287.

¹²² . “Zbulesa përsërit Porosinë e Madhe, por e vendos atë qëllimisht në kontekstin e mundimit dhe të vuajtjes.” Kështu mendon David E.

Edhe, ndërsa shtohet ndikimi i së keqes, po ashtu shtohen edhe efektet pozitive të shpalljes së lajmit të mirë të planeve të Perëndisë, ashtu siç çuan në eksodin fatkeqësitë që solli Moisiu mbi shtëpinë e faraonit. Në mënyrë të ngjashme, kur Elia thirri zjarr nga qielli, kjo çoi në shkatërrimin e profetëve të Baalit dhe profecitë e tij për thatësi dhe shi vunë në lëvizje ngjarje që pastaj përfunduan me përfundimin e mbretërimit të keq të Ashabit dhe Jezebelit (ndaj kemi edhe shëmbëlltyrën e përmendur në Zb. 11: 5-6).¹²³

Por, megjithatë, dëshmitarët duhet të vuajnë për një kohë të shkurtër pasojat e luftës së tyre shpirtërore kundër fuqive të së keqes. Ata martirizohen nga forca demonike (v. 7) dhe lihen të pavarrosur për t'u turpëruar. Ndërkohë, njerëzit e botës gëzohen me vdekjen e tyre (vv. 8-10). Sipas vargut 8, e gjithë kjo ndodh në “qytetin e madh” (një term i shekullit të parë për Romën), “i cili frymërisht quhet Sodomë dhe Egjipt” (vende me imoralitet të lartë dhe ku njerëzit e Zotit janë keqtrajtuar në kohën e Dhiatës së Vjetër), “ku është kryqëzuar edhe Zoti ynë” (Jerusalemi padyshim). Meqenëse asnjë vend nuk mund të jetë më shumë se njëri nga këto katër vende në të njëjtën kohë, qëllimi, me sa duket, nuk është të identifi kojë një vend të caktuar, por ta përngjasë përndjekjen që do të heqë kisha me atë të ushtruar mbi besimtarët e Dhiatës së Vjetër e të

Holwerda, “Th e Church and the Little Scroll (Revelation 10,11),” *CTJ* 34 (1999): 148.

¹²³ · Krahajo: Beasley-Murray, *Revelation*, 183-85.

Re dhe mbi vetë Jezusin.¹²⁴ Dhe tre ditët e gjysmë, kur dëshmitarët mbeten të pavarrosur, është përsëri një periudhë kohe e parafundit, sepse ajo ia lë vendin ringjalljes dhe ngjites në qiell të dëshmitarëve (vv. 11-12). Në të njëjtën mënyrë siç iu mor shfajësua dhe iu mor haku Jezusit, po ashtu edhe besimtarët mund t'i mbajnë shpresat te ringjallja dhe jeta e përjetshme me Perëndinë në vendet qiellore.

Për disa që shohin një kronologji strikte gjatë gjithë Apokalipsit, ky “rrëmbim” i shenjtorëve, që vjen (sipas këtij këndvështrimi) në mesin e gjykimeve të borive dhe të kupave, i ka dhënë nxitje pikëpamjes të rrëmbimit të kishës në mes të mundimit. Por, nëse boria e gjashtë na solli deri në pragun e fundit, kjo tablo po aq mirë mund të mbështesë pikëpamjen e rrëmbimit pas mundimit. Ata që mbështesin pikëpamjen e rrëmbimit para mundimit kanë dalë në përfundimin që kisha është rrëmbyer më herët, duhet t'i marrin dëshmitarët si shenjtorë individualë (ose si përfaqësues të numrit të vogël të besimtarëve që e kalojnë mundimin). Për këtë pozicion, ringjallja e dëshmitarëve nuk mëson asgjë për kohën e rrëmbimit.

Pas ringjalljes dhe ngjites në qiell të dëshmitarëve, një tërmet i madh shkatërron një të dhjetën e “qytetit të madh.” Meqenëse vriten shtatë mijë, mund të mendojmë se qyteti ka patur 70 mijë njerëz, afërsisht sa Jerusalemi i shekullit të parë. Nëse ky është kryeqyteti i hebrenjve,

¹²⁴ · Osborne (*Revelation*, 433) e përshkruan këtë tablo si “një përzierje të Jerusalemit dhe Romës në një kryeqytet të pashenjtë të Antikrishtit.”

ndoshta kthimi në besim i të mbijetuarve përfaqëson kthimin në masë në besim të hebrenjve menjëherë përpara kthimit të Krishtit (krahaso: Rom. 11:25-26).¹²⁵ Por, pa figura të tjera që tregojnë më qartësisht se janë hebrenj në vargun 13, është shumë e vështirë të jesh i sigurt për këtë sugjerim. Disa studiues, madje, e vënë në dyshim që “dhënia lavdi Perëndisë” këtu është më shumë se thjesht pranimi i veprave të tyre, si me shprehjen paralele tek Jozueu 7:19 drejtuar Akanit.¹²⁶ Sido që të jetë interpretimi, kemi edhe një shembull më shumë të natyrës korrigjuese të gjykimit të Perëndisë, edhe kaq afër përfundimit të gjërave dhe mbylljes së historisë. Ai po iu jep njerëzve çdo mundësi të pendohen, nëse duan të pendohen. Por kjo kohë nuk do të zgjatë shumë; boria e shtatë tregon marshimin e pandalshëm drejt fundit (v. 14).¹²⁷

Boria e shtatë (11:15-19)

Siç ndodhi me vulën e shtatë, edhe borinë e shtatë nuk e shoqëron ndonjë fatkeqësi e re, gjë që na përforcon

¹²⁵ · Shih: sid. Ladd, *Revelation*, 159-60.

¹²⁶ · Krahaso: Osborne (*Revelation*, 433-35), i cili e sheh në këtë si kthim në besim të disa njerëzve nga të gjitha kombet, me Mounce (*Revelation*, 22324), që e sheh këtë vetëm si pranim nga ana e tyre të fajit në përndjekjen e kishës.

¹²⁷ · R. Dalrymple (“Këta janë ata...[Zbu 7],” *Bib* 86 [2005]: 396-406) identifikon katër fokuse për të drejtët në kapitullin 11 të tij: mbrojtje hyjnore, dëshmi, durim të përndjekjes dhe shfajësim. Dy të parat prej këtyre karakterizojnë të 144 mijët te Zbulesa 7:1-8; dy të fundit turmën që askush nuk mund ta numëronte në 7:9-17, duke mbështetur edhe më tej barazimin e këtyre dy grupeve.

MUNDIMI

7 VJET?

Dëshmi e fuqishme

Përndjekje

e besimtarëve

e besimtarëve

APO

3 1/2 VJET?

Gjykimi i Perëndisë mbi jobesimtarët

Dëshmi e fuqishme nga besimtarët

dhe

Përndjekje nga Satan i besimtarëve

Besimtarët përjashtohen nga zemërimi i Perëndisë

Besimtarët nuk përjashtohen nga zemërimi i Satanit

sugjerimin e mëparshëm se ajo prezanton dhe përmbledh gjykimet e shtatë kupave. Zëra triumfues në qiell lavdërojnë Perëndinë, sepse erdhi koha që Ai të marrë në dorë mbretërimin (vv. 15-17) që do të sjellë ditën e gjykimit – duke shpërblyer shërbëtorët e Perëndisë dhe duke ndëshkuar armiqtë e Tij (v. 18). *Efekte zanore kozmike – bubullima, vetëtima, breshër dhe tërmet në qiell – e shoqërojnë borinë e fundit*, por asgjë nuk na thotë që ato ndihen në tokë deri këtu (v. 19).¹²⁸

¹²⁸ · Ladd, (*Revelation*, 164) shpjegon se bubullima, vetëtima, tërmeti dhe breshëri “janë mënyra të zakonshme për të shprehur madhështinë dhe pushtetin që shoqërojnë shfaqjen e pranisë hyjnore.”

Triniteti satanik: Ngritja dhe Rënia e afërt

Dragoi (12:1-17)

Këtu fi llon një interlud tjetër, për shkak se shtatë kupat e zemërimit të Perëndisë nuk përshkruhen deri në kapitujt 15-16. Por kapitujt 12-14 janë një seksion mjaft i madh dhe me një temë mjaft koherente të tyren, saqë formojnë më shumë se një interlud. Së bashku ata tregojnë kulmin e luftës shpirtërore me sulmin më të keq kundër njerëzimit nga ana e djallit (kapitujt 12-13), i cili më në fund nuk ia arrin qëllimit. Ndjekësit e tij munden, ndërsa gjithnjë e më shumë njerëz hyjnë në mbretëri (kap. 14). *Kapitujt 12-13 formojnë një të tërë, duke përshkruar me radhë të tre anëtarët e atij që është quajtur triniteti satanik – imitues të dobët të Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë.* Kapitulli 12 portretizon kreun e këtij triniteti: dragoin (v. 3) që është Satani (v. 9).

Edhe një herë vëmendja e Gjonit drejtohet në qiell. Këtë herë ai shikon portretin e lavdishëm të një gruaje të rrethuar nga dielli, hëna dhe yjet (v. 1). Të shkon mendja tek ëndrra e Jozefi t te Zanafi lla 37:9-11, që simbolizonte gjithë familjen e tij (dhe kështu gjithë Izraelin si një i tërë) që i përulëshin atij. Kjo grua është në dhimbjet e lindjes (v. 2); të prerat e lindjes rregullisht u referoheshin “mjerimeve mesianike” ose mundimit që judenjtë besonin

se do t'i paraprinte ardhjes së Mesisë.¹²⁹ Kur gruaja lind (v. 5), ajo lind një djalë që thuhet se plotëson profecitë e shoqëruara me Mesinë (v. 5a; krahaso: Ps. 2:9). Kjo do të na bënte të mendonim se gruaja duhet të jetë Maria ose ndoshta kombi i Izraelit si një i tërë. Por, në vargun 17, dragoi bën luftë kundër gruas dhe pjesës tjetër të pasardhjes së saj, në një kontekst që i referohet përndjekjes së besimtarëve. Prandaj ka mundësi që gruaja të përfaqësojë të gjithë “komunitetin mesianik.”¹³⁰

Kokat dhe brirët e dragoit na kujtojnë profecitë e Danielit 7-8 për perandoritë e ardhshme që do të luftonin kundër popullit të Perëndisë. Kurorat sugjerojnë pretendime për mbretërim dhe pushtet, duke imituar vetë Perëndinë. Flakja e një të tretës së yjeve të qiellit në tokë nga bishti i dragoit (v. 4a) mund të jetë në vazhdim të traditës judeje, në lidhje me rënien e atyre engjëjve që u bënë demonë.¹³¹ Ndërkohë, dragoi pret në qiell të gllabërojë fëmijën e gruas, sapo ai të ketë lindur (v. 4b). Fëmija mbrohet nga ky fat dhe vegimi kalon direkt nga lindja e Krishtit, në ngjitjen e tij në qiell (v. 5; kujtoni 11:12).

Megjithatë, ndjekësve të Krishtit u duhet të arratisen, por Perëndia i mbron ata për të njëjtën periudhë 1260 ditore që na prezantohet fi llimisht në 11:2-3 (v. 6). Meqë

¹²⁹ . Shiko sidomos në Qumran Hymns (1QH 3:1-11); krahaso: Murphy, *Fallen is Babylon*, 282-83.

¹³⁰ . Mounce, *Revelation*, 231.

¹³¹ . Osborne, *Revelation*, 461.

kapitulli 12 ka fi lluar me një kthim të shpejtë tek ardhja e parë e Krishtit, nuk mund thjesht t'i mbledhim bashkë të dyja periudhat prej tre vjet e gjysmë. Më shumë të ngjarë ka që të dyja t'i referohen të njëjtit interval midis brezit të parë dhe atij të fundit të historisë së krishterë.

Nuk është e qartë se kur ndodh lufta në qiell që përshkruhet pas kësaj. Vargu 4 e bën të duket sikur demonët janë fl akur nga qielli, para se të lindë Mesia, duke bërë që disa t'i shohin vargjet 7-9 si rënien prehistorike të Satanit dhe lakejve të tij. Megjithatë, vargu 4 e përshkruan Satanin në qiell kur Krishti fëmijë vjen në botë, duke sugjeruar që të paktën rënia e *tij* ndodh më vonë. Te Luka 10:18, Jezusi u përgjigjet raporteve të shtatëdhjetëve (apo shtatëdhjetë e dyve) për suksesin e shërbesës së tyre, duke thënë: “Unë e shikoja Satanin që po binte nga qielli si një rrufe.”¹³² Patjetër, rrjedhshmëria e metaforës apokaliptike do të thotë që Gjoni mund të mos e ketë ndër mend t'i përgjigjet fare kësaj pyetjeje! Sidoqoftë, ne e kemi mësuar tashmë se Gjoni beson se goditja vendimtare ndaj djallit kishte të bënte me vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit (kujto kap. 5), një ide kjo që bëhet edhe më e qartë në vargjet 10-11. Por, si një gjarpër me kokë të prerë, që përdridhet jashtë kontrollit në grahmat e vdekjes, djalli i plagosur për vdekje përpëlitet me furi në tokë, duke shkaktuar sa më shumë dëm që të mundet në atë pak kohë që i ka mbetur, para se të marrë fund një herë e mirë (v. 12).

¹³² · Krahaso: Witherington, *Revelation*, 171.

Vargjet 13-17 i rikthehen betejës midis dragoit dhe gruas. Ndjekja e tij në vargun 13 korrespondon me ikjen e saj në vargun 6 (vini re referencat për shkretëtirën në vv. 6 dhe 14a). Kështu që “një kohë, disa kohë dhe gjysmën e një kohe” në vargun 14b përputhet me tre vjetët e gjysmë të vargut 6 dhe, edhe një herë tjetër, me përafërsi barazohet me epokën e kishës. Sulmi vazhdon në vargun 15, derisa vjen mbrojtja e vargut 16. Por përndjekja ndaj të krishterëve, ndaj (“atyre që i ruajnë urdhërimet e Perëndisë dhe që kanë dëshminë e Jezu Krishtit”) vazhdon gjatë gjithë historisë së kishës (v. 17).¹³³

Bisha e parë (13:1-10)

Pas kësaj, Gjoni shikon një bishë që del nga deti, që ishte shpesh vend tmerri në botën e lashtë. Brirët dhe kokat e saj u ngjajnë atyre të të “atit”, dragoit, që i ka deleguar autoritet, dhe të dyja tablotë marrin fi gura nga Danieli 7 për atë që 1 Gjoni 2:18 e quan Antikrishti (vv. 1-2). Shenja më e qartë që kjo bishë është një imitim i Jezusit vjen në vargun 3a, ku duket se ajo ka patur një plagë vdekjeprurëse, por i është shëruar. Por Gjoni, me fj alët që përdor, sugjeron që dukja mund të mos përputhet me realitetin. Bisha përpiqet të duket si Krishti, por nuk ka përjetuar vërtet kryqëzim dhe ringjallje. Megjithatë, ai mashtron mjaft individë, saqë njerëzit në gjithë botën që

¹³³ · Keener (*Revelation*, 327) ka fj alë të qarta në lidhje me gatishmërinë për të përballur martirizim që do të jetë e nevojshme për të arritur ato pjesë të botës që janë më rezistente ndaj ungjillit.

kanë adhuruar dragoin do ta adhurojnë edhe bishën (vv. 3b-4). Audienca e Gjonit do të ketë menduar patjetër për pretendimin blasfemues të Domicianit se ishte Perëndi, bashkë me të thënat se ai (apo dikush tjetër që do të shfaqej së shpejti) ishte Neroni i rikthyer në jetë.¹³⁴

Antikrishti e ushtron autoritetin e vet për dyzet e dy muaj. Tani, për herë të parë, një periudhë e përshkruar si tre vjet e gjysmë duket se i referohet mundimit të madh në fundin e epokës së kishës (v. 5). Por, për shkak se periudhat e mëparshme prej tre vjet e gjysmë nuk ishin periudha të vërteta prej aq kohe, nuk ka arsye që të mendojmë se mundimi do të zgjatë vërtetë kaq.¹³⁵ Ideja këtu më shumë është të tregojë paralelizëm midis mundimit që ka karakterizuar gjithë historinë e krishterë dhe atij që do të jetë në fundin e kohërave. Fatkeqësitë mund të intensifi kohen në natyrë menjëherë përpara fundit, por ato nuk ka pse të jenë cilësisht të ndryshme nga ato që kanë ndodhur në epokat e mëparshme (vv.67a). Blasfemia dhe autoriteti i Antikrishtit kanë të njëjtin ndikim të gjerë mbi njerëzit nga të gjitha grupet etnike, ashtu siç vijnë edhe ndjekësit e Jezusit nga të gjitha këto grupe (vv. 7b-8a; kujtoni 7:9).

Ndërsa përmbushet Porosia e Madhe, armiqësia ndaj kishës rritet. Ndërsa shtohet përndjekja, gjithnjë e më

¹³⁴ · Mounce, (*Revelation*, 251) e përmbledh kështu këtë fi guracion: “Adhurimi i një perversioni të frymëzuar nga Satani të autoritetit laik është fyerja më e madhe kundër të vetmit Perëndi të vërtetë.

¹³⁵ · Krahaso: Ladd, *Revelation*, 180.

shumë njerëz bëhen besimtarë. *Shenja që po jetojmë në fundin e kohërave nuk është as krishterizimi i botës, as tmerret e pakrahësueshme të kohës, por polarizimi progresiv i të mirës dhe të keqes, ndërsa secila shtohet respektivisht me anë të fuqisë së Krishtit dhe të armikut.* Vargu 8b e bën të qartë që bota përfundon e ndarë në dy kampe – ata, emrat e të cilëve kanë qenë shkruar që nga krijimi i botës në librin e jetës dhe ata që zgjedhin të adhurojnë bishën.¹³⁶ Koha tani është aq e shkurtër dhe fatet e secilit grup aq të sigurta, saqë Gjoni i inkurajon besimtarët të kenë durim, edhe nëse vuajtja apo martirizimi bëhen të pashmangshme (vv. 9-10).

Bisha e dytë (13:11-18)

Anëtari i tretë i trinitetit satanik përshkruhet si një bishë nga toka (13:11-18). Kjo bishë imiton Frymën e Shenjtë. Ashtu si Fryma e Shenjtë është plotësisht një me Atin dhe Birin, kjo bishë e tokës duket si qengj (Antikrishti, imiton Qengjin e Perëndisë) dhe fl et si një dragua (Satani, që imiton vetë Perëndinë) (v. 11). Ashtu siç ushtron Fryma e Shenjtë autoritetin e Jezusit dhe i

¹³⁶ Megjithëse sintaksa e favorizon përkthimin: “të gjithë emrat e të cilëve nuk janë shkruar në librin e jetës që i përket Qengjit që u ther që nga krijimi i botës,” kjo nuk ka shumë kuptim logjikisht. Plani i Perëndisë për shpëtimin me anë të vdekjes së Krishtit u bë që përpara krijimit të botës, por Jezusi nuk u vra atëherë. Shpjegimi i përkthimit NIV është një përkthim i pranueshëm dhe jep kuptimin më të mirë konceptual. Është gjithashtu interesante të vëmë re se, për ata që adhurojnë bishën, nuk ka një deklaratë korresponduese, ndoshta përsëri për të nënkuptuar një paracaktim të vetëm.

fuqizon njerëzit që ta adhurojnë Atë, në të njëjtën mënyrë bisha e tokës ushtron autoritetin e bishës së parë, me qëllim që njerëzit ta adhurojnë atë (v. 12). Ashtu siç prodhoi Fryma gjuhë zjarri dhe i mbushi dishepujt ditën e Rrëshajeve, që të mund të bënin shenja dhe mrekulli, po ashtu bisha nga toka thërret zjarr nga qielli dhe bën shenja të rreme për të mashtruar ata që nuk janë të zgjedhurit e Perëndisë (vv. 13-14a). Ashtu siç ngrinin perandorët statujat e tyre, kjo bishë i urdhëron ata që ka mashtruar që të ndërtojnë një fi gurë të Antikrishtit, të cilës ajo i dha një frymë, si roli i Frymës në krijimin e njeriut (v. 14b-15).¹³⁷

Që “të gjithë ata, të cilët nuk e adhuronin fi gurën e bishës” u vranë, nuk mund t’i referohet çdo të krishteri, sepse dy vargjet që pasojnë përshkruajnë të krishterë që janë gjallë, të cilët po përjetojnë një bojkotim ekonomik ndaj tyre. Ndoshta kjo frazë u referohet atyre që e dëshmuuan besimin publikisht, kur iu dorëzuan autoriteteve (Shiko më sipër në faqen 10-11).¹³⁸

¹³⁷ · Me të vërtetë, kulti perandorak nxori një sërë paralelesh me shenjat dhe mrekullitë që përshkruhen në këtë kontekst nëpërmjet pajisjeve të ndryshme mekanike dhe formave të iluzionit. Shih: Steven J. Scherrer, “Signs and Wonders in the Imperial Cult: A New Look at a Roman Religious Institution in the Light of Rev 13:13-15,” *JBL* 103 (1984): 599-610.

¹³⁸ · Osborne (*Revelation*, 516) në mënyrë të ngjashme na tërheq vëmendjen ndaj kësaj praktike paralele të Plinit pesëmbëdhjetë vjet më vonë.

כ	י	ט	ח	ז	ו	ה	ד	ג	ב	א
20	10	9	8	7	6	5	4	3	2	1
ת	ש	ר	ק	צ	פ	ע	ס	נ	מ	ל
400	300	200	100	90	80	70	60	50	40	30
ר	ט	ק		נ	ו	ה	ב	NRWN QSR		
200 +	60 +	100		50 +	6 +	200 +	50			

Veprimi i fundit i bishës së tokës që shikon Gjoni është bërë më i famshmi. Jobsimtarët e çdo klase ekonomike e shoqërore marrin një lloj shenje në dorën e djathtë ose në ballë, e cila është e vetmja gjë që i mundëson ata që blejnë e të shesin (vv. 16-17). Ashtu siç u vulosën besimtarët me një shenjë në ballë, para se të fi llonte mundimi (7:3), edhe opozita satanike imiton vulosjen e Perëndisë me një shenjë mbi ndjekësit e saj. Nuk janë zbuluar praktika të lashta identike me këtë, por shoqëritë tregtare në botën greko-romake i kufi zonin disa transaksione biznesi vetëm për anëtarët e tyre (krahaso Ezekieli 9:4-7).¹³⁹ Kjo “damka e bishës” thuhet se është e

¹³⁹ : Edwin A. Judge, “The Mark of the Beast, Revelation 13:16,” *TynB* 42 (1991): 158-60. Philip A. Harland (“Honouring the Emperor or Assailing the Beast: Participatin in Civic Life among Associations (Jewish, Christian and Other) in Asia Minor and the Apocalypse of John,” *JSNT* 77[2000]: 99-121) thekson paralelet midis kishave të Gjonit dhe shoqërive vullnetare greko-romake më në përgjithësi, duke vënë në dukje mundësinë që disa nga këta të krishterë të merrnin pjesë në shoqëritë e esnafëve.

barabartë me emrin e bishës ose me numrin e emrit të saj. Kur llogaritet, ai numër është 666. Të shkon menjëherë mendja në përdorimin nga grekët dhe hebrenjtë të shkronjave për numra dhe tek *gematria*¹⁴⁰ përkatëse që i përcakton një domethënie të fshehtë shumës së numrave që iu korrespondojnë shkronjave të emrit të dikujt (apo diçkaje).

Që herët në historinë e krishterë, është sugjeruar që 666 do të thotë Neron Cezar, meqenëse bashkëtingëlloret e hebraishtes קסו (NRWN QSR) japin këtë shumë.

Problemi me këtë identifi kim është që funksionon vetëm në hebraisht, ndërkohë që Zbulesa u shkrua në greqisht dhe Neroni fliste latinisht. Përveç kësaj, kjo funksionon vetëm nëse përdoret një variant më pak i përdorur i emrit Neron, duke i shtuar një “n” në fund të emrit.¹⁴¹

Ndoshta shpjegimi më i mundshëm është që, ashtu siç është shtata numri i përsosur në pjesën më të madhe të simbolizmit të Zbulesës, 777 do të ishte numri për Trininë e përsosur. *Numri 666 atëherë, do të formonte një mënyrë të natyrshme për të simbolizuar përpjekjen e trinitetit satanik për të imituar në mënyrë qesbarake Atin, Birin dhe Frymën e Shenjtë, duke iu afruar me sa mundet, por pa e arritur kurrë.*¹⁴²

¹⁴⁰ · Gematria – (nga hebraishtja “gematrija”) është një sistem tradicional judaik që i cakton vlerë numerike një fjale apo fraze të caktuar (red. teol. F.M.).

¹⁴¹ · Që normalisht duhet të ishte Nero. (Shën. i Përkthyesit). Disa dorëshkrime e kanë 616, që është shuma e bashkëtingëlloreve pa “n-në” e tepërt, pra, të paktën disa skribë besonin se ishte fjale për Neronin.

¹⁴² · Shih: p.sh. Beasley-Murray, *Revelation*, 219-21.

Përpjekjet për të bërë *gematria* në disa gjuhë të sotme me emrin e një fi gure bashkëkohore e humbin krejt thelbin e simbolizmit të Gjonit. E po ashtu bëjnë ata që kërkojnë për një shenjtë të mirëfi llhtë që mund të vendoset në trupat e njerëzve ose që e barazojnë shenjtën e bishës me karta krediti, procesorë kompjuteri apo me World Wide Web – Rrjetin Botëror të Kompjuterave – sepse shkronja e gjashtë e alfabetit hebraik ishte W! Në të vërtetë, edhe përpjekjet për të identifi kuar Antikrishtin me një person apo lëvizje të tmerrshme, të paperëndishme, në një epokë të caktuar, tërheq vëmendjen nga jeta e krishterë me besnikëri, në të cilën i thërret vazhdimisht besimtarët apokaliptika biblike.

Historia e hamendësimeve hebreje dhe të krishtera se kush mund të jetë kjo fi gurë, mund të ishte një libër shumë interesant për t’u lexuar – janë ruajtur dhjetëra propozime – por përsëri 100% e tyre kanë dalë të gabuara, gjë që të paktën duhet të na frymëzojë kujdes të jashtëzakonshëm para sugjerimit (apo besimit të sugjerimit të dikujt tjetër) të një tjetër kandidati!¹⁴³ Në fund të fundit, meqenëse Satani nuk është i gjithëdijshtëm dhe, meqë vetëm Perëndia e di kohën e fundit, djalli duhet të ketë një “antikrisht” gati për çdo epokë, se mos ajo del të jetë koha që Zoti ka caktuar për fundin e gjithë gjërave.¹⁴⁴

¹⁴³ · Krahaso: sid. Bernard McGinn, *Antichrist* (San Francisco: HarperSanFrancisco, 1994).

¹⁴⁴ · Keener, *Revelation*, 342-43.

Nëse duam t'i vëmë gishtin dikujt, ndoshta duhet ta kthejmë atë nga vetja. Zbatimet e Petersonit janë aq të thella, sa meritojnë të citohen me detaje.

“Si të mbrohem nga mashtrimi i organizuar? Shën Gjoni është i drejtpërdrejtë; vini mendjen në punë. Kuptoni ç’po ndodh. Pjesa më e madhe e fesë që bie në sy dhe që është në modë në vend, në çdo kohë vjen nga bisha e tokës. Ekspozojini ato pretendime fetare. Kjo fe nuk ka të bëjë fare me Perëndinë. Kuptojeni numrin e saj: është një numër *njeriu*. Ky nuk është mister hyjnor, por e folur e shkathët e një njeriu të shkathët: është fe që bën spektakël, që mburr vetveten; fe që na i heq sytë nga Krishti i varfër, i vuajtur dhe i shenjtë. Në gjuhën e numrave, 666 është një dështim i trefi shtë për të qenë 777, numri tre herë i përsosur, i plotë, hyjnor. Një karakteristikë e shpeshtë e kësaj feje të bishës së tokës është që ajo komercializohet. Ajo kërkon buxhet të madh për të mirëmbajtur veten. Na manipulon ekonomikisht, duke na bërë të blejmë e të shesim kur të thotë ajo, duke tregtuar këshilla, ngushëllim, bekim, zgjidhje, shpëtim, ndjenja të mira. Strategjia e djallit këtu nuk është mesha e zezë, por tregtia në masë”.¹⁴⁵

¹⁴⁵ : Peterson, *Reversed Th under*, 126.

Fitorja e Qengjit mbi trinitetin satanik (14:1-20)

144 mijët *rishfaqen* (14:1-5) Pavarësisht mashtimit dhe terrorit që sjellin dragoi dhe dy bishat, lavdia e tyre do të jetë jetëshkurtër.

Kapitulli 14 ndahet në tri pjesë që përshkruajnë shpengimin e njerëzve të Perëndisë (vv. 1-5), gjykimin e atyre që e kanë pranuar shenjën e bishës (vv. 6-13) dhe “të korrën” e tokës (vv. 14-20). Skena e tretë duket sikur vë në kontrast kthimin në besim të shumë njerëzve nga çdo komb, me gjykimin e jobesimtarëve nga po i njëjti grup popujsh (vv. 14-20). Së bashku këto tri skena përgatisin rrugën për zbulesën e shtatë plagëve të fundit në kapitullin 15.

144 mijët e vargjeve 1-5, me sa duket, janë i njëjti grup si në 7:1-8.¹⁴⁶

Vula në ballet e tyre (7:3) tani specifi kohet si emri i Atit dhe i Qengjit (14:1). Zëri, si ushima e shumë ujrave, na kujton përshkrimin e zërit të Krishtit në 1:15. Por zhurma shndërrohet në tingujt e harpave dhe Gjoni dallon krijesat engjëjllore rreth fronit të Perëndisë, duke kënduar një këngë të re, të cilën vetëm të shpenguarit mund ta këndojnë bashkë me ta (vv. 2-3).

Vargu 4 ka zënë ngushtë shumë lexues; në botën tonë moderne ai mund të tingëllojë si misogynist.¹⁴⁷ Por

¹⁴⁶ . Beasley-Murray, *Revelation*, 222.

¹⁴⁷ . Misogjinist është personi që i urren femrat. (Shën i Përkthyesit). Siç pretendohet sid. nga Tina Pippin (*Death and Desire: The Rhetoric of Gender in the Apocalypse of John* [Louisville: WJKP, 1992] për të gjithë librin e Zbulesës.

“ndotja me femra” pothuajse me siguri përmban të njëjtin spektër metaforik që përdor edhe Dhiata e Vjetër, kur përshkruan mosbesnikërinë e njerëzve të Perëndisë, si shkelje kurore ose kurvëri ndaj Zotit.¹⁴⁸

Për metaforën “frytet e para” disa mendojnë se këtu flitet vetëm për martirët, që po e përjetojnë që më përpara të ardhmen e lavdishme që i pret gjithë besimtarët. Por frytet e para mund të përfaqësojë edhe përlëvdimin e besimtarëve që janë gjallë gjatë mundimit të madh, si kësti i parë i ringjalljes dhe përsosmërisë (krahajo v. 5) së të gjithë njerëzve të Perëndisë në të gjitha kohërat.

Sidoqoftë, këtu nuk kemi asgjë si në kapitullin 7 që të na sugjerojë se këta duhet të jenë të krishterë hebrenj.¹⁴⁹

Tre engjëjt (14:6-13) Vargjet 6-13 na tregojnë tre engjëjt që bëjnë shpalljet e fundit në lidhje me shpëtimin dhe gjykimin, megjithëse theksi këtu duket qartë që është mbi gjykimin. Engjëlli i parë vazhdon përmbushjen e Porosisë së Madhe, duke iu bërë thirrje njerëzve të “druajnë Perëndinë dhe t’i japin Atij lavdi,” në një kontekst ku ky

¹⁴⁸ · Shih: sid. Elizabeth Schüssler Fiorenza, *Revelation: Vision of a Just World* (Minneapolis: Fortress, 1991), 88. Ajo argumenton në mënyrë bindëse se në këtë rast pabesnikëria specifi ke është pjesëmarrja në kultin perandorak. Krahajo: Ruben Zimmerman, “Die Virginitäts – Metapher in Apk 14:4-5 im Horizont von Befl eckung, Loskauf und Erstlingsfrucht,” *NovT* 45 (2003): 45-70.

¹⁴⁹ · Edhe referenca ndaj Malit Sion nuk mund të jetë për malin tokësor mbi të cilin qëndronte tempulli hebre, sepse këta besimtarë, ashtu si edhe Qengji, qëndrojnë para fronit të Perëndisë. Përdorimi i kësaj fj ale nga Gjoni është analoge me Malin Sion qiellor tek Heb. 12:22.

urdhër i referohet qartë adhurimit të vërtetë (vv. 6-7), duke mbështetur sugjerimin tonë të mëparshëm se në 11:13 bëhej fj alë për kthimin në besim. Engjëlli i dytë shpall gjykimin e pashmangshëm mbi perandorinë e keqe që kishte ngritur triniteti satanik, e cila quhet këtu për herë të parë Babiloni, që të kujton kryearmikun e Izraelit shekuj më parë (v. 8). Por zemra e kësaj nënpjese është deklarata e engjëllit të tretë mbi gjykimin e atyre që morën shenjë e bishës (vv. 9-11). Ajo që ata menduan se po iu jepte privilegjin për të tregtuar me mallrat e kësaj bote i dënon në mundim të përvetshëm!¹⁵⁰ Tymi dhe squfuri mund të jenë metafora përsëri, por realiteti prapa tyre është qartësisht një realitet mbytës.

Është e vështirë të pajtosh deklaratën e qartë që ata “nuk do të kenë prehje ditë e natë” (v. 11) me pikëpamjen asgjësuese¹⁵¹ të ferrit, sipas së cilës jobesimtarët thjesht vdesin dhe pushojnë se ekzistuari (si ndarje e përvetshme nga Perëndia).

¹⁵⁰ . Mbi ndryshimin radikal të atyre që grumbullojnë nderin dhe turpin e botës dhe të atyre që fi tojnë miratimin apo mosmiratimin e Perëndisë, shih: David A.deSilva, “Honor Discourse and the Rhetorical Strategy of the Apocalypse of John,” *JSNT* 71 (1998): 79-110. Për më shumë detaje të kësaj teme për këtë fragment specifi k dhe për të treguar se si Gjoni thekson zëvendësimin e Romës nga Jezusi, si Gjykatësi dhe Mirëbërësi i vërtetë tek i cili duhet të drejtohen kishat e Tij, shih po aty: “A Sociohistorical Interpretation of Revelation 14:6-13,” *BBR* 9 (1999): 65-117.

¹⁵¹ . Pikëpamja asgjësuese – në anglisht termi është “annihilationism” (nga latinishtja “asgjësoj”). Sipas kësaj ideje, pas gjykimit përfundimtar, jobesimtarët asgjësohen, pra, nuk mundohen përjetësisht në ferr (red. teol. F.M.).

Megjithëse nuk e pakëson vuajtjen e besimtarëve, dijenia që përndjekja e tyre është afër fundit dhe që shtypësit e tyre do ta paguajnë shumë më shtrenjtë, duhet t'i ndihmojë ata të durojnë çfarëdo mundimi tjetër që duhet të kalojnë në tokë (v. 12). Pastaj, ata mund të shpresojnë në pushimin e përrjetshëm që munduesit e tyre nuk do ta kenë (v. 13).¹⁵²

Korrja dhe vjelja (14:14-20) Komentuesit debatojnë nëse të dyja skenat në këtë nënpjesë (vv. 14-16, 17-20) përshkruajnë gjykimin e jobesimtarëve apo nëse e para lajmëron kthimin e kombeve në besim. Për aq sa korrësi që mban drapërin përfaqëson bujkun në shëmbëlltyrën e farës që rritet në fshehtësi (Marku 4:26-29), ai do të ofronte një imazh pozitiv të korrësit të fryteve të mbretërisë së Perëndisë.

Për aq sa Gjoni po drejtohet te tabloja e ngjashme tek Joeli 3:13, portreti do të ishte portret gjykimi. Meqë të 144 mijët u quajtën frytet e para në fi llim të këtij kapitulli, duket më e natyrshme t'i shohësh këto si frytet që kanë mbetur, duke krijuar kështu një mbyllje rreth e rrotull

¹⁵² . “Disa mund të pyesin nëse ne mund të gëzohemi vërtet në parajsë, nëse e dimë fatin e përrjetshëm të të mallkuarve (14:10-11). Por qëllimi për shkruarjen e këtij lajmërimi është të sigurojë të krishterët që vuajnë për vënien në vend të drejtësisë (14:12). Për ata prej nesh që zakonisht përballen me një nivel shumë më të ulët shtypjeje dhe mundimi, ky imazh mund të mos na duket si shkak për festim. Për ta kapur plotësisht frymën e tekstit, ne duhet të hyjmë në vuajtjet e vëllezërve dhe motrave që vuajnë në vende të tjera të botës” (Keener, *Revelation*, 380).

gjithë nënpjesës.¹⁵³ Vargjet 17-20, nga ana tjetër, premtojnë pa ekuivoke gjykimin mbi armiqtë e Perëndisë nëpërmjet metaforës së vozës së zemërimit të Perëndisë. Mbështetësit e dragoit dhe të dy bishave do të paguajnë një për një “deri në qindarkën e fundit”, ashtu siç shkelet me këmbë rrushi i shtypur më parë me presë për t’i nxjerrë edhe pikat e fundit të lëngut. Metafora ia lë vendin realitetit që simbolizonte në fund të vargut 20, ndërsa lëngu i rrushit kthehet në gjak dhe arrin deri te frerët e kuajve mbi një zonë pak a shumë sa territori i Izraelit në shekullin e parë.¹⁵⁴

Shtatë kupat

Lavdërimi qiellor përgatit skenën për Gjykimet e Kupave (15:1-8)

Fillimin e fatkeqësisë së fundit nga të shtata e shoqëron më shumë lavdërim qiellor dhe gëzim midis besimtarëve . Njerëzit e Perëndisë qëndrojnë më këmbë në Dhomën e Fronit (kujtoni 4:6), duke mbajtur në duar harpa dhe duke kënduar “këngën e Moisiutdhe këngën

¹⁵³ · Krahaso: sid. Bauckham, *Climax of Prophecy*, 238-337. Për pikëpamjen që të dyja skenat i referohen gjykimet të besimtarëve, shih: sid. Eckhard J. Schnabel, “John and the Future of the Nations,” *BBR* 12 (2002): 24371.

¹⁵⁴ · Ladd, *Revelation*, 202. Nga ana tjetër, 1600-a mund të jetë përdorur meqë “është katrori i shumëzuar me 100 i 4-ës, numrit që shpreh plotësinë e botës (krahaso 7:1). Kuptimi atëherë do të ishte që shkatërimi përfshin gjithë botën në të gjitha rajonet e saj” (Roloff , *Revelation*, 178).

e Qengjit” (kujtoni 14:2-3). Ai lloj adhurimi që Izraeli i dha Jahves pas eksodit (Eks. 15) tani krishterizohet (vv. 3b-4). Adhurimi i ofruar nga gjithë kombet e përforcon përfundimin tonë që 14:14-16 përshkruante kthimin në besim të njerëzve nga gjithë grupet etnike të botës. Këtu kemi “kombet e bashkuara” të vërteta dhe pajtimin e përsosur racor.¹⁵⁵ Vargjet 5-8 kalojnë nga theksimi i adhurimit të Perëndisë në përshkrimin e lavdisë së Tij. Ashtu si tabernakulli dhe tempulli në tokë, në mënyrë figurative, strehonin lavdinë e Perëndisë, po ashtu edhe kjo shenjtërore qiellore, që vë në kontrast engjëjt përsosmërisht të pastër me plagë përsosmërisht të neveritshme, mbushet me tym temjani “nga lavdia e Perëndisë,” duke e mbushur krejt hapësirën e brendshme dhe duke penguar kështu hyrjen e të tjerëve.

Fillojnë Gjykimet e kupave (16:1-21)

Më në fund, shtatë gjykimet e fundit që përfaqësojnë zemërimin e Perëndisë mbi jobesimtarët derdhen mbi tokë (v.1). Pesë të parat i ngjajnë njëra – tjetrës dhe, ashtu si katër gjykimet e para të borive, na kujtojnë plagët që Moisiu solli mbi egjiptasit – *ulcerat, kethimi i ujërave në gjak, djegia nga dielli dhe errësira* (vv. 2-11). Por këtë herë nuk ka kufi zime në përqindjen e botës që goditet nga ato (shih sidomos v. 3). Përsëri, qëllimi i Perëndisë është që ata të pendohen, siç na e konfirmon vargjet 9-11 në një mënyrë të tërthortë, duke vënë re se njerëzit nuk pranuan

¹⁵⁵ . Osborne, *Revelation*, 573.

të pendohen.¹⁵⁶ Njëri nga engjëjt e kujton Gjonin se Perëndia është plotësisht i drejtë në këto gjykime, sepse njerëzit e prekur nga ato janë pikërisht ata që kanë munduar njerëzit e Perëndisë dhe kanë martirizuar shumë prej tyre (vargjet 5-6).¹⁵⁷

Ashtu si në dy seritë e mëparshme të gjykimeve, gjykimi i gjashtë ndryshon në mënyrë të dukshme nga pesë të parët. Kupa numër gjashtë *than Lumin Eufrat* (kufi ri ideal i Izraelit në verilindje), duke përgatitur rrugën për perandoritë nga ajo anë, që të kalojnë matanë pa vështirësi (v. 12). Lexuesit në Perandorinë Romake, në fund të shekullit të parë, përsëri do të kishin menduar menjëherë për Partët.¹⁵⁸ Nga “gojë” e trinitetit satanik tani dalin tri bretkosa (përsëri na kujtojnë plagët në Egjipt), të identifi kuara qartë se janë simbole të frymërave demonike që shpërndahen për t’iu mbushur mendjen gjithë fuqive të rëna botërore që të mblidhen për një betejë të madhe (vv. 13-14) në një vend të njohur si Armagedon (v. 16). Fjala hebraike që gjendet pas transliterimit të Gjonit në greqisht është *har magedon* – mali i Megidos. Në shekullin e parë, në atë vend, në majë të një kodre të lartë, qëndronte një fshat-kështjellë që shikonte mbi luginën e Jezreelit, famëkeqe si vendi i shumë betejave në kohërat e Dhiatës së Vjetër

¹⁵⁶ . Keener, *Revelation*, 400.

¹⁵⁷ . Krahaso: Mounce, *Revelation*, 294: “Gjykimi i Perëndisë nuk është as hakmarrës, as kapriçioz. Ai është një shprehje e natyrës së Tij të drejtë dhe drejtësidashëse.”

¹⁵⁸ . Krahaso: Aune, *Revelation 6-16*, 893.

(shih: Gjykatësit 5:19; 2 Mbret 9:27; 2 Kron 35:22). Por shprehja ndoshta ishte bërë proverbiale për çdo vend ku mund të zhvillohej një betejë vendimtare, siç përdorim sot shprehjen “Vaterlo”, sipas fushës së betejës ku Napoleoni më në fund u mund në vitin 1815.¹⁵⁹

Para se Gjoni të mund të përshkruajë se çfarë ndodh faktikisht kur mbretërit fi llojnë të luftojnë, ai i kujton lexuesit se sa papritur dhe sa shpejt do të kthehet Krishti (v. 15) dhe dëgjon engjëllin e shtatë që thërret: “U bë” (v. 17). Nuk mund të mos na kujtohen fj alët e parafundit të Jezusit nga kryqi: “U krye” (Gjoni 19:30). Ashtu si me vulën e gjashtë, duket sikur gjithësia po shpërbëhet (Zbu. 16-21). Armiqtë e Perëndisë përpiqen pa sukses t’iu shpëtojnë tmerreve, ndërsa qyteti i madh që përfaqëson perandorinë satanike, anti të krishterë të kohëve të fundit, bashkë me gjithë qytetet e tij satelite bie. Kjo pamje e fundit e lejon Gjonin të tregojë për shkatërrimin e kësaj perandorie dhe të vajtojë për të në dy kapitujt që pasojnë para se të kthehet në 19:19 në skenën e mbretërve të dheut të mbledhur për betejën përfundimtare që paraqitet këtu.

¹⁵⁹ · Alan F. Johnson, “Revelation,” në *Expositor’s Bible Commentary*, ed. Frank E. Gaebelin, vol. 12 (Grand Rapids: Zondervan, 1981), 552.

Mposhtja e fuqive të së keqes nga mbretëria e krishtit

Shkatërrimi i perandorisë së keqe të kohëve të fundit (17:1-18:24)

Përmasat fetare dhe politike (17:1-18) Kapitulli 17 e paraqet perandorinë e keqe të ditëve të fundit si një kurvë që ishte kurvëruar me mbretërit e dheut (vv. 1-2).¹⁶⁰

Gjoni këtu përsëri përzien imazhet e imoralitetit dhe idhujtarisë, për të sugjeruar një përzierje anti të krishterë të politikës dhe fesë. Lexuesit e Gjonit patjetër do të kishin menduar për Romën nën Domicianin. Vargjet 3-6a e ndryshojnë skenën, por realiteti që paraqitet mbetet i njëjtë. Tani kurva hiqet si mbretëreshë e veshur dhe e stolisur me pajisje mbretërore. Ajo rri e ulur mbi një bishë të kuqe (ngjyrë e cila përsëri është ngjyrë mbretërore dhe/ose e gjakut) e përshkruar si Antikrishti i 13:1.

Pavarësisht bukurisë në dukje dhe fuqisë që i rrethon të dyja krijesat, nga këndvështrimi i Perëndisë ato përfaqësojnë vetëm neveri dhe ndyrësi (v.4). Të dyja kanë emra blasfemie të shkruar në ballë dhe kurva përsëri quhet

¹⁶⁰ - Këtu dhe në kap. 21 shfaqen kulmimet e dy simboleve në kontrast me njëri-tjetrin që gjenden të shpërndarë në gjithë Apokalipsin – Babilonia, prostituta, dhe Jerusalem i Ri, nusja e Krishtit. Shih: Gordon Campbell, “Antithetical Feminine – Urban Imagery and a Tale of Two Women Cities in the Book of Revelation,” *TynB* 55 (2004):81-108. Për një lloj ekuivalenti në një libër shih: Barbara R. Rossing, *The Choice Between Two Cities: Whore, Bride, and Empire in the Apocalypse* (Harrisburg: Trinity, 1999).

Babiloni (kujtoni 14:8). Vargu 6a shpjegon mëkatën më të madh që ajo ka kryer – martirizimin e besimtarëve.¹⁶¹

Pasi zbrapset nga ky vegim i neveritshëm, Gjonit i jepet një shpjegim i hollësishëm i tij (vv. 6b-18). Bisha përsëri është një imitim qesharak i Perëndisë së përjetshëm, të cilin nuk arrin ta imitojë plotësisht. Në vend të jetë ai që ishte, që është dhe që do të vijë (kujtoni 1:4), bisha “ishte, dhe nuk është, ndonëse është” (v.8). Lexuesit e Gjonit do të kujtonin edhe legendat e *Nero redivivus*; që një ditë Neroni do të shfaqej përsëri për të rimarrë fronin, megjithëse në këtë kohë mungonte në peisazhin politik.¹⁶² Shfaqet përsëri fi gura e librit të jetës, këtë herë pa ndonjë sugjerim sado të vogël për fshirjen e emrave të njerëzve. Në vend të kësaj, ata që janë jobesimtarë janë thjesht ata që emrat e të cilëve nuk ishin shkruar në këtë libër që nga koha e krijimit, një motiv më ‘paracaktimor’ se ai që sugjerohet në 3:5.

Vargjet 9-11 duken të paktën po aq kriptikë (të fshehtë) sa edhe numri misterioz 666 në 13:18. Tamam si atje, edhe këtu thirrja për të qenë i urtë ndiqet nga një sërë numrash enigmatikë.

Antikrishti që të kujton Neronin, lidhet me qytetin që ulet mbi shtatë kodra – një mënyrë e zakonshme për t’iu

¹⁶¹ . Roloff (*Revelation, 197*) vëren se dy aspekte e karakterizojnë shfaqjen e gruas që rrinte mbi bishën – “sensualizëm luksoz dhe joshje arrogante,” dhe që “vrasja e dëshmitarëve të Jezusit bëhet për perandorinë triumfi fi nal i paperëndishmërisë së saj.”

¹⁶² . Gilles Quispel, *The Secret Book of Revelation* (New York: McGraw-Hill, 1979), 96.

referuar Romës dhe vendndodhjes së saj.¹⁶³ Ai është, gjithashtu, mbreti i tetë që, në njëfarë mënyre, i përket një serie prej shtatë mbretërisht, nga të cilët “pesë kanë rënë,” një është, dhe i fundit do të zgjasë vetëm për pak kohë. Asnjë përpjekje për të kombinuar këtë seri me perandorët e shekullit të parë (sidomos me Neronin dhe Domicianin, si i gjashti) nuk ka shumë kuptim dhe nuk është pranuar gjerësisht.¹⁶⁴ Prandaj përsëri, simbolizmi është ndoshta thjesht i shtatës si numri i plotë. Duke thënë që mbreti i gjashtë mbretëron tani, Gjoni nënkupton se, nga këndvështrimi i Perëndisë, koha deri në fundin e gjërave është e shkurtër. Përshkrimi i mbretit të tetë sugjeron që, edhe Antikrishti është një njeri me ndikim politik, por më haptas demonik.¹⁶⁵

Një aleancë jetëshkurtër bashkon dhjetë fuqi të tjera politike me Antikrishtin dhe mbështetësit e tij. Përsëri, numri është ndoshta një numër plotësie, megjithëse është interesante që Roma ishte ndarë në dhjetë provinca në atë kohë.¹⁶⁶ Këto forca së bashku do të përndjekin ndjekësit e

¹⁶³ · David E. Aune (*Revelation 17-22* [Nashville: Nelson, 1998], 920-22) vëren se një monedhë e fundit të shekullit të parë paraqet perëndeshën Roma si luftëtare, ulur mbi shtatë kodra me këmbën në lumin Tiber – të gjitha sfonte të mundshme për këtë referencë.

¹⁶⁴ · Për shtatë këndvështrime të ndryshme, shih: Osborne, *Revelation*, 61820.

¹⁶⁵ · Mounce, *Revelation*, 316-18.

¹⁶⁶ · Është patjetër e pajustifi kuar nga ana ekzegjetike dhe perverse nga ana teologjike të barazosh këto dhjetë fuqi me Bashkimin Ekonomik Europian, i cili për shumë vjet kishte dhjetë anëtarë. Sot ata numërojnë afërsisht njëzet e pesë, por, edhe kur ishin më pak besimtarët evropianë, po përmbushnin qetë-qetë ndërmarrje shumë të krishtera nëpërmjet

Krishtit, por më në fund do të munden (vv.12-14). Ndërkohë, e keqja kthehet kundër vetvetes përsëri, si me borinë e pestë dhe të gjashtë (kap. 9). Për më tepër, këtu ne kujtohem përsëri se Perëndia sillet në mënyrë asimetrike në lidhje me të mirën dhe të keqen. Ai dhe djalli nuk janë forca të barabarta, por të kundërta, siç paraqiten në fe të tjera të lashta dhe në teologjinë e sotme të “Luftës së Yjeve” (me anën e ndritshme dhe të errët të “forcës”), por përkundrazi, fuqia e Perëndisë gjithnjë mbetet superiore dhe qëllimet e Tij përmbushen gjithnjë, pavarësisht nga njerëzit e këqij apo fuqitë e këqia që mendojnë se mund të sundojnë të lirë dhe të pakontrolluar (vv.15-18).

Përmasat ekonomike (18:1-24) Kapitulli 18 e plotëson tablonë e kapitullit të mëparshëm duke i shtuar lajmërimin e shkatërrimit të “Babilonisë” (vv. 1-3), një thirrje njerëzve të Perëndisë për t’u veçuar prej saj (vv. 4-8) dhe një vajtim nga ana e të pushtetshmëve të botës për rënien e saj (vv. 9-19). Por njerëzit e Perëndisë kanë arsye të gëzohen (v. 20), sidomos sepse kjo përmbysje e së keqes është e plotë dhe e përhershme (vv. 21-24). Nga fundi i kapitullit nuk mund të ketë më dyshim që kjo është përfundimtare.

Vargjet 1-3 përsërisin imazhet kryesore nga kapitulli 17, me një shtesë kyçe – “luksin e shfrenuar” të Babilonisë. Kur shikojmë qeveri të këqia tokësore në çdo epokë, me potencialin për t’u zhvilluar në perandorinë e

kësaj organizate. Shih: Fred Catherwood, *Pro-Europe?* (Leicester: IVP, 1991).

fundit të kohërave, *nuk duhet të kërkojmë vetëm njësi të fuqishme nga ana politike që i përndjekin të krishterët dhe blasfemojnë Perëndinë triun, por edhe ato që grumbullojnë sasi të mëdha pasurie materiale*. Asnjë vend sot nuk është më i fuqishëm politikisht dhe më i pasur ekonomikisht, sesa Shtetet e Bashkuara. Dhe, ndërsa vlerat e trashëgimisë sonë judeokristiane vazhdojnë të gërryhen dhe, ndërsa është më e vështirë sot të dëshmosh për Jezusin në sektorin publik në këtë vend, sesa në Bashkimin Sovietik, ne s’kemi pse e drejtojmë gishtin përtej brigjeve tona, nëse kërkojmë shembuj të kurvës apo të bishës.¹⁶⁷

Kur këto rrethana të përputhen, të krishterët duhet të veçohen nga neveritë, jo patjetër gjeografi kisht, por nga sjellja, që të mos marrin një ndëshkim të njëjtë për mëkatet e tyre (vv. 4-8).

¹⁶⁷ · Ndoshta nuk ka vënie në dukje më të fuqishme të këtyre paraleleve, sesa në poemën e Xhulia Eskuivelit “Dita e Falënderimeve në SHBA” (Julia Esquivel, “Th ankgiving Day in the USA”) në *Th reatened with Resurrection* (Elgin: Brethren, 1982), 79-91. Ndërsa shkruaj skicën e parë të këtyre shënimeve në Ditën e Falënderimeve të vitit 2004, vë re se pak ka ndryshuar që nga 1980-a. Armët tona të sofistikuar po vrasin qindra, në mos mijëra, në Irak, jo në Amerikën Qendrore, por logjika prapa tyre mbetet e njëjtë. Është interesante që gjatë administratës së Klintonit në SHBA 1992-2000, shumë të krishterë të krahut të djathtë besonin me siguri se SHBA po rrëshqiste gjithnjë e më shumë në moçalin e parashikuar nga Zbulesa këtu. Gjatë administratës së Bushit, nga viti 2000 deri tani, shumë njerëzve iu duken mendime të tilla blasfemi. Të dy reagimet janë të ekzagjeruara dhe tregojnë problemet që rezultojnë kur përpiqemi ta lexojmë Zbulesën me lupë, sikur të jenë profeci të ngjarjeve që përmbushen në mënyrë unike pikërisht në kohën dhe kulturën e lexuesit. Por, herët a vonë, modat e përsëritura të çdo epoke do të vijnë në një përmbushje kulmore.

Megjithatë, pothuajse në çdo fushë kryesore morale, statistikat në Amerikë sot gati nuk tregojnë ndonjë ndryshim midis besimtarëve dhe jobesimtarëve, ndërsa përgjegjësitë ekonomike të të krishterëve zënë tepër pak vëmendje në predikimin dhe mësimin ungjillor. Zbatimi i Kreig Kinerit (Craig Keener) s'mund të ishte më i saktë dhe më me vend:

Sot më shumë se një miliard njerëz mbijetojnë me ekuivalentin e më pak se një dollari në ditë dhe punët po shkojnë edhe më keq. Hendeku ekonomik midis vendeve të pasura dhe atyre të varfra është dyfi shuar që nga viti 1960; 20 % -shi më i pasur i popullsisë së botës ka kaluar nga marrja e 70% të të ardhurave botërore në vitin 1960 në marrjen e 83% në vitet 1990; 20%-shi më i varfër kaloi nga 2,3 % në 1,4% në të njëjtën periudhë kohe, kështu që raporti i të ardhurave midis të pasurve dhe të varfërve kaloi nga 30 me 1 në 1960-ën, në 59 me 1 në 1989-ën.” Për shkak se ne kemi shumë të krishterë këtu dhe, për shkak se qytetarët e vendit tonë dhe aksionerët në korporatat tona kanë një zë, normalisht do të shpresonim që të punonin më shumë të krishterë për t'i barazuar më shumë gjërat në favor të vëllezërve dhe motrave tona që vuajnë në shumë vende të tjera...

Edhe diçka tjetër në lidhje me pikën tonë kryesore: ne konsumojmë mallra luksi shpesh në kurriz të burimeve të të tjerëve (krahaso 18:12-13). Stili i jetesës së familjes së mesme amerikane, krahasuar me atë të një miliard

njerëzve më të varfër të botës, është gati - gati si i një aristokrati mesjetar krahasuar me bujkrobërit e tij.¹⁶⁸

Dhe, a mund të themi me sinqeritet se ne nuk imitojmë arrogancën e kurvës në vargun 7 në gjithë argumentat që përdorim për të justifi kuar shpenzimet tona të jashtëzakonshme për veten në kurriz të të mjerëve dhe të atyre që vdesin, të cilët mund t'i ndihmonim në vendin tonë dhe në vendet e tjera?

Vargjet 9-19 mund të përmbliidhen në mënyrë prozaike në një fj alë. Të pasurit dhe tregtarët e botës vajtojnë se nuk kanë më mundësi të “blejnë derisa të bien”!

Vargjet 11-13 duken si një listë shitjesh në një mol të lashtë romak. Nga lista e Plinit me njëzet e shtatë artikujt më të shtrenjtë në perandori, në fi llim të shekullit të dytë, tetëmbëdhjetë janë këtu. Por, pas artikujve të luksit, shumica prej të cilëve importoheshin në Itali nga popujt e nënshtruar të perandorisë, vijnë artikujt bazë si vera, vaji i ullirit, mielli, gruri, lopë, dele, kuaj dhe qerre. Kulmi i listës vjen në vargun 13 me “trupa dhe shpirtra njerëzish” – tregtia romake e skllëvërve.¹⁶⁹ Vargjet 14-17 përmbledhin humbjen e pasurisë, duke përsëritur të gjitha temat e vargjeve 9-10, për të krijuar një mbyllje rreth kësaj liste mallrash luksoze. Vargjet 18-19 paraqesin detarët që

¹⁶⁸ · Keener, *Revelation*, 442-43.

¹⁶⁹ · Shih për më tepër Bauckham, *Climax of Prophecy*, 338-83; J. Nelson Kraybill, *Imperial Cult and Commerce in John's Apocalypse* (Sheffield: SAP, 1996).

transportonin mallrat nëpër Mesdhe, të cilët bashkohen me tregtarët në vajtimin për humbjen e “qytetit të madh” dhe të pasurisë së saj. Petersoni vë në duke në mënyrë të fuqishme se:

Në adhurimin e kurvës, ata kishin gjithçka dëshironin, jetën e mbushur me gjëra, dhe tani ajo ka marrë fund, humbi, mbaroi. Ata kanë mbetur pa asgjë nga ato që u ishin premtuar, që kishin investuar dhe që gëzonin. Nuk janë përmbysur bizneset e tyre, por feja e tyre, një fe teprimesh dhe marrjeje. Tani ka shkuar: shpëtimi nga çeqet ka shkuar, perëndia me porosi ka shkuar, kuptimi nga paraja ka shkuar, feja si ndjenjë ka shkuar, vetja si perëndi (e përkohshme) ka shkuar. Ata kanë mbetur pa asgjë tjetër, veç vetes së tyre, për të cilën, pas një jete të tërë në shtëpinë publike, nuk dinë asgjë.¹⁷⁰

Por, ndryshe nga të krishterët e sotëm amerikanë, besimtarët në Romën e lashtë ishin në pjesën më të madhe të varfër. Kështu që përmbysja e perandorisë premtonte për ta një shans të ri, si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ana fetare. Ishte me vend që të gëzoheshin (v. 20) tani që kurva dhe bisha ishin gjykuar. Fakti që shkatërrimi i Babilonisë është përfundimtar, ilustruhet edhe një herë të

¹⁷⁰ . Peterson, *Reversed Th under*, 148. Për një kapitull të detajuar sugjerimesh praktike se si besimtarët mund ta shmangin këtë fat në shoqëritë e sotme kapitaliste, shih: Wes Howard-Brook dhe Anthony Gwyther, “Coming Out of Empire Today,” në *Unveiling Empire: Reading Revelation Th en and Now* (Maryknoll: Orbis, 1999).

fundit me zhytjen e pashmangshme të një guri mulliri në det (v. 21). Edhe ngjarjet e zakonshme të jetës dhe të lumturisë janë zhdukur (vv. 22-23a), ndërsa magjia që kishte bërë aq shumë njerëz të adhuronin gëzimet tokësore dhe që çoi në martirizimin e profetëve dhe shenjtorëve është prishur (vv. 23b-24). Kultura më e madhe e narcisizmit është përmbysur!¹⁷¹

Vendosja e mbretërisë së Krishtit (19:1-20:15)

Parusia (19:1-20:3) Rënia e “Babilonisë” shkakton një litani halelujash qiellore (vv. 1-8) për triumfin e Perëndisë mbi armiqtë e Tij. Hakmarrja e drejtë që vetëm Perëndia mund ta ekzekutojë ka rënë më në fund mbi ata që e korrptuan tokën dhe martirizuan njerëzit e Perëndisë, dhe ndëshkimi do të jetë i përjetshëm. Kompania e të shpenguarve që janë tashmë në praninë e Perëndisë e lavdëron Atë (vv. 1-3), e po ashtu edhe engjëjt (v. 4). Pastaj të dy grupet me një zë të mrekullueshëm e përlëvdojnë atë së bashku në pritje të dasmës së Qengjit (vv. 6-8) – pika kulmore e profecisë së Isaisë për një banket eskatologjik (Isa. 25:6-8) – që është paralajmëruar disi në darkat e Jezusit me mëkatarët dhe në disa nga shëmbëlltyrat e Tij. Një lumturi për të ftuarit në banket dhe një shpallje tjetër solemne e vërtetësisë hyjnore (v. 9) është e kuptueshme që e bënë Gjonin të përgjigjej me adhurim. Por ai gabon duke u përlulur para lajmëtarit

¹⁷¹ · Krahajo: Osborne, *Revelation*, 659.

engjëllor, një bashkëshërbëtor i Krishtit, në vend të përulej para Perëndisë vetë. Prandaj engjëlli e qorton, duke i kujtuar që të adhurojë vetëm Perëndinë. Pastaj ai shton: “Sepse dëshmia e Jezusit është frymë e profecisë” (v. 10). Kjo thënie e çuditshme është interpretuar nga disa në qarqet karizmatike se dëshmitarët e vërtetë të Krishtit gjithnjë profetizojnë. Por një deklaratë e tillë do të ishte pa vend në këtë kontekst. Ka shumë më tepër të ngjarë që engjëlli ka dashur të thotë që profetët e vërtetë të krishterë (si Gjoni) duhet të pranojnë se askush tjetër veç Jezusit nuk mund të jetë në qendër të shpalljeve të tyre.¹⁷²

Me këtë rifokusim të vegimit, Gjoni është tani gati të shohë zbulesën e Krishtit, duke u kthyer në tokë nga qielli (19:11-20:3). Ndryshe nga simbolizmi i vulës së parë (6:2), këtë herë kalorësi mbi kalin e bardhë mund të jetë vetëm Jezusi. Emrat dhe atributet e Tij u bëjnë jehonë përsosmërive të Perëndisë; pamja e Tij të kujton diçka mbretërore dhe pastërti. Ai që vdiq si një qengj fl ijimi kthehet si një luftëtar hyjnor për të vrarë armiqtë e Tij dhe për të sunduar mbi ta (vv. 11-16). Emri i Tij na kujton përshkrimin të Gjoni 1:1 si Fjala e Perëndisë, citimi i Psalmi 2:9 përsërit Zbulesën 2:27, dhe metafora e vozës së zemërimit të Perëndisë na kujton 14:18-20.

Duke sfi duar drejtpërdrejt pretendimet blasfemuese të Domicianit, Gjoni shpall Krishtin, jo Cezarin, si “Mbret

¹⁷² · Krahaso: Witherington, *Revelation*, 234. Për një këndvështrim “edhe..., edhe” shih: Smalley, *Revelation*, 487.

i Mbretërve dhe Zot i Zotërve” (v. 16).¹⁷³ Ashtu siç triniteti satanik kishte imituar Perëndinë triun, ashtu Krishti do të japë një darkë për armiqtë e Tij që imiton dasmën e Qengjit: “gostinë e madhe të Perëndisë” (v. 17).¹⁷⁴

Por të ftuarit do të jenë shpendët që hanë kufoma, të cilët do të ngopen me mishin e armiqve të Perëndisë, sado të fuqishëm mund të kenë qenë ata në këtë botë (v. 18; krahaso Ezekieli 39:18). Me vargun 19 ne e vazhdojmë historinë atje ku e lamë në 16:16 – sundimtarët e paperëndishëm të tokës të mbledhur së bashku në Armagedon, për të luftuar kundër njerëzve të Perëndisë.

Tani Gjoni, në mënyrë të drejtpërdrejtë, e përmend bishën apo Antikrishtin si të pranishëm, ndërkohë që tregon qëllimin e ushtrisë së paperëndishme për të luftuar kundër Krishtit dhe ndjekësve të Tij.

Kjo betejë fi nale ka qenë objekt i kaq fi lmave dhe romaneve, pikturave dhe poemave, prandaj ia vlen të lexojmë çfarë thotë Bibla për të! Për habinë tonë, *nuk ndodh fare ndonjë betejë, të paktën jo në kuptimin e zakonshëm të luftës me viktimë në të dyja anët për një periudhë të gjatë kohe*.¹⁷⁵

Përkundrazi, ndërsa ne mbajmë frymën duke pritur fi llimin e luftimit, lexojmë që bisha dhe profeti i rremë

¹⁷³ . Osborne, *Revelation*, 686.

¹⁷⁴ . Aune, *Revelation* 17-22, 1063.

¹⁷⁵ . Ushtria që shoqëron Krishtin “nuk na thuhet se lufton. Në fakt ata mbajnë uniformë ceremoniale, jo veshje luftarake. Krishti bën luftën që duhet dhe këtë e bën me anë të fj alës së Tij” (Witherington, *Revelation*, 243).

(fryma e pashenj të apo qenia e tretë demonike) kapen dhe fl aken të gjallë në liqenin e zjarrtë (v. 20).

Në të njëjtën mënyrë, edhe ndjekësit e tyre vriten dhe kufomat e tyre konsumohen (v. 21).

Krishti i mposht armiq të Tij pa lënë që ndjekësit e tij të japin apo të marrin qoftë edhe një goditje të vetme!¹⁷⁶

Jomijëvjeçaristëve dhe pasmijëvjeçaristëve iu duhet ta interpretojnë 20:1-6 si një pamje të ardhjes së parë të Krishtit, ashtu siç dallojnë një pamje të tillë në 12:1-9 pothuajse të gjithë komentatorët. Patjetër që ka paralele midis 20:1-6 dhe ngjarjeve të shekullit të parë: lidhja e Satanit, ndarja e njerëzimit në mbështetës dhe kundërshtarë të Jezusit, dhe fi llimi i një jete të re shpirtërore për ndjekësit e Tij. Mbretërimi i tyre me Krishtin atëherë mund të shihet si fi torja shpirtërore që ata kanë në Të gjatë gjithë jetës së tyre dhe “epokës së kishës.” Lirimi i Satanit për një kohë të shkurtër në fund

¹⁷⁶ . “Një nga pasojat e paqëllimshme dhe të padëshirueshme të vegimit të Shën Gjoni për Armagedonin është që i ka ndezur imagjinatat e atyre që nuk e njohin Biblën me fantazi të pafund, në lidhje me fundin e kohërave, duke i shpërqendruar nga trimëria e përditshme e të qenit i bindur, pavarësisht nga rrethanat, i të dashurit në mënyrë sakrifi kuese dhe i të duruarit me vigjilencë. Kjo është tamam ajo që Shën Gjoni nuk e kishte ndër mend, siç mund ta kuptojmë edhe nga një lexim sipërfaqësor i Zbulesës së tij. Kur njerëzit janë të paditur për imazherinë e përdorur nga profetët dhe në ungjill, dhe të pamësuar me gjuhën metaforike të luftës në historinë e shpëtimit, ata bien lehtësisht pre e parashikimeve zbavitëse për një holokaust në malin Megido në Izrael në fundin e kohërave, të sajuar nga shkrimet e gazetave mbi politikën ndërkombëtare. Jezusi na e tha qartë se njerëzit që bëjnë këto parashikime sensacionale janë vetë Krishtërit e rremë dhe profetët e rremë nga të cilët pretendojnë të na ruajnë (Mat. 24:23-26)” (Peterson, *Reversed Th under*, 165)!

të kësaj periudhe do të korrespondojë atëherë me të këqiat që ai do të bëjë gjatë mundimit të madh, siç janë përshkruar në kapitujt e mëparshëm të Zbulesës. Ai, po ashtu, do të mashtrojë kombet dhe do të mbledhë ushtritë e tyre për betejë kundër të zgjedhurve të Perëndisë, vetëm për t'u gjykuar nga ndërhyrja e mbinatyrshme e Perëndisë dhe për t'u dënuar bashkë me ndjekësit e tij (vv. 7-15).

Nga ana tjetër, është shumë më e vështirë të prezantosh një ndarje letrare dhe një ndërprerje kronologjike midis 19:21 dhe 20:1, sesa midis 11:19 dhe 12:1. Në rastin e parë, ajo që vinte më pas ishte një skenë krejt tjetër; këtu ne sapo na është treguar për shkatërrimin e dy të tretave të trinitetit satanik, dhe tani mësojmë për fatin e një të tretës që mbetet – djallit. Pjesa 19:19-20:3 është një paragraf i pandërprerë që përshkruan se si të tria krijesat demonike gjejnë një fund të dhunshëm, kur Jezusi kthehet nga qielli. Në këtë lexim, Krishti kthehet *përpara* se të fi llojë mijëvjeçari në vargun 3.¹⁷⁷ Është apo s'është ky një mijëvjeçar i mirëfi llë, ka pak rëndësi. Ky numër i madh i rrumbullakosur mund të përdoret thjesht për të treguar karakterin dhe jo patjetër gjatësinë e kësaj periudhe – që është quajtur “pushimi i sabatit i

¹⁷⁷ . Për një listë të detajuar të argumenteve ekzegjetike këtu për mijëvjeçarin pas kthimit të Krishtit, shih: Keener, *Revelation*, 464-65. Krahaso edhe Beatrice S. Neall, “Amillennialism Reconsidered,” *AUSS* 43 (2005): 185-210.

historisë.”¹⁷⁸*Mijëvjeçari (20:4-15)*¹⁷⁹ Dy të tretat e para të vargut 4 përbëjnë një fj alë gjigande në greqisht. Duke e ndarë atë në përkthimin anglisht, NIV e keqdrejton lexuesin që të mendojë se vetëm ata të cilëve u qenë prerë kokat (ose, ndoshta – kemi të bëjmë me një sinekdokë¹⁸⁰ – që ishin martirizuar në çfarëdo mënyre) do të ringjallen për të jetuar gjatë mijëvjeçarit. Mirëpo, greqishtja e thotë në mënyrë më të drejtpërdrejtë që Gjoni pa ata “të cilëve u ishin prerë kokat... ,për shkak të fj alës së Perëndisë, dhe ata që nuk e kishin adhuruar bishën.” Me fj alë të tjera, të gjithë të shpenguarit – *edhe* ata që kishin vdekur më përpara e kishin shkuar në qiell dhe që u kthyen me Krishtin, *edhe* ata që ishin gjallë në kohën e Parusias

¹⁷⁸ . George R. Beasley-Murray, “Premillennialism,” in *Revelation: Th ree Viewpoints* (Nashville: Broadman, 1977), 67. Ideja është që, ashtu siç mund të fl asë Psalmi 90:4 për një ditë si një mijë vjet në sytë e Zotit, ashtu edhe Gjoni mund t’i ishte dhënë vegimi i pushimit të Sabatit për një periudhë të ngjashme kohe. Ka të dhëna që disa hebrenj dhe të krishterë të hershëm besonin se historia njerëzore do të zgjaste gjashtë mijë vjet dhe do të pasohej nga një mijëvjeçar për pushim. Ironia me të krishterët e sotëm që i referohen kësaj bindjeje, për të thënë se mijëvjeçari do të fi llojë diku rreth vitit 2000, është që, edhe kreacionistët që besojnë në një tokë të re nuk e përdorin më atë metodë që llogarit të gjithë vitet që përmenden në Bibël, pa lejuar mundësinë e ndonjë hapësire kohore të papërmendur, dhe arrin në përfundimin se Perëndia e krijoi universin rreth vitit 4000 para Krishtit. Edhe kreacionistët më striktë të ditëve të sotme pranojnë që toka ka ekzistuar për shumë më shumë se gjashtë mijë vjet.

¹⁷⁹ . Krahaso edhe J. Webb Mealy, *After the Th ousand years: Resurrection and Judgement in Revelation 20* (Sheffi eld: JSOT, 1992).

¹⁸⁰ . Sinekdoka – (nga greqishtja, “kuptim i atypëratyshëm”) është fi gura letrare ku një term që nënkupton pjesën e diçkaje përdoret për t’iu referuar tërësisë së saj ose anasjelltas. Për shembull, kur përdoret fj ala “rend” përdoret për t’iu referuar policisë (red. teol. F.M.).

/Ardhjes së Dytë – do t’i marrin trupat e ringjallur në të njëjtën kohë, ashtu siç premton 1 Selanikasve 4:15-17. Vetëm ata që vdiqën si jobesimtarë duhet të presin fundin e mijëvjeçarit për t’u ringjallur (v. 5); besimtarët mbretërojnë me Krishtin në një “epokë të artë” paqeje dhe drejtësie në tokë (v. 6).¹⁸¹

Megjithatë, ky lloj interpretimi paramijëvjeçaror përballet me disa pyetje të vështira. Kush mbetet në tokë për t’u sunduar nga shenjtorët? Kush mbetet për të rebeluar në fund të “një mijë vjetëve”? Në 19:21 “të tjerët” që ishin rreshtuar me Satanin dhe forcat e tij u vranë. Dy përgjigje të mundshme sugjerojnë veten: (1) E gjithë “beteja” mund të jetë shpirtërore/frymërore, kështu që këta adhurues të bishës thjesht konfi rmohen në rebelimin e tyre shpirtëror, duke mos qenë më as në pozitë për të shqyrtuar mundësinë e pendimit. Ose, ndoshta, me më shumë mundësi, (2) njerëzit e vrarë këtu vdesin fi zikisht, por ata janë thjesht ushtarët në ushtritë e bishës (krahaso v. 19), dhe jo çdo jobesimtar në planet.¹⁸² Po pse atëherë u jep Zoti atyre edhe një mundësi tjetër rebelimi në fund të mijëvjeçarit? Me sa duket, ai e bën këtë për të treguar se, edhe kur e drejta e zgjedhjes së lirë u kthehet atyre përsëri për pak kohë, ata pashmangshmërisht zgjedhin të

¹⁸¹ · Keener, (*Revelation*, 467) shpjegon: “Për shkak se Gjoni përfytyron se gjithë kisha ka nevojë për t’i rezistuar sistemit të botës, ai mund ta portretizojë kishën si kishë martire, megjithëse fj alët që përdor mund të nënkuptojnë se ka patur edhe të tjerë që i kanë rezistuar bishës, por nuk janë martirizuar.”

¹⁸² · Osborne, *Revelation*, 688.

keqen dhe luftën kundër Perëndisë, duke treguar se dënimi i tyre përfundimtar është krejt i drejtë.¹⁸³ Por, a sugjeron kjo atëherë që mijëvjeçari është një kohë kur besimtarët do të jetojnë në trupa të ringjallur përkrah me jobesimtarët me trupa të vdekshëm dhe, a nuk është kjo kaq e çuditshme sa të jetë e pabesueshme? Është e çuditshme, sigurisht, por, nëse besojmë se Jezusi u ringjall trupërisht nga varri (për të mos përmendur ringjalljen e disa shenjtorëve të përzgjedhur te Mateu 27:51-53), kjo ka ndodhur një herë kur Jezusi iu shfaq disa herë ndjekësve të Tij ende të paringjallur.¹⁸⁴ Ndryshimi, kur kjo të ndodhë përsëri në mënyrë më të zgjeruar, është vetëm sasior, jo cilësor.

Por ç'mund të themi për përjetimet e shenjtorëve në qiell? A nuk është tepër antikulmore që të të gëzosh lumturi të plotë në një gjendje të ndërmjetme pa trup, drejtpërdrejt në praninë e Perëndisë, dhe pastaj të të duhet të rikthehesh përsëri në një tokë ende të papërsosur, sado më e mirë se më përpara të jetë gjendja gjatë mijëvjeçarit? Varet. Lumturia pa trup nuk është gjithçka që Perëndia kishte ndërmend nga fi llimi për krijesat e Tij. Planet e Tij për njerëzimin nuk janë të plota, derisa njerëzit e Tij të

¹⁸³ - Kjo është pika më e afërt e Shkrimit me pikëpamjen e mundshme, por përfundimisht të paprovueshme, të C. S. Luisit në romanin e tij të mrekullueshëm, *Divorci i Madh* (*The Great Divorce*), ku, edhe ata që vuajnë tashmë tmerret e ferrit, nuk do të zgjidhnin të largoheshin dhe të shkonin në parajsë, sikur t'iu jepej mundësia, për shkak se u mungon aftësia për t'u kënaqur me të.

¹⁸⁴ - Krahajo: Ladd, *Revelation*, 268.

jenë përsëri qenie tërësore, të ribashkuar në trupa dhe shpirta tërësisht të përlëvduar. Dhe asgjë në këtë kapitull (apo në profeci të ndryshme të Dhiatës së Vjetër që shpesh supozohet se përshkruajnë këtë periudhë kohe) nuk sugjeron se lumturia e njerëzve të Perëndisë gjatë mijëvjeçarit errësohet në ndonjë mënyrë thjesht sepse qielli i ri dhe toka e re nuk kanë ardhur ende. Vetë fakti që ne e ngrejmë këtë pyetje tregon se sa të platonizuar janë në të vërtetë shumë të krishterë. Ne mendojmë se lumturia jashtëtrupore – pavdekësia e shpirtit – është gjithçka duhet të mezipresim – ndërkohë që, siç e thotë shumë bukur N.T. Rajt, shpresa e vërtetë e krishterë është “jeta *pas* jetës pas vdekjes.”¹⁸⁵

Për më tepër, Perëndia e krijoi këtë botë dhe të gjitha krijesat “të mira,” ndërsa njeriun e krijoi “shumë të mirë” (Zan. 1). Pavarësisht mëkatit tonë dhe përhapjes së gjerë të së keqes, Ai do t’i përligjë ato qëllime fi llestare të krijimit për *këtë* botë, para se të vazhdojë me modelimin e një kozmosi të rikrijuar tërësisht.

Kapitulli 20:7-15 përshkruan kryengritjen dhe gjykimin e fundit në fund të mijëvjeçarit. Vargjet 7-10 përshkruajnë lirimin e fundit të Satanit nga burgimi i tij në humnerë, në mënyrë që ai të “mashtrojë kombet” në gjithë botën edhe një herë të fundit (vv. 7-8). Këtu këtyre kombeve iu referohet si Gogu dhe Magogu, emra që Gjoni i ripërdor nga Ezekieli 38. Nëse bëhet fj alë për një

¹⁸⁵ . Wright, *The Resurrection of the Son of God*, 31 et *passim*.

vend të identifi kueshëm, Ezekieli ndoshta e kishte fj alën për Gigun e Lidisë, në Turqinë e sotme jugperëndimore. Megjithë pretendimet për të kundërtën në disa “manuale profecie” të sotme, nuk ka lidhje gjeografi ke apo etimologjike midis këtyre termave dhe ndonjë vendi në ish - Bashkimin Sovjetik apo Rusinë e sotme.¹⁸⁶ Për më tepër, deri në kohën e Gjonit ka të ngjarë që shprehjet të ishin bërë po aq proverbiale sa “Armagedoni”. Në fund fare, Lidía (apo edhe Rusia jugore) zor se do të ishte konsideruar si një nga cepat e largët të dheut në periudhën romake.

Dhe, për ta plotësuar, Gogu dhe Magogu kanë lidhje me ngjarjet *përpara* kthimit të Krishtit vetëm në interpretime jomijëvjeçare ose pasmijëvjeçare. Në një interpretim paramijëvjeçar (që është zakonisht ajo që mbështesin shkruesit e këtyre manualeve profetike), këta emra iu referohen skajeve të tokës vetëm në *fund* të mijëvjeçarit! Por, ashtu siç ndodhi me kombet e përgatitur për të luftuar në Armagedon, këto ushtri thjesht përgatiten për luftë. Në vend që të sulmojnë njerëzit e Perëndisë, bie zjarr nga qielli dhe i shkatërron. Dragoi, Satani, hidhet në liqenin e zjarrit ku janë hedhur më parë edhe bisha dhe

¹⁸⁶ . Në Ezek. 38:2 Gogu del si princi kryesor i Meshekut dhe Tubalit. Këto “nuk janë format origjinale të Moskës dhe Tobolskut! (Ata janë emrat hebraikë për grupe të Anadollit Lindor të njohur nga historianët klasikë si Moskët dhe Tibarenët.)” (Mounce, *Revelation*, 372, n. 5).

profeti i rremë (kujtoni 19:19-21) dhe ku do të mundohet përjetësisht.¹⁸⁷

Në këtë pikë, të vdekurit e këqij ringjallen, gjykohen dhe dërgohen në ferr, në atë që Gjonit e sheh si “gjykimi i fronit të madh të bardhë” (vv. 11-15). Baza për dënimin e tyre është intriguese. Rishfaqet fi guracioni i librave. Nga njëra anë, njëri libër me sa duket ka të shkruara të gjitha bëmat e njerëzimit (vv. 12-13). Kështu që të këqijtë gjykohen mbi bazën e atyre që kanë bërë. Nga ana tjetër rishfaqet edhe libri i jetës dhe, nëse emri i ndokujt nuk u gjend i shkruar atje, edhe ai do të dënohet (vv. 12,15). Kështu që, edhe mospërfshirja e tyre nga Perëndia midis të zgjedhurve, edhe veprat e tyre të këqia i dënojnë.¹⁸⁸ Përpjekjet për të përkufi zuar më tej marrëdhënien e këtyre dy shkaqeve me njëri-tjetrin duhet të shkojnë përtej çdo gjëje që nënvizon teksti këtu.

Qiej të rinj dhe Tokë e re

Përjetësia (21:1-22:6) Në “Babiloni” njerëzimi përpiqet të krijojë parajsën në tokë pa Perëndinë dhe

¹⁸⁷ · “Ata që fyhen nga një mësim i tillë e kuptojnë shumë cekët natyrën e tmerrshme të mëkatit dhe reagimin e natyrshëm që shenjtëria hyjnore duhet të ketë ndaj tij” (Osborne, *Revelation*, 717).

¹⁸⁸ · Duke iu mbajtur pikëpamjes se vetëm martirët ringjallen gjatë mijëvjeçarit, Mounce (*Revelation*, 377) supozon që pjesa tjetër e të vdekurve të krishterë gjykohen këtu dhe që emrat e tyre janë në librin e jetës. Megjithatë është e mundur, asgjë nuk thuhet shprehimisht për këtë, vetëm për ata emrat e të cilëve nuk janë në librin e jetës.

dështon plotësisht. Për ata që i rezistojnë kësaj shtyse dhe presin për Perëndinë, Perëndia premton ta ribëjë tokën dhe qiellin, për të krijuar parajsën më të përsosur që mund të imagjinohet, që njerëzit e Tij ta gëzojnë në përjetësi. Nëse do të ketë një shkrirje të universit me zjarr (2 Pjetrit 3:10), kjo do të ishte koha logjike dhe vendi logjik për këtë. Por, pas qiellit të vjetër dhe tokës së vjetër, vijnë një qiell i ri dhe një tokë e re (v. 1a), siç është profetizuar që tek Isaia 65:17-25 (megjithëse atje mbeteshin nja dy papërsosmëri që janë zhdukur këtu). Mungesa e detit (v. 1b) nuk duhet t'i zhgënjejë ata që iu pëlqen të lundrojnë apo të peshkojnë. Në kohën e Gjonit deti ishte shpesh burim tmerri. Njerëzit mbyteshin, anijet fundoseshin, stuhitë shfrynin zemërimin e tyre dhe, më e keqja nga të gjitha, demonët besohej se banonin atje.¹⁸⁹ Në kontrast të plotë me këtë, në përjetësi “vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim” (v. 4).

E shprehur konkretisht, një qytet i shenjtë do të zbresë nga qielli i ri për të zbukuruar tokën e re. E fi lluam në një kopsht, por do të përfundojmë në një qytet – *njerëzit e Perëndisë në komunitet të përsosur*.¹⁹⁰ Fakti që qyteti quhet Jerusalemi i ri sugjeron plotësimin e gjithë premtimeve

¹⁸⁹ - Krahaso: Aune, *Revelation 17-22*, 1119.

¹⁹⁰ - Shumë njerëz e imagjinojnë jetën e përtejme si një parajsë idilike, private, por Perëndia përshkruan këtu masa të tëra njerëzish që jetojnë me njëritjetrin! Në këtë botë të rënë, qytete të tilla prodhojnë patjetër të këqija të mëdha, por në kozmosin e ri mëkati do të zhduket. “Ne hyjmë në parajsë, jo duke u ikur gjërave që nuk na pëlqejnë, por me anë të shenjtërimit të vendit në të cilin Perëndia na ka vendosur” (Peterson, *Reversed Th under*, 174).

ndaj Izraelit, si edhe ndaj njerëzimit në këtë zbulesë.¹⁹¹ Por qyteti është edhe nuse (ashtu si Jahveh dhe Krishti portretizohen si dhëndurë për ndjekësit e tyre në gjithë Dhiatën e Vjetër dhe të Re).

Fokusi i vëmendjes është mbi njerëzit dhe jo mbi vendet (v. 2).¹⁹² Dhe më e madhja nga të gjitha është që të shpenguarit e Perëndisë do të kenë një bashkësi të pakrahasueshme, intime me Të (v.3). Fakti që e gjitha kjo ndodh, sepse qyteti zbret nga qielli, sugjeron që përjetësia është tërësisht krijim i Perëndisë dhe jo i njerëzve (v. 5a).¹⁹³ Nuk është çudi që Gjonit i thuhet t'i shkruajë të gjitha këto (v. 5b) , megjithëse këtu më shumë se kudo tjetër ai duhet ta ketë ndjerë pafuqinë e gjuhës së papërsosur, të fundme, për të përshkruar përsosmërinë e pafundme dhe madhështore!

Ashtu si në 16:17, Gjoni dëgjon shqiptimin solemn: “U bë.” Perëndia përsërit titujt e Tij të përjetshëm prezantuar fi llimisht në 1:8. Duke i bërë jehonë Isaisë 55:1, Ai u ofron falas ujë të gjallë atyre që kanë etje (v. 6). Të gjithë atyre që “fi tojnë” (kujtoni fundin e secilës prej shtatë letrave në kapitujt 2-3), ai u premton këtë

¹⁹¹ . Krahaso: Celia Deutsch, “Transformation of Symbols:Th e New Jerusalem in Rv 21, 1-22, 5,” *ZNW* 78 (1987): 106-26. Imazhi është shfaqur tashmë si “Jerusemi qiellor” te Gal. 4:26 dhe Heb. 12:22. Për një studim të hollësishëm të kësaj teme dhe të Zbulesës 21-22, shih: Phichan Lee, *Th e New Jerusalem in the Book of Revelation* (Tübingen: Mohr, 2001).

¹⁹² . Krahaso: Robert H. Gundry, “Th e New Jerusalem: People as Place, Not Place for People,” *NovT* 29 (1987): 254-64.

¹⁹³ . Keener, *Revelation*, 486.

trashëgimi kaq madhështore (v.7). Por vargu 8 na kujton se ferri ekziston ende në këtë kozmos të ri. Litania e mëkatarëve këtu lidhet drejtpërdrejt me ata të i përndoqën të krishterët në jetët e tyre të vdekshme dhe/ose e mohuan Jezusin nën kërcënimin e përndjekjes (v.8).¹⁹⁴

Pjesa tjetër e këtij seksioni shpjegon detajet e Jerusalemit të ri. Vargjet 9-14 përshkruajnë shkëlqimin e tij dhe pasqyrimin nga ana e tij të lavdisë së Perëndisë. Dymbëdhjetë portat na kujtojnë dymbëdhjetë fi set e Izraelit, ashtu si dymbëdhjetë themelet e qytetit përfaqësojnë dymbëdhjetë apostujt (vv. 12, 14). Njerëzit e besëlidhjes së Perëndisë nga Dhiata e Vjetër dhe nga Dhiata e Re tani janë bashkuar në mënyrë të pandashme. Përmasat e qytetit e bëjnë atë një kub të përsosur me lartësi astronomike (vv. 15-17). I vetmi ndërtim me këtë formë i mirënjohur në Mesdheun e lashtë ishte Shenjtërorja e Shenjtërore në tempullin e Jerusalemit. Mungesa e një tempulli të mirëfi lltë në Jerusalemin e ri (v. 22) mund të sugjeronte që i gjithë qyteti, i gjithë komuniteti i të shpenguarve të Perëndisë, tani funksionon si kryepriiftëri, duke patur hyrje të drejtpërdrejtë te Perëndia. Gjatësia e 12 mijë kubitëve përsëri sugjeron simbolizmin e plotësisë (kujtoni 7:5-8).¹⁹⁵

¹⁹⁴ · Shih listën e hollësishme të elementeve dhe shpjegimin e tyre po aty, 489-90.

¹⁹⁵ · Witherington (*Revelation*, 268) nxjerr si përfundim se “nuk ka më ndarje të laikes dhe të të shenjtës. I gjithë qyteti është një tempull i shenjtë, sepse

Gurët e çmuar në themelet e tij (vv. 19-20) na kujtojnë pectoralin e Aaronit tek Eksodi 28:17-20, i cili ishte zbukuruar me shumë gurë të njëjtë, të përshtashëm për një komunitet të tërë priftëror.¹⁹⁶ Pjesa tjetër e mureve, portave, dhe rrugëve të qytetit përbëhen nga metalet më të bukura dhe më të çmuara. Rrugët prej ari mund të tregojnë aspektin mbretëror, krahasimi i arit me qelqin duket qartë se aludon për pastërti (vv. 18, 21).

Nëse të gjithë besimtarët kanë hyrje të drejtpërdrejtë te Perëndia, Perëndia në Krishtin mbetet fl ijimi i përjetshëm. Kështu, siç e parashikoi Jezusi që te Gjoni 2:19: “Zoti Perëndi i plotfuqishëm dhe Qengji janë tempulli i tij [i qytetit]” (Zbu. 21:22). Po ashtu, drita e tyre zëvendëson çdo nevojë për diell apo hënë, për ndriçimin e këtij komuniteti të shenjtë (v. 23). Në të njëjtën kohë, në një farë mënyre të pathënë, vazhdimësia me rendin e vjetër mbetet. Njësitë e quajtura dikur “kombe” (ose më mirë “grupe etnike”) dhe sundimtarët e tyre, në njëfarë mënyre, ekzistojnë ende; ata që u shpenguan sjellin “shkëlqimin,” “lavdinë dhe nderin” në Jerusalemin e ri (vv. 24, 26; krahaso gjithë Isainë 60).¹⁹⁷

Perëndia është me popullin e tij në të gjithë qytetin dhe ata janë tempulli i Tij.” Në lidhje me dymbëdhjetë mijë kubitët, ai gjithashtu vëren se sipërfaqja e qytetit do të përafrohej me “gjithë gjysmëhënën mesdhetare nga Jerusalemi deri në Spanjë,” dhe se “Gjoni në këtë rast do të sugjeronte se krijesa e re është e barabartë me popullin e ri të Perëndisë ose me komunitetin e tyre të ri” (fq. 269).

¹⁹⁶ · Keener, *Revelation*, 496.

¹⁹⁷ · Dave Matthewson (“Th e Destiny of the Nations in Revelation 21:122:5: A Reconsideration,” *TynB* 53 [2002]: 121-42) heton mundësitë

Megjithëse qyteti ka ende mure, si të gjitha qendrat e mëdha urbane në botën e Gjonit, portat e tij nuk mbyllen asnjëherë, sepse nuk kanë mbetur rreziqe nga të cilat të mbrohet komuniteti. Tmerret e natës po ashtu mungojnë (v. 250). Megjithatë, ashtu si vargu 8, edhe vargu 27 aludon për faktin që të këqijtë ekzistojnë ende, por në ferr ata nuk mund t'iu bëjnë më asgjë të keqe këtyre banorëve të parajsës.

Gjoni nuk shikon det në tokën e re, por ai shikon lumin e jetës, duke dalë nga froni i Perëndisë dhe duke kaluar mes për mes qytetit (22:1). Kjo të kujton veçanërisht lumin që lidhet me tempullin e ri të Ezekielit (Ezek. 47:112). Ky paralel, i kombinuar me rolin e gjithë qytetit si një “shenjtërore e shenjtërore” e re, sugjeron se përmbushja e vërtetë e profecisë së Ezekielit vjen në përjetësi, jo në ndonjë ndërtesë të mirëfi lltë të rindërtuar në Izraelin si vend i udhëhequr nga hebrenjtë.¹⁹⁸ Ashtu si lumi, pema apo pemët e jetës ushqejnë popullin e Perëndisë, duke patur gjithmonë frut për t'i ushqyer ata në mënyrë të mjaftueshme (v. 2a). Ata që kishin nevojë për shërim, tani janë shëruar.¹⁹⁹ “Froni i Perëndisë dhe i

kryesore, duke dalë në përfundimin se gjuha e Gjonit thekson “kombet që do të kthehen në besim në të ardhmen, në përmbushje të profecive të DHV (Isa. 2:2-5; 60).” Por, ndryshe nga theksi në gjithë veprën e Bauckham-it (*Climax of Prophecy*), Matthewson-i nuk sheh që theksi i Gjonit mbi shpëtimin universal të tejkalojë apo të ketë përparësi mbi gjykimin universal. Të dy duhen lejuar të qëndrojnë bashkë.

¹⁹⁸ . Keener, *Revelation*, 497.

¹⁹⁹ . Në greqisht nuk ka folje, kështu që duhet të vendosim formën e foljes “jam” që i përshtatet më shumë kontekstit. Meqenëse thuhet në fj alinë

Qengjit” nuk janë më thjesht në parajsë/qiell. Ata kanë edhe korresponduesit e tyre në tokën e re (vv. 1, 3b).

Referenca ndaj “shërbimit” ngre pyetje kurioze në lidhje me çfarë lloj veprimtarish do të përfshihemi në përjetësi, por i lë ato pa përgjigje. *Latreno* këtu mund të ketë thjesht kuptimin “adhurim.” Sidoqoftë, marrëdhënia intime që do të kemi me Perëndinë tani e përligj metaforën se do të “shohim fytyrën e Tij” që më parë gjithmonë ndalohej me dënimin me vdekje. Emri i Tij mbi ballet tona tregon identifi kim dhe pronësi/zotërim (v. 4). Vargu 5 përsërit mendimet e 21:23, ndoshta sepse ato janë tepër mahnitëse, dhe mbyllet me mbretërimin tonë të përjetshëm. Vargu 6 krijon një përmbyllje/inkluzion me 21:5 në lidhje me besueshmërinë e fj alëve të Perëndisë dhe një tjetër me 1:1 në lidhje me sa shpejt do të ndodhin këto gjëra.

Mbyllja (22:7-21)

Tri herë në këtë mbyllje, Jezusi vetë përsërit refrenin: “Ja, unë vij shpejt” (vv. 7a, 12a, 20).²⁰⁰ Lumturia e v. 7b rimerr temën e 1:3, vetëm se tani bekimi nuk është thjesht për atë që e lexon këtë profeci, por për atë që u bindet

tjetër që nuk ka më mallkim, është e pamundur të besojmë se Gjoni mendon se ndokush do të kishte nevojë për shërim në Jerusalemin e Ri. Përkthimi duhet të lexohet: “Dhe gjetet e pemës *ishin* për shërimin e kombeve.” Teksti nuk e mbështet as universalizmin, thjesht përmbushjen e Porosisë së Madhe. Krahajo po aty, 511; Osborne *Revelation*, 772.

²⁰⁰ · Beale (*Revelation*, 1135) vë në dukje se ngjarja e dytë kryesore në historinë e shpëtimit pas ditës së Rrëshajeve është parusia, (ardhja e dytë e Krishtit, shën. i përkth) kështu që ajo do të jetë gjithmonë “shpejt”-s’ka rëndësi sa vjet kalojnë.

mësimeve të saj (një kujtesë që profecia është më shpesh qortim/mësim sesa parashikim). Vargjet 8-9 krijojnë një përsëritje të 19:10. Ata që dyshojnë se Gjoni mund të ketë bërë dy herë të njëjtin gabim, duhet të kenë një këndvështrim jorealit mbi shenjtërimin e krishterë dhe duhet të mos e kuptojnë se sa i madh ka qenë tundimi për t'u përulur përpara dikujt që të zbulon gjëra kaq të mahnitshme. Vargu 10a është në kontrast edhe me 10:4, edhe me Danielin 12:4 (për të cilin shihni më lart, fq. 66). Vargjet 10b-11 sugjerojnë që fundi është kaq afër, sa që është tepër vonë që njerëzit të ndryshojnë rrugët e tyre (kujtoni 13:10),²⁰¹ megjithëse kjo nuk mund të thuhet në mënyrë absolute, sepse njerëzit pendohen dhe kanë edhe mundësi të tjera të pendohen, të cilat nuk i shfrytëzojnë, në disa vende në gjithë Zbulesën.²⁰²

Ashtu si në kapitullin 1, Jezusi mund të jetë fi llimi dhe fundi, tamam si Perëndia (v. 13). Vargjet 14-15 formojnë një përmbyllje me 21:7-8. Për herë të parë në të gjithë librin, Jezusi tani e identifi kon veten me emër, si edhe me tre tituj të qartë mesianikë, të gjithë nga Shkrimi i shenjtë hebraik (v. 16). E vetmja përgjigje e duhur, logjike ndaj kësaj zbuluese kaq madhështore, nga kushdo që dëgjon çfarë kanë thënë Fryma dhe njerëzit e Perëndisë, është të vijë dhe të pranojë ftesën për të marrë falas jetën e përjetshme (v. 17). Megjithatë, për çudi, disa ende refuzojnë. Akoma më keq, disa do t'u shtojnë apo do t'u heqin fj alëve të kësaj profecie. Reagimi i

²⁰¹ · Roloff, *Revelation*, 251.

²⁰² · Osborne, *Revelation*, 786.

Perëndisë do të jetë që t'iu mohojë atyre pjesë në jetën që do të vijë, që përshkruhet në mënyrë shumë të fuqishme këtu (vv. 18-19). Këto paralajmërime e kanë zanafi llën në LiP 4:2 dhe nuk mund të zbatohen për të gjithë kanonin e Shkrimit. Në kontekstin e Gjonit, ato zbatohen në mënyrë strikte ndaj librit të Zbulesës vetë. Por domethënia e kanonizimit të njëzet e shtatë dokumenteve të veçantë dhe krijimi i një Dhiate të Re është që të gjithë këta libra duhet të trajtohen me të njëjtin respekt dhe frikë.²⁰³ Ata që e ndryshojnë Fjalën e Perëndisë në mënyrë domethënëse në lidhje me “kush-in” dhe “si-në” e shpëtimit dhe gjykit nuk mund të pretendojnë se janë njerëzit e Tij. Përgjigjet liturgjike të gjysmës së dytë të vargut të parafundit dhe të vargut të fundit e pohojnë edhe një herë këtë të vërtetë, luten për kthimin e shpejtë të Krishtit dhe shqiptojnë një formë të shkurtuar të hirit të 2 Korintasve 13:14 mbi gjithë besimtarët.

²⁰³ · Krahaso Peter Balla, “Evidence for an Early Christian Canon (Second and Third Century),” në *The Canon Debate*, ed. Lee M. McDonald dhe James A. Sanders (Peabody: Hendrickson, 2002), 375.

ZBATIM

Në vend që ta lexojmë Zbulesën sikur të ishte një manual mbi ngjarjet e sotme, ne duhet të përpiqemi të kuptojmë të vërtetat e gjithkohëshme, premtimet dhe paralajmërimet që ka si synim të komunikojë simbolizmi apokaliptik. Ndërsa një brez do të shikojë me të vërtetë përmbushjen përfundimtare të ngjarjeve të profetizuara në apokalipsin e Gjonit, brezat para tij do të jetojnë shumë përmbushje të ngjashme parapërfundimtare. Perëndia nuk na ka dhënë (as ka patur ndër mend të na japë) një hartë rrugore të detajuar, që të jemi të sigurt se kur do të jetë afër përmbushja përfundimtare, pikërisht sepse lloji i gjërave që ai parashikon ndodhin pjesërisht herë pas here si një parashije e “fi nales së madhe.” Detyra jonë nuk është të predikojmë apo të dëgjojmë predikime, të shkruajmë apo lexojmë libra, apo të ndjekim media të tjera që pretendojnë se i dinë ato gjëra për të cilat Jezusi tha në mënyrë të përsëritur se nuk mund t’i dimë – kohërat dhe stinët e realizimit fi nal të realitetit që gjendet prapa gjithë këtyre simboleve. *Ajo që duhet të bëjmë ne është të fokusohemi në mesazhin qendror të librit që, më në fund, pavarësisht nga gjithë larmishmëria e njerëzimit, ka vetëm dy destinacione përfundimtare të mundshme për njerëzit – një papërsbkrueshmërisht i mrekullueshëm dhe një paimagjinueshmërisht i tmerrshëm. Përgjigjja ndaj Jezusit (Qengjit që është edhe Luan) është e vetmja gjë në botë që përcakton se si do ta kalojmë përjetësinë.*

Ndërkohë, historia njerëzore po shkon diku; dhe çdo ngjarje, sado e tmerrshme, mbetet nën drejtimin sovran të Perëndisë. Këto të vërteta duhet t’iu japin inkurajim të fortë besimtarëve në çdo lloj rrethane, sado të vështirë. Nëse nuk mund ta llogaritim kohën e kthimit të Krishtit, të paktën mund të kemi një ide se si do të jenë ditët menjëherë përpara saj. Do të jetë koha e polarizimit më të madh në histori midis të mirës dhe të keqes, ndërkohë që Fjala e fuqishme e Perëndisë shkon deri në skajet e tokës dhe njerëz nga të gjitha grupet e mëdha etnike në tokë vijnë në besim. Në të njëjtën kohë, ata që e hedhin poshtë ofertën e Krishtit për shpëtim, do t’i kundërshtojnë besimtarët me përndjekje të paprecedent, ndërkohë që Perëndia nga ana tjetër e zbraz zemërimin e Tij mbi jobesimtarët me fatkeqësi dhe katastrofa të një shkalle rekord. Nuk është për t’u habitur që të krishterët e vërtetë, në këtë kontekst, mund të përshkruhen si fi timtarë!²⁰⁴

Libri i Zbulesës: *Plani i Perëndisë për historinë kozmike*

Ata që janë vërtet të shpëtuar do të qëndrojnë deri në fund, por do ta demonstrojnë këtë shpëtim pikërisht me anë të qendrueshmërisë së tyre. Megjithatë, kompensimi në qiejt e rinj dhe token e re është i mrekullueshëm.

²⁰⁴ · David Scholer (“Breaking the Code: Interpretive Reflections on Revelation,” *ERT* 25 [2001]: 304-17) tregon se si libri zbatohet më shumë si manual mbi dishepullëzimin, sidomos gjatë vuajtjeve të mëdha, sesa si “kriptogram” i ngjarjeve të asaj kohe apo të së ardhmes.

“Basti” i famshëm i Blez Paskalit këtu zbatohet më mirë se kudo. Nëse ateizmi ka të drejtë dhe krishtërimi e ka gabim, gjithçka që mund të humbin besimtarët është jeta fi zike, ndërsa, nëse ateizmi e ka gabim dhe krishtërimi drejt, ateistët mund të vuajnë tmerrësisht, të dëbuar përgjithmonë nga prania e Perëndisë dhe nga të gjitha gjërat e mira. Nëse ndonjë fe tjetër ka të drejtë dhe krishtërimi e ka gabim, ende shumica e të krishterëve kanë mundësi të mira për një jetë të mirë pas vdekjes, sepse të gjitha fetë e tjera në një nivel apo në një tjetër, në thelb kanë shpëtimin me anë të veprave. Dhe të krishterët e vërtetë shfaqin shumë vepra të mira, ndërsa jetët e tyre përputhen gjithnjë e më shumë me imazhin e Krishtit. Por, nëse gjithçka varet nga hiri nëpërmjet besimit, atëherë njerëzit e gjithë feve apo ideologjive të tjera duhet të heqin dorë nga çdo përpjekje për të merituar favorin e Perëndisë dhe duhet ta dorëzojnë veten tërësisht në mëshirën e Tij, duke besuar se vetëm Ai mund t'i shpëtojë, në mënyrë unike, nëpërmjet kryqit të Krishtit. Besimtarët, po ashtu, nuk triumfojnë në jetë, po në vdekje. Fitorja e tyre mbi vdekjen e zbeh gjithçka tjetër në këtë jetë. Nisur nga slogani i sotëm i reklamave: “Mund të kemi gjithçka!”, do të themi: Por, që të kemi gjithçka, duhet të pranojmë kushtet e Perëndisë dhe të presim për kohën e Tij të përsosur.

PYETJE SHITESË PËR PËRSËRITJE

1. Cila është mënyra më e mirë për t'iu përgjigjur pretendimit të përsëritur se ne jemi patjetër në brezin e fundit të argumentuar me praninë e të keqes në botë dhe ungjillëzimin gjithnjë e më të madh të popujve të paarritur më parë? Cili është ai parim i shëndoshë eksegetik për të përcaktuar se kur do të vijë fundi? Shikoni në mënyrë të veçantë kapitullin 11.
2. Krahasoni trinitetin satanik të Zbulesës 12-14 me Trininë e Shenjtë. Në ç'mënyra përpiket triniteti satanik të imitojë Trininë e Shenjtë? Tregoni se si secili pjesëtar i trinitetit satanik imiton njërin nga personat e Trinisë së Shenjtë. Cila është tema kryesore që u komunikon lexuesve vegimi i trinitetit satanik?
3. Cila është lidhja midis vulave dhe borive me kupat? Ç'pjesë e njerëzimit preket nga secila prej tyre dhe si synonte autori të kuptoheshin numrat specifi kë që përmenden aty? Diskutoni interludet dhe domethënien e tyre në secilën nga këto seri prej shtatë gjykimesh.
4. Çfarë vegimesh përshkruajnë përmasat politike, fetare dhe ekonomike të perandorisë së madhe e të keqe të kohëve të fundit? Në cilat të vërteta më prozaike përkthehen ato?

5. Si e përshkruan Gjoni betejën fi nale në Armagedon?
Si ndryshon ky përshkrim nga ajo që paraqitet shpesh në media ose në tregime që bazohen në mënyrë liberale mbi ngjarjet e Zbulesës? Si përgatiten dhe armatosen besimtarët për betejën që do të shfronësojë përfundimisht Satanin dhe të keqen?
6. Cilat janë disa nga idetë dhe pjesët kyçe në Zbulesë që i përdorin paramijëvjeçaristët, pasmijëvjeçaristët dhe jomijëvjeçaristët për të mbështetur pozicionet e tyre? Analizojini ngjarjet e Armagedonit bazuar në këto tri interpretime. Kur ndodhi apo do të ndodhë Armagedoni, sipas interpretimit të secilit kamp? Cilin interpretim favorizon leximi i Zbulesës 19:19-20:3, si një paragraf në të cilin triniteti satanik mundet menjëherë?
7. Cilat janë disa nga vështirësitë e interpretimit paramijëvjeçar të Zbulesës 20? Si kapërcehen më mirë këto vështirësi?
8. Me gjithë këtë gjuhë të fshehtë/kriptike dhe këto imazhe të çuditshme, cili është mesazhi kryesor që duhet të kuptojnë nga Zbulesa besimtarët, në lidhje me fundin e historisë njerëzore? Si ndryshon kjo nga mënyra se si e kanë përdorur Zbulesën shumë njerëz në brezin tonë dhe në brezat e mëparshëm?

BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR

KOMENTARË

Të nivelit të avancuar

Aune, David E. *Revelation*, 3 vols. WBC. Dallas:Word, 1997-98.

Beale, Gregory K. *The Book of Revelation*. NIGTC. Carlisle:Paternoster; Grand Rapids and Cambridge:Eerdmans, 1999.

Osborne, Grant R. *Revelation*. BECNT. Grand Rapids: Baker, 2002.

Smalley, Stephen S. *The Revelation to John*. London: SPKC; Downers Grove:IVP, 2005.

Thomas, Robert L. *Revelation*, 2 vols. Chicago:Moody, 1992-96.

Të nivelit mesatar

Caird, George B. *A Commentary on the Revelation of Saint John the Divine*. BNTC/HNTC. London: Black; New York: Harper, 1966.

Hughes, Philip E. *The Book of Revelation*. PNTC. Leicester:IVP; Grand Rapids: Eerdmans, 1990.

Johnson, Dennis E. *Triumph of the Lamb: A Commentary on Revelation*. Phillipsburg, N.J.: Presbyterian and Reformed, 2001.

Keener, Craig S. *Revelation*. NIVAC. Grand Rapids: Zondervan, 2000.

Bibliografi e përzgjedhur

Mounce, Robert H. *The Book of Revelation*. NICNT, rev. Grand Rapids: Eerdmans, 1998.

Murphy, Frederic J. *Fallen is Babylon: The Revelation of John*. NTinCont. Harrisburg: Trinity, 1998.

Reddish, Mitchell G. *Revelation*. SHBC. Macon:Smyth & Helwys, 2001.

Roloff , Jürgen. *The Revelation of John: A Continental Commentary*. Minneapolis: Fortress, 1993.

Witherington, Ben, III. *Revelation*. NCBC. Cambridge and New York: CUP, 2003.

Libra hyrës

Kovacs, Judith, and Christopher Rowland, with Rebekah Callow. *Revelation*. BBC. Oxford and Malden, Mass.: Blackwell, 2004.

Metzger, Bruce M. *Breaking the Code: Understanding the Book of Revelation*. Nashville: Abingdon, 1993.

Michaels, J. Ramsey. *Revelation*. IVPNTC. Leicester and Downers Grove: IVP, 1997.

Morris, Leon. *The Book of Revelation*. TNTC, rev. Leicester: IVP; Grand Rapids: Eerdmans, 1987.

Peterson, Eugene H. *Reversed The Under: The Revelation of John and the Praying Imagination*. San Francisco: Harper & Row, 1988.

LIBRA TË TJERË

Bauckham, Richard. *The Climax of Prophecy*. Edinburgh: T&T Clark, 1993.

Blevins, James L. *Revelation as Drama*. Nashville: Broadman, 1984.

Blount, Brian K. *Can I get a Witness? Building Revelation through African American culture*. Louisville: WJKP, 2005.

Boesak, Allan A. *Comfort and Protest: Reflections on the Apocalypse of John of Patmos*. Philadelphia: Westminster, 1987.

Collins, Adela Yarbro. *Crisis and Catharsis: The Power of the Apocalypse*. Philadelphia: Westminster, 1984.

Court, John M. *Myth and History in the Book of Revelation*. London: SPCK, 1979.

- Dawn, Marva J. *Joy in Our Weakness: A gift of Hope from the Book of Revelation*. Grand Rapids and Cambridge: Eerdmans, 2002.
- Duff, Paul B. *Who Rides the Beast? Prophetic Rivalry and the Rhetoric of Crisis in the Churches of Apocalypse*. Oxford and New York: OUP, 2001.
- Fiorenza, Elizabeth Schüssler. *The Book of Revelation: Justice and Judgement*. Philadelphia: Fortress, 1985.
- Friesen, Steven J. *Imperial Cults and the Apocalypse of John*. Oxford and New York: OUP, 2001.
- Goldsworthy, Graeme. *The Gospel in Revelation*. Exeter: Paternoster, 1984; Nashville: Nelson, 1985.
- Koester, Craig R. *Revelation and the End of All Things*. Grand Rapids and Cambridge: Eerdmans, 2001.
- Kraybill, J. Nelson. *Imperial Cult and Commerce in John's Apocalypse*. Sheffield: SAP, 1996.
- Michaels, J. Ramsey. *Interpreting the Book of Revelation*. Grand Rapids: Baker, 1992.
- Pate, C. Marvin, ed. *Four Views on the Book of Revelation*. Grand Rapids: Zondervan, 1998.
- Rhoads, David, ed. *From Every People and Nation: The Book of Revelation in Intercultural Perspective*. Minneapolis: Fortress, 2005.
- Slater, Thomas B. *Christ and Community: A Socio-Historical Study of the Christology of Revelation*. Sheffield: SAP, 1999.
- Smalley, Stephen S. *Through the Lens of Love: John's Revelation and John's Community*. Milton Keynes: Word, 1994.
- Thompson, Leonard L. *The Book of Revelation: Apocalypse and Empire*. Oxford and New York: OUP, 1990.
- Wainwright, Arthur W. *Mysterious Apocalypse: Interpreting the Book of Revelation*. Nashville: Abingdon, 1993.

BIBLIOGRAPHY

- Muse, Robert L. *The Book of Revelation: An Annotated Bibliography*. New York: Garland, 1996.

“Profesor Craig blomberg njihet dhe vlerësohet botërisht në Amerikë dhe në shumë vende të tjera, si një ndër akademikët më të respektuar ungjillorë të kohës sonë. Por atë e njohin edhe shumë njerëz të thjeshtë, sepse kalibri i tij akademik u popullarizua sidomos përmes librit “Çështja e Krishtit” të Lee strobels.

Zbulesa konsiderohet si libri më i vështirë i biblës për t’u kuptuar dhe shumë shpesh lihet pa lexuar, ndërkohë që Zbulesa është i vetmi libër që thotë shprehimisht se leximi i kësaj profecie bekon. Të krishterët në përgjithësi duken se s’kanë besim tek vetja për ta kuptuar duke e lexuar Zbulesën vetë dhe gjithmonë synojnë shpjegimet e të tjerëve që mund të variojnë në një gamë shumë të gjerë këndvështrimesh dhe interpretimesh.

As profesor blombergu, dhe as ne, botuesit, nuk presim që çdo lexues të njësohet me të në çdo mendim për Zbulesën, por shpresojmë që thjeshtësia dhe qartësia e arsyetimit do të inkurajojë mendimin e çliruar nga paragjykimet dhe pasiguria, që të përtypë bekimin e Zbulesës, duke e lexuar vetë.”

YLLi Doçi

Drejtor Kombëtar i iJr-së për
shqipërinë dhe Kosovën

Craig L. BLomBerg është profesor i dalluar i Dhiatës së re në seminarin e Denverit në sHbA. Ka fituar gradën Doktor i shkencave Filozofike si studiues i Dhiatës së re nga universiteti i Aberdinit në Skoci. Gjithashtu, ka punuar si kërkues shkencor në universitetin e Kembrixhit në Angli dhe është autor shumë i njohur librash dhe artikujsh.

ISBN: 978-99956-851-7-1

Çmimi: 500 lekë

9 789995 685171